

Revistë edukative-kulturore - [www.revistaetika.com](http://www.revistaetika.com)

Gusht 2012  
Numri: 53  
E përnuajshme

Shqipëri: 150 Lek  
Kosovë: 1 Euro  
Maqedoni: 60 Den


# ETIKA

## ASHKU HYJNOR QËLLIMI SUBLIM



# *Zytetërimi i virtyteve*

Nga epoka e lumturisë deri në ditët tona



*“Historitë e bukura  
të robërve të devotshëm  
janë pothuaj si dhuratat  
e xhenetit.”*



# Editorial

***“O myslimanë!***

***Mbi ju ka rënë hija e një muaji madhështor dhe të bekuar.***

***Ky është muaji në të cilin gjendet edhe nata e Kadrit, natë që është më e mirë se njëmijë muaj së bashku.***

***Ky është muaji në të cilin Allahu ju obligoi të agjëroni ditën dhe u begatoi me faljen e namazit (të teravisë) mbrëmjeve. Kush bën ndonjë vepër të mirë në këtë muaj, fiton po aq sevape sa fiton personi që kryen një detyrë fetare të detyruar (farz) në një kohë tjetër, jashtë këtij muaji. Ai që përmbush një farz në këtë muaj, fiton sevapin e kryerjes së shtatëdhjetë farzeve në muajt e tjerë.***

***Ky është muaji i durimit, shpërblimi për të cilin është xheneti.***

***Ky është muaji i bamirësisë, ndihmës dhe barazisë.***

***Ky është muaji, në të cilin besimtarit i shtohet begatia hyjnore e materiale.”***

Kjo pjesë nga hytja e Profetit Muhamed (a.s.), është një thirrje e qartë dhe një busull orientuese për çdo besimtar që adhuron përsosjen shpirtërore e morale në rrugën e Allahut (xh.sh.)

Në fenë islame, si jeta e individit, si jeta e shoqërisë janë të ndërlidhura me adhurimet. Agjërimi është një nga adhurimet që kryhet më shumë nëpër shoqëritë myslimane. Agjërojnë njerëz nga mosha shtatë deri në shtatëdhjetë vjeç.

Me çfarë na pajis agjërimi? Cili është dallimi mes jetës me agjërim dhe asaj pa agjërim. Çfarë shpreh ky dallim nga aspekti i jetës sonë të përgjithshme?

Agjërimi është një lloj ibadeti që ka kohën e vet. Kjo periudhë është koha e rigjallërimit të njeriut fizikisht, mendërisht dhe shpirtërisht. Ai është një adhurim në të cilin rridisplinohen nevojat më themelore të njeriut. Në këtë mënyrë, agjërimi e shtyn njeriun drejt përpikmërisë së të jetuarit sipas kriterëve të të Plotfuqishmit.

Përveç kësaj, tradita islame e ka mpleksur agjërimin me zekatin, duke vënë në zbatim dhurimin e sadakatul fitrit, përpara Bajramit të Ramazanit. Kështu myslimani, të cilit i zbutet zemra me anë të urisë individuale dhe përjeton një llogari të re në marrëdhënien e tij me pasurinë, rindërton vetveten dhe shoqërinë ku jeton.

Prandaj muajin e Ramazanit duhet ta konsiderojmë si njohje e kufijve hujnorë dhe si klimën ku rritet përpikmëria ndaj këtyre kufijve.

Të nderuar lexues!

Ky numër i revistës “Etika” është realizuar me shkrime të botuara në numra të mëparshëm. Përzgjedhja është bërë sipas kriterit të atmosferës që sjellin këto shkrime në përputhje me frymën e muajit të madhnueshëm të Ramazanit.

# Do të lexoni:

- Ahmet Tashgetiren / 4** Fillimi i një jete të re së bashku me agjërimin
- Sabri Akdeniz / 6** Ramazani dhe njeriu
- Prof. dr. Ismail L. Çakan / 8** Ramazani nga gjuha e Profetit (a.s.)
- Jetmir Selmani / 10** Sadakaja, urë lidhëse mes të pasurit dhe nevojtarit
- Jashar Kandemir / 12** Pendimi
- Ymit Shimshek / 14** Fatihaja e jetës
- Jonida Tashi / 16** 10 sëmundjet që shëron agjërimi
- Idris Arpat / 18** Boshti i Teuhidit
- Vehbi Vakasogllu / 21** Civilizim pa dashuri  
Dashuri pa civilizim
- Prof. dr. Hasan K. Jëlmaz / 24** Namazi, miraxhi i besimtarit
- Ma. Zymer Ramadani / 26** Rëndësia dhe roli i Duasë në jetën e përditshme
- Sejid Hysejn Nasr / 30** Roli dhe karakteri i Profetit (a.s.)
- Ali Riza Temel / 34** Disiplina turp-shpirt në Ramazan
- / 36** Fotoja e Muajit
- / 38-39** Një ajet - Një hadith
- Osman Nuri Topbash / 40** Sinqeriteti në dhurim

4

Ahmet Tashgetiren



18

Idris Arpat



26

Ma. Zymer Ramadani



Viti: VI | Numri: 53 | Gusht 2012

Drejtor & Kryeredaktor:

Alban Kali

albankali@yahoo.com  
+355 67 20 86767

Redaktor:

Zija Vukaj

Korrektore:  
Dr. Irida Hoti

Përkthyesit:

Albert Halili / Arjan Ymeraj / Artur Tagani  
Fatmir Sulaj / Ilir Hoxha

Dizajn-Grafik:  
Bledar Xama

Për artikuj:

e-mail: revistaetika@progresibotime.com  
e-mail: kosova@progresibotime.com  
e-mail: maqedoni@progresibotime.com

# Gusht 2012

40

*Osman Nuri Topbash*



52

*Nexhat Ibrahim*



58

*Shpëtim Kelmendi*



Mbi pasqyrimin e transcendencës  
hyjnore në artet pamore

Ashku hyjnor, qëllimi sublim

Ekuilibri ndërmjet fesë dhe botës

Universi i Kuranit

Dyzimi i njeriut

Shenjat e një familjeje të lumtur

Përkujdesja madhështore e Allahut

Tri këshilla

Zoti pret të pendohesh  
kurse ti rrefuzon

Tefsiri i sure-i Asrit

Shkenca dhe Islami

Dispozitat e agjërimit

- Roli i vitaminave në zgjatjen e trupit

- Të sëmurët kronikë dhe agjërimi

- Kompjuteri më i shpejtë në botë

- Panelet diellore transparente

- Dhuna dhe padrejtësitë kundër

myslimanëve të Mianmarit

- Olimpiada e Londrës

e gatshme për Ramazanin

**46 / Edison Çeraj**

**49 / Xhafer Bekirollu**

**50 / Doç. dr. Sulejman Derin**

**52 / Nexhat Ibrahim**

**56 / Nuredin Nazarko**

**57 / M. Sami Ramazanogllu**

**58 / Shpëtim Kelmendi**

**61 /**

**62 / Imam Naim Drijaj**

**64 / Zani i s'kaluemes**

**66 / Ma. Artur Tagani**

**68 / Ma. sci. Flamur Sofiu**

**72 / Shëndet**

**73 / Teknologji**

**74 / Aktualitet**

**PROGRESI**  
BOTIME  
www.progresibotime.com

**Adresa:**

**L: Vasil Shanto / Rr: Çajupi**

**Shkodër / Albania**

**Tel: +355 22 254 634**

**Fax: +355 22 254 633**

**Zyra e përfaqësimit Maqedoni**

Rr. Stiv Naumov / nr. 9 / lokal 25

Shkup / Maqedoni

+389 71 956 271

**Zyra e përfaqësimit Kosovë:**

Rr. Ardian Zurnaxhiu / pn. Ralin

Prizren / Kosovë

Tel: +381 29 222 795

Fax: +381 29 222 797

+377 4411 98 48

**Çmimi:**

**Shqipëri: 150 Lekë**

**Abonim (një vjetor): 1500 Lekë**

**Kosovë: 1 Euro**

**Abonim (një vjetor): 10 Euro**

**Maqedoni: 60 DEN**

**Abonim (një vjetor): 720 DEN**

**Europë: 2 Euro**

**Abonim (një vjetor): 24 Euro**

# *Sillimi i një jete të re së bashku me agjërimin*

*Ahmet Jashgetiren*

**T**ë gjithë adhurimet e Islamit janë jetë ose janë të ndërthurura me vetë jetën. Në jetën e myslimanit nuk ekziston ndarja mes jetës dhe adhurimit. Adhurimi në jetën e myslimanit nuk është një copë e huaj.

Adhurimi gjendet në thelb të cohës së jetës së myslimanit.

Në fenë islame si jeta e individit, si jeta e shoqërisë janë të ndërlidhura me adhurimet.

Vetëm në rastin kur adhurimi dhe jeta shoqërore bëhen një e tërë me ndjenjat e afinitetit ndaj Allahut atëherë mund të bëhet fjalë për "njeriun e Islamit" apo "shoqërinë islame".

Në qoftë se adhurim do të thotë "**robëri ndaj Zotit**" atëherë myslimani nuk mund të shkëputet nga "**robëria**" në asnjë fushë të "**jetës**".

Marrëdhënia mes adhurimit dhe jetës ka nisur të dobësohet gjatë proceseve sekulariste-laike-botërore të kohëve moderne.

Duket sikur myslimani i ditëve tona i kryen adhurimet, por tërhiqet drejt botëkuptimit apo veprimeve që nënkuptojnë se kjo jetë mund të jetohet edhe jashtë kriterëve islame.

Në të vërtetë që adhurimi të quhet vërtet adhurim është e nevojshme që jeta të ndërtohet brenda tërësisë islame.

Edhe për "namazin" që do të pranohej si adhurimi më personal i individit është e nevojshme një disiplinë jetë apo një jetë e unifikuar në tërësinë e saj. Në jetën që njeriu nuk arrin të qëndrojë përherë përpara Zotit, pra kur zemra, mendja dhe çdo gjymtyrë e njeriut ndjek pas nga një gjë

më vete, si është e mundur që të gjithë organet e njeriut të fokusohen në një pikë, të përqendrohen në një qëllim dhe të mund të dalin përpara "audiencës" duke thënë "Allahu ekber"?

Agjërimi është njëri nga adhurimet që kryhet më shumë nëpër shoqëritë myslimane. Agjërojnë njerëz nga moshat shtatë deri në shtatëdhjetë vjeç.

Pyetja që mund të bëhet është:

A mund të bëhet fjalë për një "jetë sipas islamit" në shoqëritë myslimane në atë masë që është i përhapur zbatimi i adhurimit të agjërimin?

Kujdes se mos agjërimi shndërrohet në një formë sjelljeje të montuar në jetën e individit prej një tradite të trashëguar dhe nuk është se përjetohet me një ndjesi frike ndaj Zotit!

Kjo shprehje ka lidhje me pyetjen nëse agjërimi ka hyrë apo jo në jetën tonë si "adhurim" i vërtetë.

Kjo shprehje ka lidhje të ngushtë me pyetjen se në cilin nivel është ndërgjegjësimi i njeriut tonë në lidhje me "adhurimin".

Çfarë është adhurimi?

Në qoftë se "**adhurim**" do të thotë robëri ndaj Zotit, çfarë vlere përcaktuese mbart "**robëria ndaj Zotit**" në jetën tonë?

Këtu ne nuk kemi të drejtën të bëjmë inspektim agjërimi apo të akuzojmë për "nivel të ulët adhurimi", por kemi të drejtë të përcaktojmë adhurimin si një mjet që e shpie njeriun drejt ndërgjegjësimit për një "bashkim me Zotin". Të shprehemi se adhurimet kryhen vetëm për hir të Zotit, se kemi të nevojshme një impuls mendor dhe shpirtëror që "të mos e harrojmë Atë". Të gjitha këto mund të realizohen vetëm me një jetë gjithëpërfshirëse.

Herë pas here flasim për rëndësinë që ka “të kushtuarit rëndësi Islamit”.

Këtë paralajmërim ia drejtojmë një bashkësie që shprehet me zë të lartë se “është myslimane”. Nën këtë qëndron meraku që edhe e cilësojmë veten si mysliman, edhe nuk arrijmë ta mbështesim këtë fjalë me të vërtetë me veprat që dëshiron feja islame. Në qoftë se është e rëndësishme të thuash “unë jam mysliman”, e rëndësishme është edhe ta mbështetësh këtë veprim me vepra, sepse nuk duhet ta harrojmë se një myslimanllëk pa vepra konkrete nuk e meriton të pranohet në audiencën e të Plotfuqishmit që në të vërtetë këtë kërkon prej nesh.

Këtë shqetësim duhet ta ndjejmë edhe për agjërimin.

Pse kam agjëruar?

Me çfarë na pajis agjërimi?

Cili është dallimi mes jetës me agjërim dhe asaj pa agjërim. Çfarë shpreh ky dallim nga aspekti i jetës sonë të përgjithshme?

Profeti (a.s.) ka thënë: *“U shoftë ai person që e mbërrin muajin e Ramazanit dhe në përfundim të tij Zoti nuk ia ka falur mëkatet.”* (Tirmidhi, Daavat, 101) Në një rast tjetër ka thënë: *“Personit që agjëron sepse beson në vlerat e muajit Ramazan dhe duke shpresuar shpërblimin nga Allahu, kanë për t’iu falur të gjitha gjynahet e kaluara.”* (Buhari, Iman 28, Savm, 6) Në të vërtetë këto dy kritere të profetit ekspozojnë para nesh dy anët e ndryshme të erashkës brenda së cilës gjendet agjërimi.

Në agjërim ka edhe një eliksir përfshirës që mundëson një pastrim të përgjithshëm, edhe një pikëllim të tipit “mos të të falë Zoti mëkatet”, edhe pse ka kaluar një muaj agjërim.

Paralajmërimet e kësaj natyre të bëra nga profeti Muhamed nuk kufizohen me kaq. Kur i lexojmë këto hadithe profetike nga aspekti i disiplinës jetësore të një myslimani përpara nesh shfaqet një kornizë e ndryshme e jetës:

*“Askush prej jush të mos thotë fjalë të këqija dhe të mos grindet me kënd kur të jetë agjërueshëm. Në qoftë se dikush e fyer atë le t’i thotë “Unë kam agjëruar sot.”* (Buhari, Savm, 9)

*“Kush nuk braktis gënjeshtat dhe punët me mashtrim, ta dijë se Allahu nuk ka nevojë që ai njeri të mos hajë dhe të mos pijë.”* (Buhari, Savm, 8)

Nga këto dy hadithe mësojmë se në jetën e myslimanit që ka agjëruar nuk ka vend për gënjeshtat dhe mashtrimet. Këto hadithe na mësojnë edhe se adhurimi ndaj Allahut nuk mbështetet në mendimin se Zoti ka nevojë për agjërimin tonë dhe se robëria ndaj Zotit, në të njëjtën kohë do të thotë të ndërtosh një jetë të pastër.

Profeti i Zotit shkon edhe më tej kur shprehet se agjërimi apo namazi që nuk është pjesë e një jete të tillë të pastër apo nuk të jep mundësinë të ndërtosh një jetë të tillë me vlerë, shndërrohet në barrë të rëndë për njeriun. Në këtë kontekst ai ka thënë:

*“Sa vetë ka që agjërojnë dhe nuk përfitojnë gjë nga agjërimi vetëm se rrinë të uritur me barkun thatë. Sa vetë ka që falin namaze nate dhe nuk bëjnë gjë tjetër vetëm se rrinë zgjuar natës.”* (Ibn Maxhe, Sijam 21, Darimi, Rikak 12, Hanbel, Musned II, 373)

Duke na bërë të ditur se gënjeshtat dhe agjërimi nuk mund të bëhen bashkë asnjëherë, i Dërguari i Allahut e

paralajmëron besimtarin që të mos shtojë mashtrim në robërinë e tij ndaj Zotit.

E vërteta që të gjitha këto gjëra nxjerrin në pah është se, njeriu që e shkon ditën brenda një kornize që bie në kundërshtim me Islamin, edhe nëse është agjërueshëm as nuk do të përfitojë nga mëshira e Zotit, as nuk do të arrijë që të pastrohet shpirtërisht.

Agjërimi është një lloj ibadeti që ka kohën e vet. Ai përjetohet brenda një afati kohor prej një muaji. Kjo periudhë kohe është koha e rigjallërimit të njeriut fizikisht, mendërisht dhe shpirtërisht.

Agjërimi është adhurimi në të cilin ri-disiplinohen nevojat më themelore të njeriut, si uria dhe seksi. Agjërimi në këtë mënyrë e shtyn njeriun drejt përpikmërisë së të jetuarit sipas kritereve të Plotfuqishmit që ka përcaktuar natyrën njerëzore të njeriut.

Agjërimi e drejton njeriun drejt të kuptuarit të situatës së nevojtarëve nga njëra anë dhe nga ana tjetër e detyron atë të mjaftohet me sasinë më të pakët të pasurisë që zotëron duke e mbajtur në këtë mënyrë larg shpenzimeve. Në një kuptim agjëruesi është i varfër. Njeriu që agjëron me këtë ndërgjegje nuk rrezikon kurrë të bëhet një ditë si Karuni.

Agjërimi dhe namazi shkojnë bashkë përherë, sepse myslimani e ka për detyrë të falë namaz çdo ditë. Atëherë namazi e ushqen agjërimin ashtu si agjërimi e ushqen namazin. Të dy këto adhurime endin “ndërgjegjen e robërisë së Allahut”, që është edhe shtylla kurrizore e personalitetit të myslimanit.

Përveç kësaj, tradita islame e ka pleksur agjërimin me zekatin, duke vënë në zbatim dhurimin e sadakatul fitrit përpara Bajramit të Ramazanit. Kështu myslimani, të cilit i zbutet zemra me anë të urisë individuale dhe që përjeton një llogari të re në marrëdhënien e tij me pasurinë në sajë të iftarit dhe syfyrit të sofrës së tij që nuk ndryshon shumë nga ajo e nevojtarit me zekatin që jep e rindërton si vet-veten ashtu edhe shoqërinë ku jeton. Aty ka edhe paqe, edhe prehje.

Të gjitha këto e bëjnë agjërimin cohën më jetike të jetës së myslimanit. Ka një harmoni të dallueshme mes agjërimit dhe jetës. Agjërimi nuk është i huaj për jetën. Askush nuk pyet “Ç’është ky agjërim, ç’është kjo jetë?” nuk mund të agjërosh ditën dhe të shkelësh “kufijtë e Allahut” natën.

Mund të mendohet se ndoshta injoranca në çështjen e **“kufijve të Allahut”** mund të hapë rrugën e këputjes së marrëdhënieve me jetën.

Prandaj muajin e Ramazanit duhet ta konsiderojmë si njohja e kufijve hyjnorë dhe si klimën, ku rritet përpikmëria ndaj këtyre kufijve.

Agjërimi është një paketë adhurimi e mrekullueshme që i ofrohet Zotit. Nëse arrijmë ta ofrojmë atë pas një jete të dëlirë edhe kjo do të numërohet si gjurmë e respektit tonë ndaj Zotit. Kuptohet qartë se shembujt e një robërie të dëlirë nuk do të mund të dalin nga një jetë e plagosur dhe e fëlliqur.

Lutemi që agjërimi ynë të jetë i tillë që agjëruesi të meritojë faljen e Zotit.



# Ramazani DHE NJERIU

*Sabri Akdeniz*

Duke filluar që nga fëmijëria, shoqëria e ka për detyrë çdo individ ta brumosë me veçoritë e besimit, zakoneve, traditave dhe sjelljeve të veta duke i formuar kështu atij edhe karakterin. I jep atij tiparet dalluese të vetat. Individu ka për detyrë që t'i mbrojë dhe t'i tejkalojë tiparet dalluese që i ka dhënë shoqëria.

Institucionet shoqërore këtë detyrë e bëjnë në dy rrugë: 1- mendimet e individëve për institucionin; 2- Sjelljet dhe drejtimi që pret institucioni nga individë apo grupi shoqëror. Edhe pse mund të duket sikur këto dy drejtime dalin në të njëjtën derë, përsëri e vërteta nuk është e tillë. Individët mund të kenë mendime të ndryshme në lidhje me institucionet. Nga ana tjetër ata që presin institucionet nga individët përherë i tejkalojnë atë që ka në mendje individit. Psh: ne meqë jemi edhe në muajin e madhnueshëm të ramazanit në sjelljet tona gjatë ditës nuk arrijmë që të ngrihemi në atë shkallë që pritet prej nesh sidomos në jetën tonë shpirtërore. Përherë janë të pranishme disa gabime apo mangësi tona. Ç' është e drejta disa nga vëllezërit tanë janë në shkallë të ndryshme, ka nga ata që nuk mund të ngjiten qoftë edhe një shkallë më lart sesa uria apo agjërimi, ndërsa ka nga ata që i afrohen lartësisë shpirtërore që kërkon ramazani. Ja pra, që ta kryejmë më devotshmëri detyrën e muajit të madhnueshëm të ramazanit, duhet që t'i afrohemi mënyrës së të jetuarit një ramazan pa gabime duke u ngritur çdo ditë nga një, dy, tre shkallë e kështu me radhë dhe duke e përgatitur veten nga një ramazan në tjetrin. Sa më pozitive dhe më të thella, sa më të kapshme dhe të kuptueshme të jenë ndjenjat, sa më i pasur dhe pozitiv të jetë mendimi dhe kuptimi që zgjon në mendjet e njerëzve ky muaj i madhnueshëm aq mirë do ta bëjë detyrën e tij edukative, drejtuese, lartësuese dhe influencuese në karakterin e individit. Padyshim kjo është e lidhur me atë se sa vend do t'i japim ne dhe sa rëndësi do t'i kushtojmë në shoqërinë tonë. Çdo institucion shoqëror bëhet ndikues aq sa rëndësi i jepet këtij institucioni në shoqëri, sa vlera bashkohet me të, aq sa pasuri idesh ka në raport me mundimin që i jepet. Ai që ka përfituar më shumë nga

ramazani, është ai që ka zgjedhur për vete qëllimet më të mira duke u përpjekur t'i arrijë ato.

Muaji i madhnueshëm i Ramazanit nuk duhet të jetë vetëm një muaj që i afrohemi më tepër Zotit me dëshirë më të fortë edhe më të madhe se në çdo kohë tjetër, por është edhe një muaj i mbushur plot me jetë të pastër dhe të paharrueshme si dhe me kujtime të lumtura. Një gjë e tillë shton edhe më tepër begatinë e këtij muaji të madhnueshëm dhe si rrjedhojë rrit vlerën dhe vijueshmërinë e influencave të dobishme.

Fatkeqësisht ne e kemi lënë mangët atë që i takon këtij muaji, përgjatë 12 muajve të tjerë nuk ia kemi dhënë dot duke e varfëruar në këtë drejtim. Kështu që edhe ky muaj është sjellë në të njëjtën formë ndaj nesh duke na dhënë pak nga mirësitë e tij. Kemi kohë që jemi në një rizgjim në rrugën e drejt Tij. Nuk ka dyshim që shpërblimin e kësaj do ta shohim që të gjithë, qoftë ato që e bëjnë detyrën e tyre si individ, qoftë edhe si popull.

Ramazani dhe agjërimi janë ngjarje të tilla që e shpëtojnë adhurimin brenda një viti nga kufizimi me pritja si dhe u ngarkojnë besimtarëve akoma pa filluar një ngarkesë shpirtërore që sa vjen e rritet. Me këtë tipar dallues mund të influencojë në sjelljet e individit në çdo moshë si dhe mund ta shpëtojë nga ndryshimet dhe zakonet e këqija. Por vetëm nëse arrijmë që ta presim ashtu siç duhet këtë muaj... Për këtë arsye qoftë ata që janë predikues, qoftë edhe besimtarët që ta çojnë në vend në shkallën më të lartë detyrën e muajit të madhnueshëm të ramazanit, duhet të bëjnë atë që u takon duke qenë të kujdesshëm në sjelljet dhe veprimet e tyre. Është shumë e rëndësishme që shkrimet në gazeta dhe revista, bisedat e bëra në radio dhe televizor, bisedat që bëhen në shtëpi, në rrugë apo në mbledhje të synojnë ta pastrojnë ramazani nga veset e këqija për t'u përgatitur për të çuar në vend detyrat që na takojnë. Në këtë drejtim, muaji i madhnueshëm i ramazanit është një mundësi ideale. Tashmë është bërë traditë që në hutbet e xhumasë së parë si dhe në ligjëratën e ramazanit të trajtohen këto tema. Por me këtë rast ka shumë rëndësi se çfarë temash do të trajtohen si dhe si të trajtohen.

Në këtë aspekt, një rëndësi të madhe mbart edhe fillimi i agjërimit për fëmijët. Nuk mjafton t'i thuash: "Tashmë ke



ardhur në moshën për të agjëruar, nesër do të agjërosh që nga fillimi i ditës e deri në të ngrysur të saj, nuk do të hash gjë, nuk do të pish', duke i dhënë disa këshilla dhe duke i shpjeguar se priten disa sjellje të mira në përshtatje me muajin e madhnueshëm të ramazanit (durimi, shmangia nga fjalët e këqija dhe fjalori i rëndë, kryerja e mirësive e dhënia e ndihmave). Këto nuk duhen dhënë me presion, por të përgatitet fëmija për të përdorur vullnetin e tij në realizimin e këtyre detyrave. Këto duhet t'u jepen si një detyrë e lartë dhe me shumë nder. Është mjaft e rëndësishme në aspektin e edukimit dhe të arsimimit fetar që fëmijët që do të fillojnë për herë të parë ramazanin të mblidhen një natë përpara në familjet mike si mysafirë duke u dhënë shpjegimet e duhura në lidhje me këtë muaj. Një natë e tillë e lumtur fëmijës mund t'i lërë gjurmë të paharrueshme. Por edhe në këtë rast patjetër duhen t'u shmangemi metodave të presionit gjatë shpjegimeve.

Që ta adhurojmë Allahun me vërtetësi, që ta mbushim shpirtin tonë me dashurinë për Të, që të meritojmë dashurinë e tij duhet që të pastrohemi nga të gjitha të këqijat. Sjelljet e mira të individit, mirësitë që ka bërë për t'u afruar Atij, janë një burim i fortë për t'i hapur zemrën, ndërsa sjelljet e këqija i ngushtojnë dyert e zemrës dhe të shpirtit për këtë dashuri. Ja pra, pikërisht ky muaj i madhrueshëm duhet të merret dhe të kuptohet si një periudhë e tillë edukimi brenda një "uni" shpirtëror. Do të forcohen zakonet e mira dhe do të lihen ato të këqijat në mënyrë që të mos kthehen më... Sevapet e fituara gjatë këtij muaji janë më tepër sevape ndërsa gjynahet më tepër gjynahe...

Muaji i madhnueshëm i ramazanit nuk është një institucion i vetëm por një buqetë institucionesh. Muaji i madhnueshëm i ramazanit është një institucion shoqëror i pazëvendësueshëm për bajramin si dhe "zeqatin" që është bërë traditë të jepet në këtë muaj, për iftares dhe rregullimin e marrëdhënieve njerëzore në rrugë sa më të mirë. Në asnjë shtet përveç shoqërive myslimane nuk ka ndonjë institucion që i mbledh të gjithë njerëzit brenda dhe jashtë vendit nën një çati të lumtur për një kohë një mujore, që i bashkon të gjithë kokë më kokë të pasur dhe të varfër, me shkollë dhe pa shkollë dhe që u ofron një bisedë tepër serioze për një natë. Është faji ynë nëse nuk marrin atë që duhet prej tij. Veçanërisht mes gjendjeve shpirtërore të atyre që mblidhen në xhami dhe atyre që mblidhen në kinema apo në vende të ngjashme, ka shumë dallime të mëdha. Së pari atyre që u flitet për ramazanin apo bajramin ju vjen si një ndriçim dhe shpresë për zemrën e tyre ndërsa tek të tjerët nuk ka një përgatitje të tillë.

Muaji i madhnueshëm i ramazanit është një mundësi e mirë edhe për të shfaqur dashurinë për njëri-tjetrin. Një gjë e tillë zgjon ndjenjat e lumturisë tek individët, ndihmon

në shëndetin e shoqërisë, forcon lidhjet e sadakasë mes njerëzve fetarë.

Ashtu sikurse është një detyrë e jona që të përgatisim popullin dhe fëmijët tanë për këtë muaj, duhet edhe ta përcjellim dhe të përgatitemi mjaft seriozisht për bajramin; pasi edhe mbarimi i ramazanit edhe ardhja e bajramit të ramazanit, janë ngjarje të rëndësishme, është koha për t'i dhënë llogari vetes sonë. Veçanërisht sjellje të mira, si: vizita tek të dashurit e zemrës, përsëritjet për bajram, marrja e rrobave të reja për fëmijët, shkëmbimi i dhuratave etj. janë gjurmë të lumtura që i kanë lënë në mendjen e secilit të madh dhe të vogël, janë edukues i mirë në kujtime të lumtura dhe krijojnë mundësi për përshtatje në jetën shoqërore. Mendoj se është detyrë e çdo myslimani që të shfrytëzojë në maksimum këtë mundësi. Edhe këshillat që u jepen fëmijëve në këtë drejtim, janë me dobi për ne dhe ata. Përsëri është detyrë e jona që të shfrytëzojmë ramazanin dhe bajramin si një periudhë e paqes dhe e harmonisë. Kështu që mes njëri-tjetrit zhvillohen ndjenjat e mirëkuptimit dhe e tolerancës, të dashurisë për njëri-tjetrin dhe një pjesë e madhe shpëton nga ato mërzitje që janë burim i prishjes së qetësisë duke mbyllur kështu edhe dyert e një kujtimi të pakëndshëm.

Kur marr parasysh përgatitjet e bëra për pritjen e Vitit të ri të të krishterëve dhe Vitin e Ri që është një bajram i të krishterëve me përgatitjet për pritjen e bajramit të ramazanit diçka më mblidhet përbrenda. Myslmani ynë! ... Përgatitjet e bëra për një vit të ri, një pritje si për një perandor që pritet nga larg 50-100 kilometra nga kryeqyteti, dhe dyqanet e mbushura plot e përplot që një muaj përpara. A është "e dhimbshme" apo "një turp" nuk e di si të them. Çdo përgatitje e bërë në çdo skaj të vendit dhe në shumë shtëpi të myslimanëve veçanërisht duke bërë reklama në televizione, festohet thuajse është bajrami ynë i vërtetë. E aq më tepër kjo nuk bie as në kundërshtim edhe me shtetin tonë dhe me ligjin laik.

Kur shkruaj këta rreshta nuk është se s'më lind edhe një ndjenjë gëzimi. Kjo pasi mendoj ramazanet dhe bajramet këtu e 50 vite më parë... padyshim që kemi bërë hapa mjaft të rëndësishëm. E kemi shmangur mjaft edhe vuajtjen tonë.

Po hyjmë në muajin e madhnueshëm të ramazanit. Mos të harrojmë, që tani të fillojmë me përgatitjet për ramazanin, për bajramin, t'i përvishemi punës që ta presim sa më mirë, të zbukurojmë aq mirë veten tonë, shpirtat tanë, xhamitë dhe qytetet tona në mënyrë që edhe ata që merren me pritjen e Vitit të Ri, me përgatitjet e pemëve, me shkuarjet në kryeqytetet perëndimore, me ata myslimanë që i bëjnë fëmijët e tyre të puthin dorën e plakut të vitit të ri, sado pak të mendojnë dhe të turpërohen. Edhe tek ne të zgjohen që herët ndjenjat e dashurisë dhe të lumturisë dhe gëzimit. Të duam më tepër, të dashurojmë dhe të shfaqim më shumë ndjenjat e dashurisë për të tjerët. Të fillojmë që tani të bëjmë më shumë mirësi dhe të vazhdojmë kështu, në mënyrë që ramazani dhe lumturia e bajramit të na mbulojnë për një kohë të gjatë duke filluar që tani. T'u shmangemi gjynaheve, mungesës së dashurive, mungesës së ndjenjave, thasethemeve, përplasjeve me njëri-tjetrin. Që tani të fillojmë të bëhemi miq dhe vëllezër. Ditët tona të madhnueshme mos t'i presim fëtyrëvarur dhe të mërzitur por me gëzim, me këngë, me ilahi, me lojëra të bukura... le ta zhvillojmë kulturën tonë, le t'u japim vend traditave tona.



# Ramazani nga gjuha e Profetit (a.s.)

Prof. dr. Ismail Lytqi Çakan

I dërguari profeti Muhamed (a.s.), mëshirë për botët, na e ka sqaruar muajin e ramazanit me të gjitha dimensionet që ka. Këtë muaj e kishte bërë shprehur ta quante edhe “muaji i myslimanëve”. Literatura e hadithit është e mbushur përplot me shumë thënie që rrëfohen prej profetit Muhamed dhe me raportimet e ndryshme të tyre. Do të qe e pamundur të mund t’i radhisim dhe t’i trajtojmë të gjithë ato hadithe brenda një artikulli. Për këtë arsye edhe ne, zgjodhëm një ligjëratë profetike (hutbe) në të cilën profeti Muhamed (a.s.) e ka sqaruar më gjerësisht muajin e Ramazanit. Ligjëratat profetike në fjalë është shkëputur nga një ndër veprat më eminente të literaturës së hadithit, më saktësisht nga vepra Sahih e dijetarit të hadithit Muhamed b. Ishak Ibn Huzejme (311 H / 923) <sup>(1)</sup>

Në kapitullin në lidhje me vlerat fetare dhe shpirtërore të muajit të Ramazanit, që gjendet në veprën e Ibn Huzejmes, pasi jepet zinxhiri i raportuesve që shkon pas deri tek Selman Farisiu thuhet: “I dërguari i Allahut, Muhamedi (a.s.), mbajti një ligjëratë në ditën e fundit të muajit Shaban në të cilën tha:

**“O myslimanë!**

**“Mbi ju ka rënë hija e një muaji madhështor dhe të bekuar. Ky është muaji në të cilin gjendet edhe nata e Kadrit, natë që është më e mirë se një mijë muaj së bashku.**

**Ky është muaji në të cilin Allahu u obligoi të agjëroni ditën dhe u begatoi me faljen e namazit (të teravisë) mbrëmjeve.**

**Kush punon ndonjë vepër të mirë në këtë muaj, fiton po aq sevape sa fiton personi që kryen një detyrë fetare të detyruar (farz) në një kohë tjetër përjashta këtij muaji. Ai që përmbush një farz në këtë muaj fiton sevapin e kryerjes së shtatëdhjetë farzeve në muajt e tjerë.**

**Ky është muaji i durimit, shpërblimi për të cilin është xheneti.**

**Ky muaj është muaji i bamirësisë, ndihmës dhe bazarisë.**

**Ky është muaji në të cilin besimtarit i shtohet begatia hyjnore materiale.**

**Kush i shtron iftare një personi që ka agjëruar, ky veprim bëhet shkas që t'i falen mëkatet që ka vepruar dhe të shpëtojë nga zjarri i xhehenemit. Ai me këtë rast do të fitojë po aq sevape sa fiton ai që ka agjëruar, por pa marrë nga sevapet e këtij të fundit."**

**Të pranishmit e pyetën:**

**- "Jo të gjithë ne i kemi mundësitë financiare që të mund të ushqejmë për iftar ata që kanë agjëruar..."**

Këtyre profeti Muhamed (a.s.) iu përgjigj duke u thënë se:

**"Allahu (xh.sh.), këtë sevap ia dhuron edhe atij personi që e gostit një person që ka agjëruar qoftë edhe me një hurmë apo disa gllënjka ujë apo qumësht"** dhe vazhdoi ligjëratën me këto fjalë:

**"Bëjini sa më shpesh katër gjëra në muajin e ramazanit. Me dy prej tyre fitoni kënaqësinë e Allahut, ndërsa prej dy të tjerave nuk mund të rrini larg edhe po të doni. Dy gjërat me të cilat do të fitoni kënaqësinë e Allahut (xh.sh.) janë të dëshmoni për njësinë e Allahut duke thënë shpesh La ilahe illallah dhe të kërkoni sa më shpesh nga Zoti juaj që tua falë mëkatet. Sa i takon dy gjërave të tjera nga të cilat nuk mund të qëndroni larg ato janë të kërkoni nga Zoti xhenetin dhe t'i luteni që t'u shpëtojë nga xhehenemi."**

Hytbja e profetit Muhamed, sikurse shihet, është shumë e qartë dhe e prerë, por gjithsesi ne jemi të mendimit se ka vlerë të ndalemi në disa pika të saja që na tërheqin vëmendjen.

## **ARDHMËRIA E VËRTETË**

Muhamedi (a.s.), e ka prezantuar në këtë ligjëratë muajin e ramazanit nga aspekti i rezultateve pozitive që u dhuron ai besimtarëve si në jetën personale, ashtu edhe në atë të botës së përtejme, sepse çdo mysliman pret diçka të re nga muaji i ramazanit që ai ka mbërritur. Këto aspirata të tijat sa kanë lidhje me jetën e kësaj bote, po aq, madje edhe më shumë, kanë lidhje me jetën në botën e përtejme, sepse e ardhmja e vërtetë për besimtarin është bota e përjetshme.

Nga ana tjetër, është një e vërtetë e njohur fakti që përmirësimi një e nga një i njerëzve shpie në një përmirësim të caktuar të shoqërisë, sepse bashkësitë njerëzore formohen nga individët. Kur ndahen me të tjerët momentet e gëzimit dhe haresë, kanë ndikim edhe më të madh, prandaj edhe hareja që të fal muaji i ramazanit, do ta rrethojë shoqërinë në atë masë që ajo ndahet me tjerët.

Profeti Muhamed (a.s.) na e ka bërë të qartë se nuk është domosdoshmëri që të kemi të ardhura financiare në mënyrë që të fitojmë sevape nga kryerja e bamirësive në muajin e ramazanit. Me këtë deklaratë të Tijën që ne e cituam në ligjëratën e mësipërme, ai sikur dëshironte të na mëson-te se **"Allahu nuk ka nevojë për pasuri të mëdha që të shpërndajë mëshirën e Tij të cilën njeriu mund ta fitojë edhe duke kryer një akt të thjeshtë bamirësie". Edhe t'i japësh personit që ka agjëruar për të çelur iftarin një gllënjë ujë apo qumësht mjafton që ne të përfitojmë nga kjo mëshirë hyjnore.** Sa është i rëndësishëm akti bamirës që kryhet, po aq i rëndësishëm është edhe qëllimi me të cilin ai kryhet. Prandaj, askënd nuk duhet ta kaplojë pesi-

mizmi po që se mendon se të ardhurat materiale që ka nuk do t'i mundësojnë të kryejë akte bamirësie. Në qoftë se ne do të tregojmë kujdesin e duhur në përmbushjen e dy akteve që na këshilloi profeti Muhamed (a.s.) që të kryejmë gjatë muajit të Ramazanit, të cilat qenë shprehja e dëshmisë dhe lutja që të na falen mëkatet, kuptojmë sesa e lehtë është për një besimtar të sinqertë që vetëm duke përdorur gjuhën e tij në ziqër të mund të fitojë shumë sevape.

Ndjesia e besimit në njësinë e Zotit dhe ndërgjegjësimi rreth kësaj të vërtete duhet forcuar dhe i duhen mundësuar të hedh rrënjë sa më thellë me anë të përsëritjeve të dëshmisë islame, sepse **"zemrat gjejnë qetësi vetëm kur e përmendin Allahun"**.

## **HUMBIA E RËNDË**

Sqarimi profetik që "nata e Kadrit që është më e mirë se një mijë muaj", qoftë shpërblimi hyjnor (sevap) që fitohet kur kryhen vepra të mira dhe bëhen bamirësi në këtë muaj, shpërblim që është shumëfish më i lartë kur të njëjtat akte dhe vepra kryhen në muajt e tjerë përjashta Ramazanit, tregojnë se muaji i ramazanit në vetvete është një "mundësi e jashtëzakonshme që na dhurohet". **E vërteta që njihet nga të gjithë është se,** momentet e jashtëzakonshme sjellin me vete edhe përgjegjësi të jashtëzakonshme. Teksa na tregon rreth vlerës së veprave të mira që bëhen në muajin e ramazanit, profeti ynë i dashur, na ka sqaruar njëkohësisht se personat që do të mbeten indiferentë ndaj këtyre mundësive do të përjetojnë humbje dhe dështime shumëfish më të rënda se ato që do të përjetonin në muajt e tjerë për shkak të indiferencës së tyre.

## **TË JESH POZITIV**

Meqë ra fjala në këtë temë, e konsiderojmë me vlerë të theksojmë se çdo veprim dhe akt që do të kryejmë duke u nisur nga respekti që ushqejmë për muajin e ramazanit, do të ketë pa tjetër një vlerë të veçantë. Shpresojmë që këto lloj aktesh bamirësie do të jenë plotësim për gabimet që njerëzit mund të kenë kryer gjatë jetës së tyre. Mirëpritja me nderim dhe respekt e çdo mjeti apo metode që mundëson të ndërgjegjësojë shoqërinë rreth temave fetare dhe domosdoshmërisë së jetës fetare, janë të përshtatshme që të arrijnë të masivizojnë nismat e këtilla. Qoftë edhe një muaj gjatë gjithë vitit, çdo ndërmarrje që do të ndihmonte në përthithjen më të shpejtë të atmosferës fetare brenda shoqërisë, do të ishte shumë më e efektshme që të mirëpritet duke u parë si një ftesë e shpërndarë në emër të veprave të mira.

Ata që meritojnë me të vërtetë për të ndjerë keqardhje, janë individët tek të cilët nuk dallohet as ndryshimi më i vogël për sa i përket ndjesive dhe mënyrës së vjetër të jetesës, të cilët nuk ndikohen qoftë edhe një grimë nga atmosfera e muajit të ramazanit. Më mjeranë se personat në fjalë janë ata individë që nuk e durojnë dot formën e re të bukur që sjell atmosfera e jetës së përditshme gjatë këtij muaji dhe përhapjen e saj në shtresat e ndryshme të shoqërisë, madje përpiqen të vënë në dukje shqetësimin që ndiejnë nga kjo atmosfera e përshpirtshme.



# Sadakaja

Jetmir Selmani

## urë lidhëse

### mes të pasurit dhe nevojtarit

Islami, përveçse ka vendosur rregulla për mirëmbajtjen e trupit dhe shpirtit, ka vendosur po ashtu rregulla edhe për mirëmbajtjen e shoqërisë.

Një ndër rregullat që luan rol të rëndësishëm në ruajtjen, ngritjen, zhvillimin, harmoninë dhe afërsinë ndërmjet pjesëtarëve të shoqërisë është edhe zekati apo sadakaja.

Njerëzit janë shumë të dhënë pas pasurisë së kësaj bote. Edhe po të jetë aq i pasur sa të ketë në dorë të gjitha pasuritë e botës, njeriu përsëri ka frikë se mos i harxhohen, nëse e ndan një pjesë të asaj pasurie për nevojtarët. Ekziston mundësia që në përpjekjet për të arritur deri tek kamja, njeriut t'i shndërrohet në pasion dëshira e tepruar për pasuri. Kjo gjendje e shndërron njeriun deri në atë pikë, sa e bën të mos njohë askënd përreth tij dhe të mos vlerësojë asgjë tjetër përveç materiales. Disa njerëz bien në adhurim të pronës, të mallit apo të pasurisë dhe mendojnë se kamja që zotërojnë është e pafund, e përhershme. Ndërkohë, zekati apo sadakaja e shmang pasionin e pasurisë e robërinë që ajo shkakton, duke e orientuar njeriun drejt një adhurimi, që e afron jo vetëm me Allahun (xh.sh.), por edhe me njerëzit.

Shumë njerëz nuk japin sadaka ngaqë kanë frikë se mos u pakësohet pasuria, por në Kuranin Fisnik, Zoti i madhëruar na siguron se pasuria jo vetëm që nuk pakësohet, por madje shtohet edhe më tepër. Në Kuranin Famëlartë, Allahu thotë: **“Djali ju frikëson me skamje e varfëri dhe ju urdhëron të bëni vepra të pamoralshme, kurse Allahu ju premton faljen dhe mirësinë e Tij.”** (el-Bekare; 268)

**“Kush do t’i japë Allahut një hua të bukur, që Ai t’ia kthejë shpërblimin shumëfish? Allahu e shtrëngon (riskun) dhe e liron; tek Ai do të ktheheni.”** (el-Bekare; 245). Në këtë ajet, Zoti nuk thotë “jepni pasuri”, por thotë “i jepni Zotit hua”, me qëllim që njeriu të sigurohet se mallin që po jep, përpara se t’ia japë nevojtarit ia ka dhënë Zotit, i Cili do t’ia kthejë më pas të shumëfishuar. Në lidhje me këtë, Pejgamberi (s.a.v.s.) ka thënë: **“Dhënia nuk e pakëson pasurinë”**. Po ashtu, ndodhi një herë që Aisheja (r.a.), para se të jepte sadaka, mori monedhën dhe e parfumosi. Kur e pyetën se përse veproi ashtu, ajo tha: **“E bëj këtë, sepse kjo monedhë do të bjerë në dorë të Zotit para se të ketë rënë në dorë të nevojtarit.”**

Kush jep pasuri në rrugë të Zotit, Ai do t’ia kthejë atë pasuri deri në 700 fish e më tepër.

***“Ata që shpenzojnë pasurinë e vet në rrugë të Allahut, i shëmbëlajnë atij që mbjell një kokërr nga e cila dalin shtatë kallinj, ku secili kalli ka nga njëqind kokrra. Allahu ia shton (shpërblimin) edhe më tepër kujt të dëshirojë; Allahu është Mirëbërës i madh dhe i Gjithë-dijshëm.”*** (el-Bekare; 261)

Në një farë mënyre, zekati është urë lidhëse mes myslimanëve. Ai që ndihmon nevojtarët në një shoqëri, ka krijuar në të njëjtën kohë edhe lidhje të ngrohta me ta. Po ashtu, nëse u vjen në ndihmë edhe atyre që janë kapluar nga probleme të ndryshme, ai ka arritur të fitojë zemrat e tyre. Në lidhje me këtë, po përmendim rastin e Safvan bin Umeje, i cili thotë: *“Muhamedin e urreja aq shumë, sa që nuk urreja tjetërkënd më shumë se atë, por ai vazhdonte të më jepte derisa fillova ta dua.”* Pra, le ta mësojmë edhe ne këtë mënyrë sjellje të Pejgamberit (a.s.) për t’i fituar njerëzit: nëse dikush të urren, jepi atij derisa ai të fillojë të të dojë. I Dërguari i Allahut thotë: *Bëjini dhurata njëri-tjetrit, që të mund t’ju shtohet dashuria.*

Sadakaja është një ndër treguesit më të qartë të ndarjes në Islam. Ai që jep sadakanë, në një farë mënyre ka dëshmuar ekzistencën e Allahut, si dhe ka forcuar lidhjet sociale. Sadakaja nuk është vetëm një adhurim i lidhur me pasurinë, por ekzistenca e saj përfshin çdo individ të shoqërisë e po ashtu është edhe preteksti i ekzistencës së jetës sociale. Ashtu si kujdesja për familjen, sadaka konsiderohet edhe ndihma që u ofrohet kafshëve e shpezëve. Po ashtu, sadaka konsiderohet edhe buzëqeshja drejtuar vëllezërve në fe.

### **MYSLIMANI NUK ËSHTË NJË INDIVID QË JETON VETËM PËR VETEN E TIJ...**

Myslimani nuk është një individ që jeton vetëm për veten e tij, por një rob i Zotit që jeton për shoqërinë, aq sa ndan me ta si dhimbjet ashtu edhe gëzimet.

S’duhet harruar se dhënia e zekatit-sadakaja ka dobi të shumta, mes të cilave mund të rendisim ato ekonomike, politike e madje edhe edukative. Një gjë e tillë ndikon shumë në formimin, edukimin, karakterin, psikologjinë dhe në mënyrën e të menduarit. Një njeri i mirë tregon: *“Sa herë që shihja të varfër, më vinte në mendje babai me zarfet në dorë, duke shkruar emrat e nevojtarëve. Ditën e parë të Ramazanit ai hynte në shtëpi me zarfet, me regjistrit dhe të hollat në dorë. Të gjithë ne e ndihmonim në shkruarjen e emrave dhe në ndarjen e të hollave për çdo nevojtar.”*

Prof. Xhasim El-Mutava tregon: Një ditë, një grua nga Kuvajti më tregoi diçka të çuditshme. Ajo më tha: *“Kur isha e vogël, shtëpia jonë ishte prej qerpiçi. Unë dilja në oborr dhe luaja gjithë ditën. Një ditë, gjyshi hyri në oborr me një qese të mbushur në dorë dhe filloi të kërcente i gëzuar e*

*i lumturuar. Unë mendova se mos ndoshta atë ditë mund të kishte fituar shumë para në tregtinë e tij, ose i kishte ardhur ndonjë lajm i gëzuar. Kur e pyeta në lidhje me shkakun e gëzimit, ai më tha: Sot është dita e parë në jetën time që m’u mundësua të jap zekatin e pasurisë!”*

Kur Xhafer bin ebi Talibi vdiq, la pas tre vajza. I Dërguari (a.s.) i mori në krahë vajzat e tij dhe iu drejtua të pranishmëve: *“Kush do t’i përkrahë vajzat e Xhaferit?”* Pamë tre vetë që u ngritën menjëherë dhe thanë: unë, o i dërguari i Allahut, unë o i dërguari i Allahut. Të tre ishin njëri më i varfër se tjetri... kurse në ditët e sotme, na vdes vëllai prej nëne a prej babai dhe nuk duam t’ia dimë për fëmijët e tij. Mundet që fëmijët e tij të dalin e të lypin në rrugë, ndërsa ne na interesojnë vetëm fëmijët tanë. Pra, qoftë fshehtas apo haptas, sadakaja duhet të jepet. Gjëja e mirë e sadakasë së dhënë haptas është se në këtë mënyrë i nxit edhe njerëzit e tjerë për të ndihmuar nevojtarët. Kurse sadakaja e dhënë fshehtas është më e dashur te Zoti i Madhëruar, sepse sikundër thuhet edhe në një hadith *“Shtatë lloj njerëzish do të qëndrojnë nën hijen e Zotit, ditën kur nuk do të ketë hije tjetër përveç hijes së Tij... dhe një njeri, i cili jep sadaka ashtu që dora e majtë nuk e di se çfarë dha e djathta.”*

Duhet pasur parasysh se, në qoftë se ti nuk do që të japësh, Zoti i Madhëruar do të ta marrë në një mënyrë tjetër. Të ndodh diçka për të cilën do të të duhet të shpenzosh më shumë nga sa do të mund të kishe dhënë me dëshirën tënde, ose të bëhet fëmija haram dhe t’i harxhon paratë në bixhoz apo në vende të ndyta! Po ashtu, në një hadith tjetër, Pejgamberi (a.s.) thotë: *“Sikur të kisha florinj sa kodra e Uhudit, do t’i kisha shpërndarë pa kaluar as tri ditë”, ndërsa ne, edhe pse mund t’i kemi garderobat të mbushura me rroba që nuk i përdorim, nuk na shkon ndërmend t’ua japim nevojtarëve!*

Në përfundim, një përkujtim për ata që vuajnë nga mosdhënia e sadakasë për arsye të ndryshme... Pejgamberi (a.s.) thotë: *“Në agim të çdo dite zbresin dy melekë, njëri prej të cilëve thotë: ‘O Zot, shtoja pasurinë atij që jep’, ndërsa tjetri thotë: ‘O Zot, shkatërroja pasurinë atij që nuk jep’.”*

Zoti na ruajtë nga çdo e keqe e mundshme! Na bëftë njerëz, që kanë mundësi të japin, na bëftë prej atyre që e kanë dorën vazhdimisht të shtrirë...

S’ka dyshim që sistemi i zekatit-sadakasë është një mrekulli sociale më vete. Nëse do ta zbatonim këtë sistem në shoqëritë tona ashtu siç kërkon dhe porosit vetë Zoti i Madhëruar, atëherë në asnjë shoqëri nuk do të qe e nevojshme të luftohej varfëria, vjedhja e anomali të tjera si këto, sepse gjithçka do të ishte e rregulluar më së miri dhe në harmoni.

# PENDIMI

*Jashar Kandemir*

Djali e mashtron njeriun dhe e orienton për të bërë mëkat.

Sepse djalli është armiku i njeriut.

Edhe njerëzit me besim të fortë gabojnë nga shkaku i joshjeve të shejtanit.

Shkurtimisht, të gjithë mund të mëkatojnë përveç atyre që i mbron Allahu.

Çdo mëkat që bëhet, lë gjurmë në zemër, si një pikë e zezë. Nëse robi i largohet mëkatit që ka bërë, i drejtohet Allahut dhe kërkon falje nga Ai, zemra e tij e arrin përsëri pastërtinë e mëparshme. Por nëse nuk vepron kështu dhe vazhdon të bëjë mëkate, pikat e zeza në zemër i shtohen. Ajeti "Jo, mëkatet që bënë ata ua kanë nxirë zemrat", flet për këto pika të zeza.

## LARGIMI NGA MËKATET E VOGLA

Njerëzit në përgjithësi nuk u japin rëndësi mëkateve të vogla dhe nuk e shikojnë si problematike kryerjen e tyre. Ky konceptim bëhet shkak që të shtohen mëkatet.

Shërbëtori i Pejgamberit, Enes bin Malik shpreh me keqardhje se në vitet pasi ndërroi jetë i Dërguari i Allahut (a.s.), njerëzit filluan të neglizhonin në këtë çështje dhe i shikonin si të thjeshta e të parëndësishme veprat që në kohën e të Nderuarit tonë llogariteshin si mëkate të mëdha.

Por i Dërguari i Allahut (a.s.) e këshilloi bashkëshortën e tij të dashur, Aishen (r.a.) që të largohej nga mëkatet që njerëzit i nënçmonin dhe i kujtoi asaj se ka ëngjëj të cilët i shikojnë dhe i rregjistrojnë mëkatet e vogla.

Ai lajmëroi se mëkatet që duken të vogla, e gëzojnë shumë shejtanin e mallkuar.

## DUHET TË PENDOHEMI SA JEMI NË KOHË

Ja, për këtë arsye Allahu Teala i urren mëkatet dhe dëshiron që ne t'ua kthejmë shpinën atyre,

Dëshiron që t'i kthehemi Atij duke u penduar me gjithë zemër dhe duke ndjerë keqardhje,

Ai pret që t'i përgjërohemi, ashtu që të na falë,

Dhe thotë se vetëm atëherë mund të na i falë veprat tona të këqija.

Sepse vetëm Allahu është ai që i pranon pendimet e robërve, që ua fal të këqijat dhe i cili e di çdo gjë që veprojnë.

Meqë e vërteta është kjo, atëherë nuk duhet të vonohemi për t'u penduar, ashtu që t'i kthehemi e t'i dorëzohemi Allahut para se të vijë vdekja.

Kur të mos veprojmë kështu, duhet të dimë se askush nuk ka fuqi ta mbrojë njeriun nga problemet që mund t'i ndodhin në të ardhmen.

Por sa keq që shumë njerëz janë tolerantë në këtë çështje, vazhdojnë të bëjnë vepra të këqija deri në çastin e vdekjes, dhe kur u vjen vdekja kërkojnë të falen, duke thënë "Tani po pendohem".

Por Allahu Teala kurrë nuk i pranon pendimet e atyre që veprojnë kështu.

## SHEMBËLLTYRA PROFETIKE

Pejgamberi ynë i Nderuar ka qënë shembull për ne edhe në këtë çështje. Edhe pse ishte përgëzuar me faljen e mëkateve, ai pendohej duke kërkuar falje nga Allahu nganjëherë **shtatëdhjetë herë në ditë** dhe nganjëherë **njëqind herë në ditë**.

Madje nganjëherë edhe në vendin ku ishte ulur i përgjërtoj Allahut duke thënë njëqind herë:

“O Zot! Im! Më fal mua dhe ma prano pendimin tim! Me të vërtetë Ti je mëshiruesi që i pranon pendimet”.

Njeriu duhet të turpërohet nga Allahu për të keqen që bën, duhet ta vrasë ndërgjegja dhe të pendohet për gabimin që ka bërë.

Mënyra më e mirë për t’u bërë pishman është pendimi.

Kur robi të bëjë ndonjë mëkat, duhet të lutet ‘O Zot, të lutem më fal!’

Kjo quhet **istigfar**.

Të pendohesh do të thotë të ndjesh keqardhje për mëkatet që ke bërë.

### ALLAHU E DO ATË QË PENDOHET

Allahu gëzohet shumë kur robi pendohet. I Nderuari ynë këtë fakt e përngjason kështu: Kur robi pendohet, Allahu gëzohet më shumë se sa njeriu i cili e humb devenë e tij në shkretëtirë bashkë me ujin e ushqimin dhe e gjen atë ndërkohë që po ballafaqohet me vdekjen.

Përse pendimi i një njeriu e gëzon kaq shumë Allahun Teala?

Për shkak të mëshirës së madhe që ka për robin e Tij.

I Dërguari i Allahu thotë se për shkak të kësaj dashurie dhe mëshire, Allahu i Lartësuar pret tërë natën që t’ia pranojë pendimin atij që ka bërë mëkat ditën, dhe pret tërë ditën që t’ia pranojë pendimin atij që ka bërë mëkat natën.

### DERA E PENDIMIT ËSHTË GJITHMONË E HAPUR

Nuk ka ndonjë kohë të caktuar për t’u pastruar duke u penduar.

Një njeri mund të pastrohet nga mëkatet duke u penduar, përderisa nuk ka filluar të japë shpirtin. Një pendim i bërë me sinqeritet i fshin dhe i shkatërron të gjitha mëkatet përveç hakut të robit.

Ndërsa haku i robit mund të falet vetëm duke u pastruar apo duke u bërë hallall.

Në kohën e Pejgamberit tonë të Nderuar, një grua kishte bërë zina. Ajo u pendua shumë për atë që kishte bërë. Peshën e mëkatit që kishte bërë e ndjeu në zemër, shkoi disa herë te i Dërguari i Nderuar dhe duke këmbëngulur i tha se dëshironte ta merrte ndëshkimin në këtë botë dhe se nuk dëshironte ta linte për në botën tjetër. Ajo u ndëshkua.

Njëri prej sahabëve të rëndësishëm e nënvlerësoi gjendjen e gruas. Hz. Pejgamber nuk e pa të drejtë këtë sjellje të tij. Ai tha se ajo grua është penduar me gjithë zemër dhe nëse pendimi i saj do t’u shpërndahej

shtatëdhjetë banorëve të Medinës, do të mjaftonte për t’u falur të gjithë ata.

Ajo që e bën të vlefshën pendimin është:

Të të shqetësohet zemra dhe të pendohesh për shkak të mëkatit që ke bërë,

Mëkatari duhet ta lërë plotësisht atë sjellje të keqe,

Dhe të japë fjalën se nuk do ta bëjë më atë asnjëherë.

Nëqoftëse çështja ka lidhje me hakun e robit, atëherë ai duhet t’i kërkojë atij të cilit i ka hyrë në hak që ai ta falë.

### TË DIMË SE KA NJË ZOT

Nëse myslimani largohet nga mëkatet e mëdha, Allahu mund t’ia falë mëkatet e vogla që ka bërë, sepse Ai është bujar në çështjen e faljes.

Të dish se ka një Zot që t’i fal mëkatet dhe të kërkosh falje sinqerisht duke iu drejtuar Allahut, kjo mjafton për t’i fshirë mëkatet.

Sipas asaj që na ka njoftuar i Nderuari ynë, kur një rob i përgjërtoj Zotit ‘O Zot! Unë bëra një mëkat, të lutem më fal!’ pasi ka bërë një mëkat me dashje, Allahu Teala thotë:

“Domethënë robi im e di se ka një Zot që mund t’ia falë mëkatin apo ta ndëshkojë. Atëherë edhe unë e fal robin tim”.

Nëse ai rob jeton për një kohë pa bërë mëkate, pastaj bën mëkat përsëri dhe vepron në të njëjtën mënyrë duke iu drejtuar Zotit dhe duke i kërkuar falje, Allahu Teala kënaqet nga robi për shkak se iu drejtua Atij dhe e fal atë.

Nëse robi e kupton gabimin pasi të bëjë një mëkat, e kujton Zotin, i drejtohet Atij dhe pendohet, kjo e kënaq shumë Allahun dhe Ai thotë “Tashmë robi im le të bëjë ç’të dojë”.

Ky përgëzim hyjnor u sjell fllade mëshire zemrave besimtare dhe i ndalon mëkatarët që të bien në batakun e pesimizmit.

### PO NËSE NUK MË MJAFTOJNË MIRËSITË E MIA!

Allahu i Lartësuar ka premtuar se mirësive do t’u japë sevape të shumfishuara.

Ka thënë se nganjëherë një mirësi do ta shpërblejë me **dhjetëfishin** e saj.

Po ashtu ka thënë se nganjëherë do t’i japë sevap nga **dhjetëfish** e deri në **shtatëqind fish**, madje edhe më shumë.

Kjo masë mëshire tregon se një pendim i sinqertë mund ta fshijë dhe ta zhdukë një mëkat edhe nëse është sa malet.



# Fatihaja e jetës

*Ymit Shimshek*

Në mbrëmje shejtani nuk u kthye. As në ditën tjetër. As një ditë më pas. Edhe Xhemi, që prej asaj mbrëmjeje nuk u kthye më. Kishte shkundur ndyrësitë e mbetura nga diskutimi i volitshëm që kishte pasur me shejtanin, kishte hapur melekët e mendjes aq sa kishte pasur mundësi.

Shpesh, kudo që të ndodhej, Xhemi i mbyllte për një çast sytë e tij, priste që çdo gjë të errësohej dhe të humbiste, përpiqej të harronte botën ku jetonte, si të donte t'i fshinte nga truri të gjitha dhe dalëngadalë mësohej me errësirën dhe varfërinë, duke përdorur të gjithë forcën e tij. Më pas, kur ndodhej në mes të errësirës, të dhunës, varfërisë, i çelte sytë sërish.

Përsëritje botë!

Por, një botë e huaj. Xhemi ndodhet mbi një planet të çuditshëm. Përpara tij qëndronte një diell që lindte për herë të parë, mbi detin që e shihte për herë të parë. Mbi një anije në të cilën hipte për herë të parë. Frymëmarrje e parë. Shikim i parë.

Filizi i çajeve!

Nuhatja e parë. Gëlltitja e parë. Një kontrollim një për një i shijes së secilës, duke e numëruar gllënjekën pikë për pikë dhe pikën grimcë për grimcë.

Përpara Xhemit ka fytyra. Dy të mëdha, një të vogël. Por para së gjithash, ç'fytyrë?

Foshnja që është në prehrin e nënës po luan me babain. Duart e njoma të foshnjës lënë shenja gishtërinjsh

në syzet e të atit. Po shenja e duarve?

Babai luan me duart e njoma. I puth... i puth... Por, puthje ç'do të thotë? Vetulla që rrethojnë buzët dhe që nuk kanë asnjë lidhje me kockat. Lëviz me nervat e fytyrës. Nervi i fytyrës merr sinjal nga mendja. Vetullat rrudhen. Buzët rrumbullakosen, mbyllen dhe hapen me një lëvizje të çastit. Më pas diçka përhapet prej anëve të buzëve drejt thellësive të shpirtit. Nuk është aspak diçka e nevojshme për të jetuar. Po sikur të mos ishte puthja në jetë?

Nëna qesh... Babai qesh... Foshnja qesh... Foshnja?... Të qeshësh?...

Foshnja akoma nuk di të flasë. Foshnja nuk di të ecë. Por të qeshurën e di. Foshnja di të qeshë që kur lind!

Pse nuk mund ta shoh unë, për të gjetur këtu një emëruer? Zëri i shejtanit oshëtin në veshët e Xhemit. Një dritërimë nga debati i disa ditëve më parë. Bota po errësohej përsëri. Ngjyra e fytyrës së foshnjës po humbiste, muskujt e poshtëm mbetën prapa... muskujt dhe gjaku. Më pas edhe ato ikën, në mes mbeti vetëm një kokë e tharë me gjithë anët e frikshme të saj.

Telefoni celular i Xhemit jep alarmin. Fillim ore. Ushtrimet e meditimit fillojnë përsëri. Xhemi mbyll sytë. Bota errësohet. Përsëri dhunë, varfëri, dhunë, varfëri... Pastaj, çilembyll sytë, një lindje e çastit.

Shiko tani kockat, si e ndërtojnë, më pas e veshin atë me mish.

Në një anë kocka e çenes së poshtme të foshnjës që



ulet e çohet si një menteshë, dhe koka e tij që sillet herë tek nëna dhe herë tek babai.

Vetullat mblidhen përsëri mbi kocka. Majat lidhen për eshtra. Mes vetullave dhe trurit rreshtohen malet e nervave të fytyrës. Damarët shtrohen, ndërse gjaku pompohe deri në qoshet më të largëta. Në gropat e syve vendosen një çift sysh blu, sy që lëvizin brenda vendit të tyre, sy që shndrisin. Sytë fshihen me një pastrues lens nga pjesa e sipërme, në pjesën e poshtme përgjatë së cilës shtrihen tubat e kullimit dhe pjesa tepruese kalohet në boshllëkun e tubit të nxehtësisë. Sipër tyre zgjaten kapakët e syve, sipër me qerpikë që vazhdimisht fshihen, pastrohen dhe shndrisin pjesën ngjyrë blu më të bukur në botë. Më pas, e gjithë fytyra vishet dhe zbukurohet me një lëkurë të butë si pambuku,

Faqet topolake, buzët trëndafil, sytë e vegjël. Foshnja qesh.

Foshnja nuk di të ecë. Nuk di të flasë. Por të qeshë di.

Foshnja, ashtu sikurse di të qeshë, ashtu di të lexojë edhe buzëqeshjen.

Nëna qesh, foshnja jep përgjigje.

Babi qesh, foshnja jep përgjigje.

Qeshin.

Tani fillon edhe pjesa më e bukur e bisedës, kështu pati thënë Xhemi, por në mes kishte hyrë namazi, më pas Shejtani ishte zhdukur dhe nuk shihej. Xhemi donte ta merrte përpara, ta kapte për jake, ta godiste në kokë dhe t'i fliste.

- Kush të bën të qeshësh?

Kot është koka me shumë vetulla? Kot shtrihen rretjet e nervave? Kot zbukurohen të gjitha këto në lëkurën e fytyrës së foshnjës? Kush e krijoi kokën? Kush i ngjyrosi sytë bojëqielli? Kush e krijoi këtë buzëqeshje mbi gjak dhe vetulla?

Le të vijë Shejtani të mbledhë të gjithë ndihmësit e tij prej xhindëve dhe të gjejë një emërues të të gjitha këtyre punëve!

Mos ato gjetën krijues si Allahu dhe ato gjëra ia përngjasuan krijimit të tij?

Dy pika loti rrodhën nga syve e Xhemit.

Ai është që të bën të qeshësh, por edhe të qash

Nuk mjafton të gjesh emëruesin, ka edhe një pyetje që pret përgjigje.

Pse?

Pse një foshnjë mëson të qeshë para se të flasë, para se të ecë, para se të mësojë çdo gjë në këtë botë?

Pse e bën një gjë të tillë Ai që e bën të qeshë atë? Pse i bën të qeshë nënën dhe babain? Pse para së gjithash mësohet të qeshësh në këtë botë? Le të shkojmë edhe më tej. Përse Ai qe e sjell njeriun në këtë botë, në fillim ia mëson të qeshurin dhe më pas e sjell në jetë?

Në kujtesën e Xhemit vegoi dita kur vajza erdhi në

jetë. Ishin në spital. Foshnja kishte ardhur në këtë jetë me operacion dhe flinte ëmbëlsisht nën ndikimin e ilaçit. Në fytyrë i lexohej qartë një buzëqeshje. Kishte gjysmë ore që kishte lindur dhe sigurisht që për këtë gjysmë ore s'kishte se kush t'ia mësonte të qeshurën!

Xhemi filloi t'i jetonte përsëri ato ndjenja që i kishte shfaqur ajo buzëqeshje. Një qenie e paqenë deri para gjymë ore, kishte hyrë në botën e Xhemit dhe të së shoqes dhe i kishte përqaftuar ata me gjithë ngrohtësinë e saj. Ajo qenie që nuk kishte qenë para gjysmë ore, tani ishte në botën e të dyve. Ajo buzëqeshje e vogël u jepte atyre atë që e gjithë bota nuk ia jepte dot.

Ditët e mëvonshme kishin kaluar pothuajse si në një garë për të qeshur dhe për të bërë të qeshësh.

- E sheh? Shiko si po qesh babai yt, ty po të qesh.

- Eja e shiko, përsëri po qesh!

- Eja e jepi një buzëqeshje nënës tënde

Kur foshnja i përgjigjej buzëqeshjeve të tyre, ata çuditëshin.

Më parë këtë e kishin quajtur një rastësi, por sapo ngjarja përsëritej nuk mbeti asnjë dyshim për ta. Tani foshnja jo vetëm qeshte, por edhe u përgjigjej buzëqeshjeve. Ajo e ndjente kur të tjerë i buzëqeshnin.

Foshnja që nuk dinte asgjë, edhe sikur ta kishte mësuar buzëqeshjen në një botë tjetër, si mund ta dinte se çfarë pamje do te merrte fytyra e tjetrit? Si ishte e mundur që foshnja e lindur vetëm para gjysmë ore dinte ta lexonte si një libër fytyrën e njeriut?

Xhemi nuk priti orën. Mbylli përsëri sytë dhe provoi të vinte përsëri në jetë. Këtë herë nuk do të vinte në këtë jetë, por do të provonte të dërgonte veten.

Çdo gjë u errësua dhe humbi. E gjithë bota u zhduk. Në mendjen e Xhemit ishin vetëm errësirat shumëkatëshe. Pastaj, në mes errësirash u duk një botë blu.

Xhemi nuk hyri në brendësinë e botës. Ai solli në kujtesën e tij vetëm një botë blu ku donte të futej. Mendoi sikur po hidhte hapin e parë në këtë botë si një foshnjë, dhe pastaj u mundua të bënte një listë të gjërave që i duheshin.

Ka të ftohtë, mërdhin, ka temperature, uri. Sëmundje, ngricë, shi, furtunë, qenie të gjalla, të vdekura...

U mundua të mendonte, që të merrte masa për të përballuar çdo lloj rreziku.

Xhemi nuk mund të mendonte asgjë nga këto me një mendje të boshatisur, pastaj u kthye në botën tonë pa asnjë zgjidhje.

Ja pra, ishte pa një foshnje të ardhur në këtë botë. Kishte një nënë, një baba, si dhe një të qeshur, kaq ishin të gjitha.

Në atë çast Xhemi kujtoi ato që këndonte në namaz. Edhe fatihaja e jetës, si ajo e Kur'anit, fillonte me emrat Rahman dhe Rahim.



# 10 SËMUNDJET QË SHËRON AGJËRIMI

Jonida Tashi

Shkenca e sotme ka zbuluar se agjërimi forcon sistemin imunitar tek agjëruesi, për t'u bërë ballë shumë sëmundjeve. Agjërimi është një adhurim i veçantë tek Allahu i Lartësuar. Ai është një prej detyrimeve me të cilat nuk u dallua vetëm umeti mysliman, por edhe bashkësitë e tjera fetare para nesh. Kjo tregon rëndësinë e tij. Më poshtë do të njihemi me rolin e agjëritimit në shërimin e shumë sëmundjeve, të vërtetuara në sajë të eksperimenteve reale.

## 1. OPERACIONI

Agjërimi kryen funksionin e kirurgut duke eliminuar prej trupit qelizat e shkatërruara dhe të dobëta. Uria që shoqëron agjërimin vë në lëvizje aparatet e brendshme të trupit duke konsumuar qelizat e dobëta për të përballur këtë uri, kështu që trupit i jepet rasti i vulltshëm të rikthejë gjallërinë dhe aktivitetin e tij. Gjithashtu, agjërimi është mbrojtje për trupin prej shumë tepricave të dëmshme si për shembull: gurët, shtresat e mishit, gjëndrat dhjamore, madje edhe vetë plagët në fillimin e formimit të tyre.

## 2. SËMUNDJET E LËKURËS

Agjërimi është i dobishëm në kurimin e sëmundjeve të lëkurës pasi ai pakëson përqindjen e ujit në gjak. Pakësimi i tij në lëkurë sjell forcimin e imunitetit të lëkurës dhe rezistencë ndaj mikrobeve dhe sëmundjeve epidemike, pakësimin e sëmundjeve të lëkurës, të cilat përhapen në sipërfaqe të mëdha të trupit, pakësimin e sëmundjeve alergjike duke i vënë kufi problemeve të lëkurës së yndyrte. Me agjërimin pakësohen sekrecionet helmuese të zorrëve dhe zvogëlohet përqindja e thartimit që shkakton puçrra

të vazhdueshme.

## 3. DHIMBJET E KYÇEVE

Kjo është një sëmundje shumë e përhapur, sidomos në moshat 30-50 vjeç. Problemi i vërtetë është se mjekësia e sotme ende nuk ka arritur në ndonjë mjekim për këtë sëmundje. Eksperimentet praktike në Rusi kanë vërtetuar se agjërimi gjate tri javëve të njëpasnjëshme, ndihmon trupin që të shkarkojë mbeturinat dhe lëndët helmuese, shkaktare të kësaj sëmundjeje. Këto eksperimente janë bërë mbi një grup të sëmurësh dhe rezultatet kanë qenë të kënaqshme.

## 4. TROMBOZA

Agjërimi ka ndikim të madh në mbrojtjen prej trombozës së zemrës dhe trurit. Shumë studime shkencore e mjekësore kanë vërtetuar se agjërimi zvogëlon përqindjen e yndyrave në trup, duke zvogëluar kështu kolesterolin. Kjo lëndë ngjitet në muret e damarëve duke sjellë rritjen e përqindjes së tij dhe rritjen e yndyrave në trup, si rrjedhim çon në ngrirjen e damarëve duke shkaktuar edhe hollimin e damarëve të zemrës dhe të trurit.

## 5. DIABETI

Agjërimi është një rast i mire për të zvogëluar përqind-

jen e sheqerit në gjak në pikën më të ulët të tij. Ai i jep gjëndrave të pankreasit një rast të mire për pushim, sepse detyra e tij është të prodhojë insulinë, e cila e shndërron sheqerin në yndyra që depozitohen në inde. Kur ushqimi e kalon masën e insulinës së sekretuar, pankreasi lodhet dhe, si rrjedhojë, e ndërpret aktivitetin e tij, kështu sheqeri grumbullohet në gjak duke rritur përqindjen e tij gradualisht, derisa shfaqen simptomat e sëmundjes. Për këtë arsye, klinikat e ndryshme kuruese, në tërë botën, praktikuan agjërimit si metodë kurimi për të sëmurët me diabet, në periudha të ndryshme kohe, në varësi të gjendjes shëndetësore të tyre. Kjo metodë ka pasur rezultate dhe sukses të kënaqshëm pa përdorur ilaçe të tjera.

## 6. PËRDHESI

Sëmundja e mbretërve, ndryshe quhet edhe "përdhësi", krijohet nga ngrënia e tepërt, sidomos e mishit. Shkaku është defekti që ndodh në grumbullimin e proteinave të gjendura në mishra, sidomos në mishin e kuq, gjë që çon në grumbullimin e acidit të urinës, sidomos në nyjën e gishtit të madh të këmbës. Gjatë prekjes së nyjës me këtë sëmundje ajo enjtet dhe skuqet duke u shoqëruar me dhimbje të mëdha. Ndoshta masa e kripërave në urinë mund të rritet e pastaj të grumbullohet në veshka duke formuar gurë. Pakësimi i masës së ushqimit është kurimi kryesor i kësaj sëmundjeje shumë të përhapur.

## 7. INFEKSIONET

Dobia e agjërimit shfaqet në mënyrë të hapur tek të sëmurët me infeksionet periodike të tretjes e në krye të tyre janë: infeksioni periodik i stomakut, vështirësia e tretjes dhe trazimi i zorrëve. Agjërimit i jep këtyre organeve mundësinë e pushimit për më se një muaj. Gjithashtu, ai ka ndikim të madh edhe në kurimin e tyre, madje edhe të sëmurët me kolonë përfitojnë shumë prej agjërimit. Tek të sëmurët me alergji, agjërimit dhe racionalizimi i ushqimit ndihmojnë të largohen shumë sëmundje alergjike. Pushimi i aparatit tretës është i domosdoshëm për të shëruar shpejt disa sëmundje.

## 8. SËMUNDJET E ZEMRËS

Agjërimit ka një vlerë të madhe për shumë sëmundje të zemrës, pasi 10 për qind e gjakut të pompuar nga zemra shkon në aparatit tretës gjatë procesit të tretjes. Kjo sasi zvogëlohet gjatë agjërimit, sepse nuk kemi proces tretjeje gjatë ditës. Kjo do të thotë më pak lodhje dhe më shumë qetësi për muskujt e zemrës.

## 9. DHJAMOSJA

Agjërimit, pa e tepruar, është mjeku më i afte dhe më i lirë. Ai çon në uljen e peshës, me kusht që ta shoqërojë normaliteti në sasinë e ushqimit në kohën e iftarit dhe njeriu të mos e fryjë stomakun me ushqim e lëngje pas agjërimit. Vetë profeti Muhamed (a.s) e fillonte iftarin me disa kokrra hurma ose me pak ujë e pastaj ngrihej dhe falte namazin e akshamit. Kjo është tradita dhe metoda më e mirë për atë që agjëron, që ndërpritet nga ushqimi e lëngjet për orë të tëra. Sheqeri i gjendur në hurma i sjell njeriut ndjesi ngopjeje, pasi gjaku e thith shumë shpejt e në të njëjtën kohë i jep trupit energjinë e nevojshme për të vazhduar aktivitetin e mëtejshëm. Por nëse e fillon ngrënie pas një

urie të gjate duke ngrënë mish e bukë, atëherë tërë këto ushqime duan një kohe të gjate të treten e një pjesë e tyre të shndërrohet në sheqer që si rrjedhim njeriu të ndihet i ngopur. Kështu njeriu vazhdon të mbush stomakun e tij mbi masë, duke menduar se ai akoma është i uritur.

## 10. BOX: KURIM PSIKOLOGJIK

Agjërimit nuk shëron vetëm sëmundjet e trupit, por ai është edhe një kurim i mirë psikologjik. Më poshtë po paraqesim mendimin e një personi që ka provuar të agjërojë pa pasur asnjë lidhje me islamin. Tom Bernez, student në shkollën "Kolumbia", dega gazetari, thotë: "Unë e konsideroj agjërimit më shumë si eksperiencë të thellë shpirtërore, sesa trupore. Megjithatë fillova të agjëroj për të ulur peshën e tepërt, e kuptova që ai është shumë i dobishëm edhe për aktivitetin e trurit. Agjërimit ndihmon si në mënyrën e të menduarit, në lindjen e ideve të reja, ashtu edhe në përqendrimin e ndjenjave. Nuk kishin kaluar shumë ditë nga fillimi i agjërimit në strehimin shëndetësor "Bulling", kur ndjeva që po kaloja një gjendje lartësimi shpirtëror të paimagjinueshëm. Tani e bëj një gjë të tillë disa herë e në periudha kohore nga një deri në gjashtë dite. Në fillim qëllimi ishte të pastroja trupin nga shëndeti i tepërt, por tani agjëroj për të pastruar edhe shpirtin tim nga tërë të metat që kane ngecur në të gjatë jetës sime, sidomos pasi shëtita nëpër bote për disa muaj dhe pashe padrejtësitë në të cilën jetojnë shumë njerëz. Ndiej se jam përgjegjës në një mënyrë apo tjetër për atë që u ndodh atyre, kështu që agjëroj si falje për këtë. Kur agjëroj më ikën tërë dëshira për ushqim e tërë trupi ndien një rehati të madhe. Ndiej që shpirti im largohet nga ndjenjat e këqija si: lakmia, xhelozia, dëshira për sundim. Gjithashtu, ndiej të largohen edhe disa gjëra që më ndjekin pas si: frika, luhatja, ndjenja e mërzi. Tërë këto nuk i ndiej të ndikojnë tek unë gjatë agjërimit dhe gjej një mirëkuptim të mrekullueshëm me tërë njerëzit gjatë tij".

## STUDIM MBI VLERAT KURUESE TË AGJËRIMIT

Në një studim të paraqitur në konferencën e sëmundjeve të zemrës në Arabinë Saudite në shkurt të 1998, janë eksperimentuar mbi 86 të sëmurë me sëmundje të ndryshme të zemrës si, damarët apo valvulet e zemrës. 86 për qind e tyre arritën të agjëronin tërë muajin e Ramazanit dhe vetëm 10 për qind e tyre u detyruan ta ndërprisnin atë disa ditë dhe në përfundimin e muajit, 78 për qind e tyre ndjenë përmirësim të gjendjes shëndetësore, kurse 11 për qind e tyre ndjenë të shtoheshin simptomat nga të cilat ankoreshin. Agjërimit ndihmon në kurimin e tensionit të lartë të gjakut, sepse ulja e peshës që shoqëron agjërimit, ul gjithashtu edhe tensionin e gjakut në mënyrë të dukshme, si edhe lëvizjet fizike në namazin e teravisë ndihmojnë në uljen e tensionit të gjakut. D. Shahid Ethar në një hulumtim të botuar në revistën amerikane "Jirir" përcakton se personi gjatë namazit të teravisë konsumon 200 kalori. Kështu, nëse agjëruesi i përmbahet një ushqimi normal, duke evituar teprimin në yndyra dhe sheqerna, do të gjejë tek Ramazani mbrojtje për zemrën e tij dhe kurim për sëmundjen e saj.



# Boshti i TEUHIDIT

*Idris Arpat*

Në themel të luftës së Profetëve ka dy parime universale, të cilat nuk ndryshojnë asnjëherë: Teuhidi përballë shirkut (bërja shok Allahut), dhe drejtësia përballë dhunës.

Fjala teuhid do të thotë të njësoh, të bësh një, ndërsa si term, teuhid do të thotë të pranosh se Allahu Teala nuk ka të ngjashëm as në thelbin ekzistencial dhe as në thelbin cilësor. Faza e teuhidit është një aforizëm, i cili shpreh obligimin që ka myslimani për të njësuar Allahun Teala dhe për këtë arsye, Profeti (a.s.), thotë: *"Ai që thotë, La ilahe il-lallah, shpëton."*

Kur themi njëshmëria e Allahut, ajo që na vjen në mendje në fillim është njëshmëria në esencën e besimit, ndërsa njëshmëria me vepra është pika e dytë, e cila do të thotë se rregullat e vlerësimit të të gjitha veprimeve tona merren nga një burim i vetëm dhe ajo që është e lejueshme, përcaktohet nga këto rregulla.

Meqënëse tokat, qiejt, pasuria dhe bota e ekzistencës, bota e dukshme dhe e padukshme janë të Allahut Teala, edhe autoriteti dhe pushteti janë të Tijat.

Allahu Teala nuk ka të ngjashëm as në thelbin ekzistencial dhe as në thelbin cilësor. Ai nuk është i lindur dhe s'ka lindur askënd. Cilësitë e Tij nuk kanë fund e kufi. (Shih. Sure Ihlas.)

Allahu Teala është Qenia Madhështore të cilin Kur'ani dhe Sunneti e përshkruajnë me 99 emrat më kryesorë. Ashtu sikur nuk e dimë se sa janë në të vërtetë emrat e Allahut, ashtu nuk mund të dijmë në mënyrë të saktë se ç'kuptim kanë dhe se ç'farë ndikim ka pasqyrimi i tyre në jetën njerëzore dhe në univers. Kështu që, ato që dijmë për Allahun Teala nuk janë të qarta dhe të mjaftueshme. Sikur t'i njihnim të gjitha dimensionet e "Esmau'l Husna" (Emrat më të bukur të Allahut) dhe të merrnim mësim prej kësaj njohurie, do të zotëronim një botëkuptim më të bukur se atë që kemi sot dhe do të kishim një jetë më cilësore. Botëkuptimi ynë njerëzor dhe shikimi ynë kundrejt materiales do të ishte shumë më i ndryshëm dhe më me nivel.

Kuptimi i teuhidit (njëshmërisë) është i lidhur me kuptimin e "Esmau'l Husna". Nuk na hyn në punë një teuhid i kuptuar si: "Allahu është një dhe nuk është dy". Ç'është përmbajtja e kësaj njëshmërie dhe si pasqyrohet ajo në jetë? Ç'farë botëkuptimi zgjon tek ata që e pranojnë? Kjo pra është edhe pika më e rëndësishme.

Allahu është zotërues i vullnetit dhe Krijuesi Madhështor. Ashtu siç ka caktuar ekzistencën e gjithçkaje, po ashtu

cakton edhe qëllimin e saj. (Shih: Sure Nahl, 9.) Allahu rregullon të gjitha çështjet e jetës. Flamurtarët e teuhidit meditojnë për të gjitha çështjet që përmbajnë jetë. Ata zotërojnë një mënyrë shikimi kritik.

E kundërta e teuhidit është adhurimi i tagutit. Tagut është çdo lloj fuqie, institucion apo person, që merr mbi vete kompenzat e Allahut dhe mundohet t'i skllavërojë dhe t'i bëjë njerëzit adhurues të tij. Taguti e vazhdon sundimin e vet duke prishur dhe shtrembëruar rregullat e besimit.

"Ju, në jetën tuaj mund të mos kryeni adhurime ndaj njerëzve sikur dilni përpara Allahut dhe falni namaz. Mund të mos prisni kurban për ta, mirëpo, kur këto njerëz ndalojnë diçka kundër vullnetit dhe dëshirës së Allahut, ju nuk i veproni dhe ruheni prej tyre. Dhe, megjithëse këto urdhëra dhe ndalesa bien në kundërshtim me urdhërat dhe ndalesat e Allahut, ju u bindeni atyre. Ja pra, kjo do të thotë shirk (t'i bësh shok Allahut)." (Prof. Dr. H. Karaman, Ensar Vakfi Bülteni Mart-Nisan 1993. s.6.)

Teuhid do të thotë, t'i bëhesh rob vetëm Allahut.

**"Thuaj: Namazi im, kurbanimi im, jeta ime dhe vdekja ime janë thjesht për Allahun, Zotin e botëve. Ai nuk ka shok (nuk adhuroj tjetër). Me këtë (thjeshtësi të adhurimit vetëm për Zotin) jam i urdhëruar dhe jam i pari i myslimanëve (i pari që pranoj dhe bindem)!"** (En'am, 162-163.)

Profeti ynë (s.a.u.s.), urdhërohet që krahas adhurimit që bënin mushrikët ndaj putave (zota), tërë jetën e Tij t'ia përkushtonte vetëm Allahut Teala, me namazet, me kurbanet dhe me gjithë qenien e Tij, deri në vdekje, dhe të jetë myslimani i parë që e merr mbi vete këtë detyrë. Kështu, që të deklarojë me besim të plotë dhe të sigurt se kurrë nuk do të njohë zot tjetër përveç Allahut Teala. (Kur'an Yolu, 2. C.)

Pjesa "...Vetëm Ty të adhurojmë" do të thotë, besim, adhurim dhe rregull social. Fjalja "vetëm prej teje kërkohet ndihmë", shpreh sinqeritetin dhe njësimin e Allahut me vepra (të mos e ulim kokën para askujt përveçse para Tij dhe të mos njohim askënd tjetër me cilësitë dhe kompetencat që i takojnë vetëm Atij). Fjalja "Udhëzoni (përforconi) në rrugën e drejtë!" mbarë në vetvete, adhurimin, disiplinën, mendimin dhe moralin. (Kuran Jollu, Shpjegimi i Sures Fatiha)

Meqenëse ne kemi premtuar se do të adhurojmë vetëm Allahun dhe jemi shprehur se jetën tonë ia kemi

kushtuar vetëm Atij, do të thotë se ne kërkohet një jetë, boshti i së cilës të jetë Allahu. Jeta që ka si bosht Allahun, është një jetë që ka për bosht Kuranin, Sunnetin, natyrshmërinë dhe ndërgjegjen. Kurani dhe Sunneti janë shpallja e vullnetit hyjnor. Natyrshmëria është gjendja e parë e njeriut, e cila është rregulluar nga Allahu. Ndërsa ndërgjegjja është zëri i Allahut brenda nesh, i cili është futur në zemrën tonë.


"Jetën time ia kushtova Allahut" do të thotë: "Për mua, kënaqësia e Allahut është gjithmonë në plan të parë." Por ç'është e kundërta e kësaj? Ajo është të kushtuarit e jetës vetëm njeriut ose gjërave të tjera që janë nën nivelin e tij ose e thënë ndryshe të shpërdoruarit e jetës pas dëshirave dhe epsheve. Të kushtuarit e jetës një krijese me të njëjtin nivel, apo edhe më të ulët, nuk përputhet me urtësinë, por gjithashtu nuk është as diçka e logjikshme dhe e natyrshme.

Meqenëse zotëruesi i Tokës dhe i gjithë universit është Allahu i Madhëruar, ndërhyrja në të bëhet vetëm me vullnetin e Tij dhe me aq sa lejon Ai.

"La ilahe" është refuzimi i gabimeve dhe "il-lallah" është pranimi i së drejtës. Shkrimtarë dhe mendimtarë si Niçja, Sartri, Kamy dhe të tjerë, parullën "la ilahe" e përhapën në një fushë të gjerë, por nuk mundën të hynin në kopshtin e "il-lallah". Kjo i çoi ata nga gabimi në gabim. Dhe më në fund, ata u përpëliten në moçalin e të pashpresëve dhe vuajtën shumë.

Nëse pranohen të drejtat pa u refuzuar gabimet, ndodh përplasje midis të vërtetës dhe të gabuarës. Kjo është një sintezë (lidhje) që tashmë e ka humbur interesin për të vërtetën. Ne myslimanët, ashtu siç jemi të urdhëruar të mos e fshehim të vërtetën, po ashtu jemi urdhëruar edhe të mos e ngatërrojmë të vërtetën me të pavërtetën. (Shih: Bakara, 42.)

E vërteta është ajo, e cila i përshtatet caktimit të Allahut, ndërsa e pavërteta është ajo e cila nuk i përshtatet atij. Teuhidi nuk i pranon as idetë e paqarta që do t'i ngatërrojnë mendjet. Çdo të thotë të rrih e të thuash "la ilahe", ndërsa je duke i hedhur me dhjetra heshta të helmatisura mendjes dhe zemrës? Ashtu siç shprehet dhe Imam Gazzaliu, "Nëse ti nuk e kupton të vërtetën e teuhidit dhe të ndarjes që përmban "kelime-i teuhid" (fjala e njësimit të Allahut), atëherë ti nuk je duke thënë "la ilahe il-lallah". Për këtë e ka fjalën edhe ajeti i nderuar kur shprehet: **"Mjerë për ata, të cilët nuk falen, janë të pakujdesshëm ndaj namazit"** (Maun 4-5.) Ne jemi të



obliguar që më parë të kuptojmë pastaj të përkujtojmë, të dimë pastaj të flasim.

Ashtu si shprehja "Eudhu bil-lahi minesh-shejtani raxhim" nënkupton strehimin tek Allahu për t'u shmangur gabimeve, ashtu edhe shprehja "Bismil-lahi Rrahmani Rrahim" nënkupton pranimin e gjërave të drejta. Nga një këndvështrim, teuhid do të thotë, të jetosh jetën me qëllime të pastra, me rregulla të drejta dhe ndjenja të bukura. Për ne, burimi i së drejtës dhe së bukurës është Kurani Famëlartë dhe Sunneti i Profetit tonë (s.a.u.s.). Çdo rregull që përshtatet me Kuranin dhe Sunnetin është brenda kornizës Islame. Si myslimanë që jemi, duhet të studiojmë të gjithë kulturën botërore, dhe duke e pranuar çdo gjë të drejtë mund ta pasurojmë në përmasa të mëdha kulturën dhe botëkuptimin tonë.

Teuhidi pasqyrohet në jetën tonë edhe si drejtësi dhe sinqeritet. Dhe nga ky pasqyrim, lind një pavarësi nga të tjerët, përveç Allahut, dhe një cilësi e mrekullueshme e jetës, sepse gjëja kryesore është që Allahu të pëlqejë qëllimin dhe veprën tonë. Veprat dhe qëllimet që do të paraqiten në një post më të lartë, duhet të jenë pa të meta. Nuk kërkohet pëlqimi i njerëzve, por i Allahut.

Ekzistenca dhe njëshmëria e Allahut e përfshin njeriun nga jashtë dhe nga brenda. **"Vërtet, ata dyshojnë në takimin me Zotin e tyre, por le ta dinë se Ai ka nën kontroll çdo gjë."** (Fusilet 54.)

E ka përfshirë aq shumë sa që nuk ka asnjë gjethë që bie nga pema dhe Ai të mos e dijë. (Shih: Sure En'ám 59.) Për këtë arsye, ashtu si zemra e myslimanit është e mbushur vazhdimisht me dashurinë ndaj Allahut, ashtu edhe çdo mrekulli në këtë botë ia mban gjallë emocionin hyjnor, ndërsa fryti i kësaj është mosdhënia rëndësi gjërave të kësaj bote, ose thënë ndryshe, të kalosh përfundimisht nga bota e vdekshme dhe të qëndrosh tek Allahu.

Teuhidi është përqendrimi i miliarda njerëzve në një qendër dhe në një zë dhe nga kjo, lindin rregulla dhe emocione të përbashkëta.

Njeriu do të përqendrohet tek zëri, i cili tregon për ngjarje shumë të rëndësishme si: ardhja dhe ikja nga kjo botë, një zë që tregon një nga një çdo gjë që ka lidhje me jetën tjetër. Ky është një zë që e qetëson mendjen dhe shpirtin e njeriut.

Një pasqyrim tjetër i teuhidit në jetën e myslimanit është ajo që e bën atë (myslimanin) të marrë pjesë në

korin kozmik. Teuhidi me gjithë universin rrotullohen vazhdimisht në të njëjtën qendër tërheqjeje. Besimtari, i cili mendon dhe e di se i gjithë universi i përshtatet ligjeve të Allahut, e ndien veten si vëllai i universit, ndërsa njeriu i përkulet ligjeve të shkruara, të gjitha krijesat e tjera u përkulen ligjeve të cilat Allahu ka caktuar për natyrën. Megjithatë, edhe në trupin e njeriut ka pjesë, të cilat u përkulen ligjeve natyrore si, rrahjet e zemrës, lëvizja e gjakut etj. Njeriu nuk duhet t'i bindet vullnetit të vet, por vullnetit të Allahut dhe nga kjo sigurisht që do të lindi vëllazëria fetare. Kështu që, midis njeriut dhe natyrës (botës) ka një lidhje vëllazërore dhe jo një luftë e përgjakshme për mbijetesë ashtu sikur pretendon filozofia materialiste. Nëse e shikojmë nga pikëpamja Islame, vëmë re se midis njeriut dhe natyrës nuk ka asnjë lloj përplasjeje, por në të kundërtën, shohim një sakrificë vëllazërore. Bota dhe krijesat që ndodhen në të, i janë vënë në shërbim njeriut dhe kaq!

Në të njëjtën kohë, kjo është një kompetencë e kufizuar që i është dhënë njeriut, sepse, njeriu nuk është zoti i të gjitha këtyre krijesave, madje as edhe i trupit të tij, por veçse një ruajtës amaneti dhe patjetër që ruajtësi i amanetit duhet të jetë i sigurt (që e mban amanetin). Më i rëndësishëm është vullneti i Atij që jep amanetin.

Teuhid do të thotë, të dalësh prej moçalishtes së shumësit dhe të futesh në ujërat e qarta dhe të ëmbla të njësimi.

Teuhid do të thotë, qartësim i të vërtetave, metodave dhe rrugëve.

Teuhid do të thotë, të ecësh me hapa të sigurt në këtë botë.

Teuhid do të thotë, të përqafosh universin me një emocion të pasqor, të cilin na e ka futur në zemër zotëria i tij (universit).

Teuhidi do të thotë, të shohësh botën e ngurtë dhe të ngushtë materiale nga majat e larta dhe madhështore të shpirtit.

Teuhid do të thotë të refuzosh shndërrimin në një qenie mekanike dhe të qëndrosh në rrugën e të qenit njerëzor.

Të gjitha krijesat iu bindën me dëshirë thirrjes së Allahut, gjithashtu edhe një pjesë e njerëzve, mirëpo, iblisi dhe shumica e njerëzve nuk morën pjesë në korin e teuhidit, madje nuk u mjaftuan me kaq, por u munduan ta sabotonin atë.

Sa guxim i çmendur!



# CIVILIZIM PA DASHURI - DASHURI PA CIVILIZIM

Vehbi Vakasoğlu

Niveli i një civilizimi është në proporcion të drejtë me vlerat që u jepen fëmijëve, grave dhe të moshuarve. Kur në një vend bëhet fjalë për civilizim, fëmijët jetojnë të gëzuar, gratë të lumtura dhe të moshuarit të qetë.

Por sot këto tri kategori të shoqërisë ndodhen në një gjendje të mjeruar. E gjithë bota ankohet nga abuzimi ndaj fëmijëve. Dhuna ndaj grave është në një nivel të frikshëm. Ndërsa të moshuarit konceptohen si teprica, ekzistenca e të cilëve është bërë shqetësuese. A mund të flitet për humanizëm dhe civilizim në shoqëritë ku ekziston ky lloj mentaliteti?

Shoqëritë më të njollosura në këtë çështje, gjenden në perëndim. Shoqëritë perëndimore, të cilat nuk imagjinojnë dot të tjera shoqëri të civilizuara përveç vetes së tyre, janë duke u përpëlitur në vorbullën e mungesës totale të dashurisë dhe mëshirës. Por më e keqja është se kjo sëmundje po përhapet anembanë botës.

Pasi filluam të mos jetojmë ashtu si besojmë, kjo sëmundje filloi të përhapet edhe tek ne. Ne, që dikur u dënim për zot me një ndjenjë të lartë respekti prindërve, gjyshërve, madje të gjithë të moshuarve, grave, fëmijëve dhe të sëmurëve, sepse libri ynë i shenjtë Kurani, e ka deklaruar këtë si një adhurim të rëndësishëm. Gjithashtu edhe Profeti ynë (a.s.), gjatë gjithë jetës së tij ka qenë shembull i gjallë i këtij adhurimi.

Feja jonë na urdhëron të tregojmë mirësi ndaj prindërve. Madje na ka ndaluar të themi qoftë edhe **"of"** për shkak të lodhjes apo mërzitjes që mund të ndjehet gjatë shërbimit ndaj tyre. Gjithashtu, ajo na e ka bërë të qartë se, përveç përbushjes së nevojave materiale që mund të kenë prindërit tanë të moshuar, duhet t'u japim rëndësi edhe nevojave të tyre shpirtërore.

Sipas islamit, fëmija që nuk mundohet t'i kënaqë prindërit e tij të moshuar me shërbim dhe mirësi, ngarkohet me gjynahe të mëdha. Ndërsa ata që marrin bekimin e prindërve, qoftë edhe me një gotë ujë, shtojnë edhe më shumë kapitalin e të mirave që u duhet për në botën tjetër.

## JAZËK I QOFTË ATIJ!

Profeti ynë i dashur (a.s.), përsëriti tri herë në një mënyrë të ashpër: *"Jazëk i qoftë atij!"*. Sahabët pyetën të habitur: *"Kush është ai, o i Dërguar i Allahut?"*. Profeti (a.s.), thotë: *"Ai që, megjithëse të dy prindërit e tij ose njëri prej tyre plakën pranë tij, nuk hyn në xhenet, por meriton xhehenemin"*. (Muslim, Birr, 9.)

Ky ishte botëkuptimi i të parëve tanë. Për besimtarët, të mëdhenjtë ishin ata që u hapnin dhe u zgjerorin rrugët e xhenetit.

Në një hadith tjetër, Profeti ynë (a.s.), thotë:

*"Sikur të mos ishin të moshuarit tuaj belkëputur, fatkeqësitë do të vërshonin mbi ju si një përrua"*. (el-Acluni, Keshfu'l-Hafa, 2:163; Sujuti, Kenzu'l-Ummal, 9:167; Imam Gazali, lhyau Ulumi'd-Din, faq. 341.)

Për këtë arsye, besimtarët e shohin respektin ndaj të mëdhenjve si një siguracion ndaj fatkeqësive dhe bëjnë ç'të mundën për t'i kënaqur ata.

Libri i saktë i Allahut, Kurani Kerim, na jep shembullin e Ibrahimit (a.s.), i cili i drejtohet babait të vet, duke i thënë: *"I dashur baba!"*. Atij babai, që atëherë gdhendte idhuj. Përsëri, libri i shenjtë na jep shembullin e Nuhut (a.s.), që i drejtohet të birit, i cili ishte bashkuar me jobesimtarët: *"Biri im i dashur!"*. Padyshim se këto ajete nuk janë veç për të na treguar gjendjen e së shkuarës, por në të njëjtën kohë edhe atë të çdo shekulli. Prandaj ai përmban mësim të çmueshme për të gjithë njerëzimin, deri në ditën e kiametit.

Në një shoqëri islame, të gjithë robërit nevojtarë dhe të varfër të Allahut kanë përfituar nga kjo mirësi në mënyrë të barabartë. P.sh., azili i pleqve që ngriti sulltani Abdulhamid Hani i II. dhe i cili vazhdon të funksionojë edhe sot e kësaj dite, është një nga shembujt më të bukur që pasqyrojnë këtë fakt edhe në ditët tona.

Në këtë institucion, të gjithë të moshuarit e vetmuar janë trajtuar në mënyrë të barabartë.

Brenda këtij azili është ndërtuar edhe një xhami, një kishë dhe një sinagogë. Ky është një mësim i mirë humanizmi që i është dhënë civilizimit perëndimor 115 vjet më parë.

### PO TANI SI ËSHTË GJENDJA JONË?

Sot, për fat të keq, në azilet e pleqve nuk qëndrojnë vetëm të moshuarit e vetmuar, por edhe ata që kanë të afërm. Ata që janë të vetmuar, pavarësisht se në të vërtetë kanë të afërm, janë më keq se ata që janë pa njeri. A mund ta imagjinoni dot gjendjen shpirtërore të një njeriu që, megjithëse përreth tij ka fëmijë, nipër e mbesa, përsëri është i vetmuar? A do të jetë i lumtur e i qetë një njeri i tillë që është i vetmuar në mes kaq shumë njerëzish, qoftë edhe nëse qëndron në azilin më luksoz në botë?

Njeriu, shtohet dhe pasurohet me njeriun. Cili mund të jetë ilaçi për atë njeri që është dënuar me vetmi në mes të një kallaballëku të madh?

Njeriu është një qenie sociale. Ai ka nevojë të bisedojë, të ndajë dhe të kuptohet, po aq sa ka nevojë për të ngrënë, për të pirë e për t'u veshur. Për këtë arsye, njeriu që jeton në ato ambiente ku shihet si i tepërt dhe i panevojshëm, **"vdes"**. Ose më mirë të themi, **"vritet"**.

Prandaj, ai evlat që i dënon me vetmi, pra me **"vdekje"** prindërit e tij, është një përbindësh me pamje njeriu. Si është e mundur që një evlat t'i bëjë të vuajnë kaq shumë njerëzit që duhen dashur më shumë, siç janë nëna me babanin?

Kjo ka të bëjë me vetëdijen, sepse ai që nuk ka frikë Allahun, nuk është e mundur të bëhet një evlat i mirë.

Ky është edhe problemi më i madh i perëndimit në ditët e sotme. Njerëzit interesahinj, që kanë në qendër egon e tyre dhe që jetojnë me parimin **"Secili për vete, Zoti për të gjithë!"**, nuk duan të interesohen për askënd, qoftë edhe për më të afërmit e tyre. Këto dy ditë të jetës së kësaj bote duan t'i kalojnë vetëm për qejf të vet. Për ta, jeta e kësaj bote, e cila është shumë e shkurtër, nuk ka vazhdim dhe rinia është e vetmja kohë, kur ata mund të bëjnë qejf e të argëtohen. Prandaj, sa të mundemi të hamë e të pimë pa u kujdesur se është haram apo hallall dhe të shëtisim e të argëtohem në mënyrë shtazore, pa pasur frikë nga Allahu.

Megjithëse ky lloj civilizimi u jep kënaqësi dhe lumturi të rrejshme e të përkohshme, kurrë nuk e qetëson shpirtin e tyre. Gjithmonë u lë një ndjenjë mangësie në botën shpirtërore. Ndërsa ata mundohen të ngushëllohen e të strehohen në shpresa boshe, duke pëshpëritur tekste këngësh si: **"Nuk jam i lumtur, por kam shpresë!"**.

Të moshuarit e pafuqishëm, nga burgjet e hapura moderne që janë azilet ose nga ndonjë qoshe tjetër vetmie, i shohin këta të mjerë që përpëliten në probleme shumë

të ndryshme e të thella. Në fakt, ata shihen në çdo program televiziv. A mund të presim më shumë se kaq nga një civilizim që është ngritur në baza interesi material?

Shteti social i shekullit modern nuk e lë vetëm të moshuarin, nuk e lë atë të uritur, por i mbledh të gjithë në një vend dhe kujdeset për ta dhe besojnë se detyrën e tyre e kanë kryer në mënyrë të përsosur. Nëse njeriu do të ishte vetëm prej mishit, kockës dhe gjakut, do të ishim dakord me këtë mendim. Por njeriu ka një zemër, një shpirt dhe ndjenja të brendshme. Edhe ata kërkojnë dashuri, mëshirë dhe dashamirësi. Për këtë arsye, pijet dhe ushqimet që nuk janë dakord me këto ndjenja nuk mund të të ngopin. Edhe veshjet që nuk u shtohen këtyre ndjenjave, nuk mund të të ngrohin.

Një njeri, i cili do të bisedojë dhe të ndajë ndjenjat e mendimet, nuk mund të jetë i lumtur as në një azil me pesë yje, nëse aty nuk ka përzemërsi, miqësi dhe mëshirë. Bota perëndimore, mundohet që këtë boshllëk shpirtëror

të zgjidhë me para. P.sh., ata u sjellin shoqëruet me qira të moshuarve që mërziten në azilet e tyre.

Këta shokë artificialë me qira, luajnë rolin e të afërmeve, të cilët i ka marrë malli për të moshuarit dhe kanë ardhur t'i vizitojnë. Ata i përshëndesin duke buzëqeshur, i pyesin për hallet dhe gjendjen e tyre dhe ç'është më e rëndësishmja, i dëgjojnë të moshuarit. I dëgjojnë aq sa duan ose më mirë të themi, aq sa paguhen.

Në fakt, më shumë se sa i dëgjojnë, bëjnë sikur i dëgjojnë. I dëgjojnë pa ndjerë asgjë, pa derdhur asnjë pikë lot për tregimet e hidhura, pa ndjerë asnjë lloj keqardhjeje brenda vetes. Pra, i dëgjojnë derisa të plotësojnë orarin e punës. Por këta njerëz të vetmuar, përsëri ndihen më mirë përkundër faktit se këta janë dëgjues që

nuk ndajnë asnjë lloj ndjenje. Sa gjendje e hidhur, apo jo?

### SHËRBIMI "ALO MIK!"

Në disa vende është hapur shërbimi **"Alo mik!"**. Nëse të vetmuarit kanë nevojë, telefonojnë shërbimin dhe me mundësinë që u lejon xhepi, thërrasin dikë që t'i dëgjojë. Ata që janë më të pasur, thërrasin psikologë dhe psikiatër të diplomuar, të cilët mundohen t'u heqin vetminë.

Gjatë viteve që kam punuar në Gjermani, u njoha me një nga këta të pasur. Ky njeri tepër i pasur, një ditë pësoi krizë zemre. Kur i shkova për vizitë, vura re se ishte shumë i gëzuar. Sigurisht që nuk e përmbajta veten dhe e pyeta se si mund të ishte kaq i gëzuar në këto çaste kaq të vështira.

Ai më tha: **"Zotëri, ju këshilloj që edhe ju të kaloni një krizë zemre sa më parë!"** Ndërsa po mundohesha të kuptoja se sa serioze ishte ajo që tha, ai shtoi: **"Deri më sot**





jam sëmurë shumë herë. Jam shtruar shumë herë edhe në spital, por asnjëherë nuk kam parë të afërm pranë meje. Kjo krizë zemre bëri që unë të jetoja diçka që nuk e kisha jetuar deri më sot. Shumë prej të afërmeve që jetojnë këtu, më erdhën për vizitë. Madje edhe djali im që jeton në Amerikë, të cilin nuk e kam parë prej nëntë vjetësh, erdhi dhe qëndroi tri ditë rresht. Ishte një gjë e mrekullueshme. Ata treguan dashamirësi dhe interes të madh për mua. Këto ishin gjëra që i jetova për herë të parë, prandaj dhe u lumturova jashtë mase. Nëse edhe ju dëshironi të ndjeni një lumturi të tillë, duhet që patjetër të kaloni një infarkt. Ju siguroj se dhimbjet dhe frika që do të ndjeni, do t'ia vlejë. Nuk të vjen kush për sëmundje të vogla, mor zotëri!”

Ky ishte një njeri i pasur nga një vend i pasur. Nuk dija ç'të thosha. Pas disa kohësh edhe unë u shtrova në spitalin e Berlinit për shkak të gurëve në veshka. Miqtë e mi nuk më lanë vetëm për gjatë gjithë kohës që qëndrova në spital. Sigurisht që vizitorët nuk i kisha me turma, por edhe vetëm nuk kam qenë. Një javë më vonë, më vizitoi shefi i spitalit dhe kërkoi të njihet me mua. Gjatë atij takimi, mësova edhe arsyen e vizitës si tij. Me habi të madhe më pyeti se çfarë pune bëja. Kur i thashë se përgjigja e kësaj pyetjeje ndodhet në regjistrat tuaj, tha:

- Regjistri thotë se ju punoni si mësues. Nuk m'u duk shumë bindëse, sepse unë kam vite që punoj në këtë spital dhe nuk më ka rënë rasti të shoh ndonjë të sëmurë me kaq shumë vizitorë.

Kur dola nga spitali, u ktheva në krye të detyrës dhe zhvillova disa seminare me të rinjtë, ku fola gjerë e gjatë në lidhje me respektin dhe shërbimin ndaj të moshuarve dhe të sëmurëve. Më vonë, njëri prej të rinjve më tha:

- Mësues, përfituam shumë nga seminarët tuaja në lidhje me respektin dhe shërbimin ndaj të moshuarve dhe të sëmurëve. Gjatë fundjavës punoja në një azil pleqsh për të përballuar shpenzimet. Puna ime ishte të shëtisja me një të moshuar dhe t'i plotësoja nevojat brenda katër orëve. Atje kishte edhe nxënës të tjerë që punonin si unë. Mirëpo, pas disa javësh, të moshuarit që kishin ngelur të kënaqur prej meje, kërkuan prej drejtorisë që t'u sillnin nxënës turq. Për këtë arsye, drejtori më tha që të sillja disa prej shokëve të mi turq. Tashmë aty punojnë vetëm të rinj turq.

- Kur e pyeta se pse i preferonin, ai më dha një përgjigje që më bëri të ndihem krenar për besimin dhe kulturën time.

- Të moshuarit na thonë se nuk na shihnin si të huaj që po u shërbenim me para, por si nipërit e tyre të vërtetë.

Ajo që i ndante ata nga të rinjtë e tjerë, ishte se ata punonin me dëshirë dhe jo si të detyruar. Ata sillleshin me mirësjellje dhe dashuri ndaj të moshuarve dhe nuk u thoshin kurrë “jo”, qoftë edhe për gjëra të cilat nuk i kishin për detyrë t'i bënin. Pra, çështja është të hysh me shpirt në një botë ku nuk ka shpirt.

Më vonë edhe unë u njoha me ata të moshuar. Dëshira e të gjithëve mund të përmblihet vetëm me disa fjalë: Na lini në dorë të fëmijëve turq. Veçoria e vetme që i ndante nga të tjerët, ishte se ata ishin myslimanë.

Në të njëjtën mënyrë jam habitur kur kam parë disa gjermanë të moshuar, që blinin në dyqanet e turqve. Përse blinin në dyqanet e turqve, kur kishte dyqane të tjerë më të lirë dhe me më shumë lloje mallrash? Përgjigja që iu dha kësaj pyetje nuk ndryshonte fare:

- Në market nuk të përshëndet njeri. Madje nuk mund të bisedosh me askënd. Çdo gjë është e fokusuar tek shitblerja, pra tek paraja. Ndërsa dyqanet turke nuk janë ashtu. Aty njerëzit bëhen si të afërm. Ata na pyesin për hallet tona dhe ne i pyesim për hallet e tyre. Madje bisedat më të përzemërta i bëjmë në këmbë në ato dyqane. Aty gjithmonë të presin me fytyrë të qeshur dhe gjuhë të ëmbël. Prandaj, gjatë blerjes në dyqanet turke, ndjejmë se jemi njerëz dhe jo robotë.

Në fakt, të moshuarit, me pretekstin e blerjes, më tepër vrapojnë për dashuri dhe butësi. Vallë, a thua se nuk kanë fëmijë apo të afërm? Kanë, por nuk kanë! A s'është më e hidhur kjo?

A mund ta mendoni një prind në këtë gjendje? Përgjigjetohet dhe harrohet nga fëmijët e tij, që i ka rritur në pëllëmbë të dorës gjatë gjithë jetës. E çfarë mund të jetë më e hidhur se kjo në sipërfaqen e tokës?..

Ndonjëherë, këtë e bëjnë ata që nuk mund ta ndajnë dashurinë për bashkëshorten nga dashuria për prindërit. Si mund ta kërkojë një gjë të tillë një bashkëshorte? Si mund të thotë: “Sa të jem unë, ata s'kanë vend këtu!” A nuk e di se nesër do ta gjejë atë që po bën sot? I nderuari Mevlana thotë: “Çfarë u mboll e nuk u korr?.” A mund të korrë dashuri, ai që mbjell urrejtje?

Nëna ime e moshuar, e cila me vite të tëra është e sëmurë dhe ka zënë shtratin, thotë:

- Duhet të jesh nënë, që të kuptosh nënën!

U martova, u bëra baba dhe i thashë nënës:

- Nënë nuk u bëra, por baba u bëra. A mund ta kuptoj nënën tani?

- Jo mor bir, jo. Nuk mund ta kuptosh nënën, pa u bërë nënë!

Ja pra, për këtë arsye, detyra e fëmijës është të mundohet të kuptojë nënën dhe babanë. Të mundohesh që t'i kuptosh ata, të hysh në zemrën e tyre dhe të marrësh bekimin e tyre, është detyra e çdo fëmije. Sigurisht që kjo detyrë duhet bërë pa neglizhuar bashkëshorten dhe fëmijët. Madje pa lënë punën dhe, mbi të gjitha, pa lënë detyrat si besimtar. Në fakt edhe përkujdesja për prindërit është një adhurim më vete.

Sot ka prindër që nuk i nxënë as shtëpitë e gjera. Më parë, me ta mund të jetoje edhe në një shtëpi me dy dhoma. Po sot, pse nuk i nxënë as shtëpitë e stërmëdha? Sepse u zmadhuan shtëpitë, por u zvogëluan zemrat.

Më parë duhet të zgjerohet shpirti me dashurinë e vërtetë. Por shpirti nuk zgjerohet përveçse me besim. Atëherë, prindërit që duan mirësi prej fëmijëve të vet, duhet që më parë t'i edukojnë ata që të bëhen robër të Allahut dhe umet i Muhamedit (a.s.). Nëse nuk mund të bëhen robër të Allahut dhe umet i Muhamedit (a.s.), nuk mund të bëhen as fëmijë të mbarë.



# Namazi

## miraxhi i besimtarit

Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz

Konceptin kuranor të qasjes sufiste "Marrëveshja e Elest"-it, Mevlana e konsideron si shkakun kryesor të ekzistencës. Jetën dhe qenien e kupton përmes saj. Veçoria kryesore e jetës së besimtarit është të qëndruarit në fjalë të kësaj marrëveshjeje dhe të qenët gjithnjë me Allahun. Prandaj dhe të gjitha adhurimet: namazi, agjërimi, haxhi, zekati, sadakaja dhe dhikri janë si dëshmitarë të kësaj marrëveshjeje hyjnore. Të japësh zekat, t'u ndash dhurata miqve dhe të heqësh dorë nga smira, dëshmojnë arritjen e enigmës së pafundësisë. Falja e namazit, si një kusht i kësaj marrëveshjeje hyjnore, është zbatimi konkret i kësaj marrëveshjeje. Gjithashtu, edhe agjërimi është një manifestim i lartë i të qëndruarit në fjalë të marrëveshjes hyjnore, duke u shmangur edhe nga ushqimet e lejuara dhe duke u larguar nga të ndaluarat. Pasuria më e rëndësishme e të qëndruarit në fjalë marrëveshjes hyjnore, është devocioni (*takva*) dhe ndërgjegjja e *ih-san*-it e njeriut. Ato që i pjekin këto janë adhurimet. Shejtani, qëkur ekziston, njeriun nuk e ka pranuar dhe është në luftë të përhershme me të. Për t'u hakmarrë ndaj dëbimit hyjnor që pësoi për arsye të njeriut, ka marrë leje që ta devijojë njeriun nga rruga e drejtë. Mevlana e tregon në këtë mënyrë marrjen e lejes së shejtanit nga Allahu: "Jepmë afat gjer ditën ku

do të bëhet kiamet/Unë jam i kënaqur në burgun e kësaj bote;/ Pra, për t'i shkatërruar njerëzit, jepmë afat/Kush pjesë nga besimi dhe bukë në dorë të ketë/Si ushqim rruge për në jetë e pas me ahiret/T'ia rrëmbej nga dora me pahir a me hile/Që pastaj nga pendimi të qajë me kuje/Herë t'i frikësoj njerëzit me papasje e varfëri/Herë t'ua lidh sytë me cullufet për bukuri." (Mesnevi, përkth. M. Hoxha, Logos-A, 2010, v. II, 4605-4610.)

Sipas Mevlanës, ushqimi më me vlerë në burgun e dynjasë është besimi. Shkaku i vërsuljes së *qenit shejtan* është pikërisht marrja e këtij ushqimi. Rruga e vetme për të penguar hyrjen e shejtanit brenda njeriut, është falja me rregull e namazit. Namazi që falet me sinqeritet, larg dyfytirësisë. Profeti ynë i dashur e ka ngritur namazin, duke thënë: "Namazi është miraxhi i besimtarit." (Sujuti, *Sherhu Ibn-i Maxhe*, I, 313.)

Mevlana i vlerëson në mënyrë metaforike pjesët e namazit, në këtë mënyrë: Besimtari, duke filluar me **tekbirin iftitah** (të thënit "Allahu ekber!"), sikurse ai që bën kurban, duke thënë "Allahu ekber!", është i gatshëm ta bëjë kurban nefsin. Me këtë *tekbir*, besimtari pastrohet nga të gjitha epshet dhe dëshirat dhe, në një farë mënyre, i flijohet Allahut. Duke qëndruar në **kijam**,

besimtari është si ai që gjendet në audiencën hyjnore dhe që po pret të japë llogari para Allahut. Të qëndruarit në këmbë duke derdhur lot, është sikur ai që qëndron para Allahut në ditën e mahsherit, pasi është ringjallur nga varri. Në **kiraat**, besimtari është duke biseduar me Allahun. Duke ia kujtuar dhuntitë krijesës së Tij, Allahu thotë: "Brenda këtij afati, ç'ke fituar e ç'më ke sjellë këtu ti? Me ç'e mbarove jetën; ushqimin që u furnizove? Fuqinë që të dhurova, me ç'qëllim e shpenzove? Dritën e syve, ku e konsumove? Pesë shqisat, ku i përdore?" Një njeri që këto pyetje e bëjnë të mendohet dhe s'mund të kthejë përgjigje të mjaftueshme, turpërohet prej Zotit, mendon gjynahet dhe, nga turpi, bie dyfish në **ruku**.

Nga pafuqia që shkaktohet, i drejtohet Allahut, duke pranuar madhësitinë e Tij dhe duke e lavdëruar me fjalët "*Subhane Rabbijel-adhim*". Më pas, vjen fermi hyjnor dhe thuajse i thuhet: "Ngrije kokën dhe ktheju përgjigje pyetjeve." Besimtari i bërë dyfish, ngre kokën i turpëruar, por nuk reziston dhe bie i palosur në tokë. Në **sexhde**, e madhëron Allahun me shpresë, duke thënë: "*Subhane Rabbijel a'la!*". Sërish i thuhet: "Ngrije kokën dhe tregoj ç'ke bërë!". Besimtari e ngre kokën edhe një herë, por nga turpi sërish bie përtokë. Zoti i Madhëruar sërish i drejtohet: "Ngrije kokën dhe tregomë një për një se ç'ke bërë?" Përballë madhësisë së Allahut, njeriu ndihet i pafuqishëm dhe me këtë barrë të rëndë gjunjëzohet në **Qabe**. Ndërkohë që


Allahu i Madhëruar, sërish i drejtohet: "Të dhashë të mira, s'i ke falënderuar? Të dhashë pasuri, tregomë, ç'ke fituar!". Robi kthehet djathtas dhe u jep **selam** profetëve dhe engjëjve dhe u thotë: "Sovranë shpirtërorë, ndërmjetësoni për shpëtim, se këmba e këtij të shkreti është zhytur në baltra." Profetët i thonë: "Dita e ndihmës dhe e shpëtimit ka kaluar. Kjo bëhej në atë botë; ato ditë kanë kaluar." Njeriu, i pashpresë, kthen fytyrën majtas dhe kërkon ndihmë nga të afërmit dhe nga miqtë. Ata i thonë: "Përgjigjen tënde jepja Zotit vetë! Zotëri, kush jemi ne që të të ndihmojmë ty? Hiq dorë prej nesh!" Pasi heq shpresën nga çdo njeri, njeriu i mjerë ngre të dy duart lart për t'u **lutur** dhe një herë: "E preva shpresën

nga të gjithë, o Zot! Mëshira dhe favorit yt s'kanë fund..." (Mesnevi, v. III, 9830-9865.)

Namazi është si një vezë, që zogu do t'i dalë në ahiret. Prandaj, që të mos dalin të zbazëta vezët, duhen mbushur me *ihlas* në këtë botë. Pesë kohët e namazit falen, që njeriu ta largojnë nga të këqijat, falen me ndjenjën e të qëndruarit në fronin hyjnor. Vërtet, janë pesë kohë namaz, por ata që bëjnë kujdes të falin namazin në kohë, konsiderohen si *salat-i daime* (gjithnjë në namaz). Detyra e shejtanit është ta shmangë njeriu nga namazi dhe ibadeti dhe ta bëjë rob të tij. Ai që lë namazin plotësisht, ka lidhur mendjen, u është nënshtruar dëshirave epshore dhe ka lënë të lirë nefsën. Afrimin me Allahun përmes sexhdes në namaz, Mevlana e krahason me një njeri që ka një mur që e pengon për të arritur tek uji dhe, çdo ditë, për të arritur tek ai, heq nga një pjesë të murit. Muri përballë njeriut është muri i ekzistencës dhe i egoizmit. Sa më i lartë të jetë ai, aq më të vështirë e ka njeriu të ulë kokën e të bëjë sexhde. Pa e kapërcyer trupin e krijuar nga dheu, është e pamundur të bëjë sexhde dhe të pijë *ujin e jetës*. Ata që gjenden para murit të ekzistencës, duhet ta prishin pak nga pak atë, që të arrijnë tek uji. Njeriu e etur e gëzon edhe zhurma që vjen nga uji, kur bien pjesët e murit mbi të dhe shpejton për ta shkatërruar murin, që të arrijë tek uji.

Qëndrimi në këmbë (*kijam*) në namaz simbolizon *tespihun* (madhërimin) që i bëjnë Allahut krijesat, si malet e shkëmbinjët,

me madhësitinë e tyre. Me *ruku* sinjifikohet *tespihu* i kafshëve dhe i shpendëve dhe *sexhdeja* ka domethënie e *tespihut* që bëjnë bimët, që i kanë rrënjët nën dhe. Kurani thotë: "**Atë e madhërojnë (tespih) shtatë qiejt, Toka dhe gjithçka gjendet në to. Dhe nuk ka asgjë që nuk e madhëron Atë, duke e lavdëruar, por ju (o njerëz) nuk e kuptoni madhërimin që i bëjnë ata. Ai, me të vërtetë, është i Butë dhe Falës.**" (Isra, 44.). Ky ajet tregon se *tespihu* i krijesave të Zotit është i përmbledhur simbolikisht në namaz. Përveç kësaj, namazi simbolizon edhe ibadetet e engjëjve, të cilët Pejgamberi ynë, i kishte parë në miraxh tek bënë ibadet, disa në *kijam*, disa në *ruku*, disa në *sexhde* dhe disa në *tehiyat*.



A black silhouette of a person in profile, facing right, with their hands raised in a prayer gesture. The background is a light, hazy sky with a warm glow at the bottom, suggesting a sunset or sunrise. The title is written in a mix of gold and red cursive fonts.

# Rëndësia dhe roli i **Duasë** në jetën e përditshme

Ma. Zymer Ramadani

Në lidhje me këtë shtyllë, këtë ajkë dhe aromë të këndshme dhe të pathyer të besimit islam, Allahu i Madhëruar në Kuranin Fisnik thotë:

**“Kur robërit e Mi (besimtarë) të pyesin për Mua, (thua ju se) Unë jam afër, i përgjigjem lutjeve të lutësit, kur ai më lutet Mua. Prandaj, le t’i përgjigjen thirrjes Sime dhe le të më besojnë Mua, për të qenë në rrugë të drejtë.”** (Bekare, 186)

Po ashtu, transmetohet nga Ebu Hurejre (r.a.), se lidhur me këtë ushqim shpirtëror të besimtarëve Pejgamberi (a.s.) ka thënë:

**“Përderisa dikush nga ju nuk ngutet të thotë: Sa herë që i jam lutur Allahut, lutja - duaja nuk më është pranuar, duaja e këtij personi do të pranohet.”** (Buhari, Deavat, 22)

Kjo shprehje, e cila rrjedh nga gjuha arabe, ka kuptimin: thirrje, ftesë, kërkesë, ndihmë, lutje etj. Vlera dhe dobia e lutjes, është trajtuar hollësisht në shumë raste në Kuran dhe i është dhënë një vlerë e lartë. Duke u nisur nga njeriu, e njëherësh edhe nga pejgamberi i parë Ademi (a.s.), duaja ka qenë themeli kryesor i kallimit të tij nga një trajtë në një trajtë tjetër, ose shkak për të fituar falje nga Allahu. Në këtë mënyrë, të gjithë pejgamberët e Allahut kanë kërkuar nga Ai atë çka u nevojitej më shumë, gjë të cilën e kanë arritur vetëm përmes duarësë. Për shembull, Pejgamberët Nuh, Hud, Salih, Ibrahim Ismail, Ishak, Jakub etj., që

të gjithë i janë lutur në forma të ndryshme Madhërisë së Allahut për ndonjë begati, ndihmë apo diçka tjetër. Në këtë rast, Nuhu (a.s.) iu lut Allahut që ta udhëzonte popullin e tij, edhe pse vetë i kishte ftuar me thirrje për plot një mijë pa pesëdhjetë vjet; Ibrahim (a.s.) i është lutur Allahut që ta falte prindin e tij Azerin; Luti (a.s.) po ashtu u lut që edhe djali i tij të mëshirohej dhe të hynte në anije së bashku me besimtarët e tjerë. Po ashtu, edhe lutja e Musait (a.s.) ishte një ndër lutjet që sipas komentuesve të Kuranit llogaritet si më e qëlluara, nga se ai iu lut Allahut që ta bënte pejgamber vëllanë e tij Harunin. Raste të ngjashme me këto i gjejmë edhe mes njerëzve të devotshëm, raste që përmenden në Kuran, si për shembull: lutja e Asijes (bashkëshortes së faraonit, e cila kishte kërkuar nga Allahu që ta mbronte nga zullumi i Faraonit e nga presionet, dhe që t'i ndërtonte një shtëpi në xhenet), lutja e Uzejrit, i cili e luti Allahun që ta bënte të kuptonte se si Allahu i ringjall të vdekurit dhe t'i hapeshin sytë plakës së moshuar që jetonte në shtëpinë e tij, lutja e Merjemes për shfaqjen e ndershmërisë së moralit të saj, pastaj lutjet e Llukmanit, lutja e As'hâbu'l-Kehf (Shokëve të Shpellës Kehf) etj.

Ajeti në fjalë kërkon nga çdo besimtar i drejtë që t'ia drejtojë lutjen vetëm Allahut, sepse përveç Tij askush tjetër nuk mund t'i përgjigjet dhe t'i shkojë në ndihmë nevojtarit. Në të njëjtën kohë, vërejmë se ajeti në fjalë po ashtu hedh poshtë çdo njeri tjetër, duke treguar se përveç Allahut, të gjitha lutjet e tjera janë të kota dhe në humbje. Po ashtu, edhe Muhamedi (a.s.) bën komentimin e këtij ajeti përmes hadithit ku thuhet se, nëse besimtari e drejton lutjen tek Allahu dhe nuk e humb shpresën për pranimin apo mospranimin e saj, lutja e tij do të pranohet me lejen e Allahut në po atë mënyrë siç e ka kërkuar lutësi.

### KUPTIMET E LUTJES NGA KËNDI KURANOR

Kur shikojmë ajetet kurane, të cilat flasin rreth kë-

saj çështjeje, vërejmë se duaja - lutja shfaqet në disa kuptime, çdonjëra prej të cilave forcon dhe plotëson tjetrën.

Të gjitha këto kanë si qëllim t'ua bëjnë të ditur sa më lehtë besimtarëve rëndësinë që kanë tek Allahu (xh. sh.):

1. Lutja në kuptimin e ibadetit - adhurimit: - **“Përveç Allahut, mos iu lut tjetërkujt nga ata që nuk të sjellin as dobi, as dëm...”** (Junus, 106)

2. Lutja në kuptimin e kërkesës së ndihmës: - **“dhe thirrni (për ndihmë) dëshmitarët tuaj”** (Bekare, 23)

3. Lutja në kuptimin e ftesës: - **“Ditën, kur Ai do t'ju thërrasë e ju do t'i përgjigjeni Atij duke e falënderuar dhe do të mendoni se në këtë jetë, nuk keni qëndruar veçse pak kohë.”** (Isra, 52)

4. Lutja në kuptimin e përgjigjes: - **“Zoti juaj ka thënë: Më thirrni Mua, Unë ju përgjigjem.”** (Gafir, 60)

5. Lutja në kuptimin e thirrjes: - **“Thuaj: “Thirrni Allahun ose thirrni të Gjithëmëshirshmin, me cilindo emër që ta thirrni ju Atë, Ai ka emrat më të bukur...”** (Isra, 110)

Në jetën e përditshme të myslimanit, duaja është ajo që duhet të zërë vend më shumë në veprat dhe fjalët e tij. Për këtë shkak, dijetarët myslimanë e kanë llogaritur duanë si një nga shtyllat e ibadetit.

Sipas thënies së Pejgamberit (a.s.), duaja është vetë ibadeti dhe thelbi i tij. (Tirmidhi, Deavat, 3371) Në këtë mënyrë, Pejgamberi (a.s.) është munduar gjatë jetës së tij që t'ua bëjë të ditur këtë myslimanëve dhe t'i nxisë ata që të jenë të lidhur sa më ngushtë me Krijuesin përmes lutjes, sepse duaja është çelësi i mëshirës. Në lidhje me rëndësinë dhe dobinë që ka duaja, në shumë hadithe ka porositur kështu:

**“Kërkoni shumë gjëra nga Allahu, sepse Ai krenohet kur ju kër-**

*Kur robërit e Mi  
të pyesin për Mua,  
(thua ju se) Unë jam afër,  
i përgjigjem lutjeve të lutësit,  
kur ai më lutet Mua.  
Prandaj, le t'i përgjigjen thirrjes Sime  
dhe le të më besojnë Mua,  
për të qenë në rrugë të drejtë.*

**koni diçka nga Ai.**" (Tirmidhi, Deavat, 3571)

**"Duaja është ajo që pengon caktimin dhe bamirësia e zgjat jetën."** (Tirmidhi, Kader, 6)

Duhet kuptuar se duaja nuk mjaftohet vetëm me leximin apo këndimin e disa lutjeve ditore, pa i futur ato në jetën praktike të përditshme. Nëse në një dua nuk ka realitet të veprës, atëherë ajo është e kotë dhe i përngjan ilaçit që blihet por nuk përdoret. Nga ana tjetër, kur besimtari kërkon ndihmë nga Allahu dhe mundohet të fitojë nga begatitë e kësaj bote, porse rruga që ai ndjek është e ndaluar, atëherë lutja e tij është e pakuptimtë, gjë që e hidhëron edhe Allahun (xh. sh.). Pra, duaja e një personi që merret me shitjen, përpunimin e alkoolit, apo që vepron ndonjë nga ndalesat tjera, nuk do të pranohet. Shijen dhe kuptimin më të mirë kësaj çështjeje ia jep ky hadith i Pejgamberit (a.s.): **"Dikush orvatet - udhëton shumë në emër të Allahut, dhe duke qenë në një gjendje të rëndë, i pluhurosur, i rraskapitur hap duart dhe i lutet Allahut duke thënë: O Allah!... Mirëpo ngrënia, pirja dhe ushqimi i tij është haram. E si të pranohet duaja e tij?"** (Muslim, Zekat, 65) Nga ky hadith kuptojmë se kushti për t'u pranuar duaja është pasja kujdes në fitimin e pasurisë, në ngrënien e ushqimit etj.

Duke pasur një jetë të larmishme dhe me shumë programe ditore, njeriu në shumë raste mund të futet në gabime dhe të bëjë gjëra që janë në kundërshtim me moralin njerëzor, ose thjesht të kryejë ndonjë vepër që nuk e preferon Islami. Për këtë shkak, Allahu i Madhëruar ua ka lënë myslimanëve dyert e hapura që t'i eliminonjë përmes lutjeve të ndryshme ditore këto gabime të paqëllimta, që në fund të kërkojnë pendim tek Ai. Nuk bën dallim nëse lutësi është mashkull apo femër, fëmijë apo i rritur, i ri apo plak, i pasur apo i varfër. Të gjithë janë të njëjtë para Allahut, gjë që do të thotë se shpërblimi për lutjet e bëra nuk do jetë sipas pozitës dhe pasurisë së tyre, por sipas devotshmërisë dhe sinqeritetit të lutësit. Gjëja më e mirë që duhet të bëjë besimtari në jetën e tij, është që nevojat dhe kërkesat t'ia drejtojë në mënyrë të drejtpërdrejt vetëm Allahut dhe askujt tjetër. Ai duhet të ketë kujdes në adhurimin dhe lutjet e tij, sepse po u lut dhe po mbeti me shpresë ndaj dikujt tjetër përveç Allahut, atëherë përveç se nuk i pranohet  
du a -

ja, ai do të meritojë edhe ndëshkimin. Allahu xh. sh. ka lidhje të drejtpërdrejtë me njeriun dhe Atij asgjë nuk i mbetet sekret. Ai e di atë që veprohet haptazi dhe fshehurazi, prandaj ai është më afër robit se gjithçka tjetër që ka. Në këtë kontekst Ai thotë:

**"O ju që besuat, përgjigjuni Allahut dhe të dërguarit kur ju ftojnë për atë që ju jep jetë, (për fenë e drejtë), dhe ta dini se Allahu ndërhyt ndërmjet njeriut dhe zemrës së tij, dhe se ju do të tuboheni te Ai."** (Enfal, 24)

Ajeti tjetër, i cili e detajon edhe më tepër përgjigjen e lutjes së besimtarit, thekson edhe dënimin për ata që i luten tjetër kujt përveç Tij: **"Zoti juaj ka thënë: Më thirrni Mua, Unë ju përgjigjem, e ata që nga mendjemadhësia i shmangen adhurimit ndaj Meje, do të hyjnë të nënçmuar në Xhehenem."** (Gafir, 60)

#### **KLASIFIKIMI I LUTJEVE NË LITERATURËN ISLAME:**

Pasi cekëm se lutja - duaja është një ndër themelet e rëndësishme në jetën e përditshme të besimtarëve, se ajo mund të ndërrojë caktimin e lig të njeriut, se ajo është çelësi i mëshirës etj., vlen të theksohet edhe vlera dhe rëndësia që dijetarët islamë i kanë dhënë asaj.

Me kalimin e Pejgamberit (a.s.) në botën e ahiretit, udhëheqja e rendit të islamit mbeti tek shokët e tij, respektivisht filloi me Ebu Bekrin (r.a.). Në këtë mënyrë gjenerata e parë ishte më e përpiktë ndaj zbatimit të asaj që porosiste Pejgamberi (a.s.), mirëpo me kalimin e kohës, u ndie nevoja për kompletimin e thënieve të Pejgamberit (a.s.) në një vend të veçantë, ashtu që myslimanët të informoheshin sa më lehtë në lidhje me zbatimin e fesë islame. Në këtë mënyrë, dijetarët e ndryshëm u përkushtuan pas klasifikimit të thënieve - haditheve të Pejgamberit (a.s.), ku përfshihej edhe klasifikimi i lutjeve - duave që kishte bërë Muhamedi (a.s.). Në kohën kur ishte gjallë. Duke filluar nga muhadithinet - dijetarët e shkencës së hadithit, me në krye Imam Buhariun (810-870), i kanë dhënë nga një kapitull të veçantë vlerës së duave- lutjeve në koleksionet e tyre dhe i kanë emëruar (*kapitulli mbi duatë, lutjet e mëngjesit dhe mbrëmjes etj*). Ata kanë tubuar të gjitha lutjet e bëra nga Pejgamberi (a.s.), qoftë gjatë kohës kur ishte në Meke apo Medine, qoftë kur ndodhej në vende dhe rrethana të ndryshme.

Mes librave në të cilat janë tubuar lutjet e Muhamedit (a.s.) si më i njohuri është libri i Imam Neveviut (613-676) "*Kitâbu'l-Edhkâr*".

Si shembull më konkret, në kohërat tona kemi edhe lutjet që bëhen gjatë ritualeve fetare në xhamitë dhe shtëpitë tona. Siç dihet, në fund të çdo namazi bëhet lutja në mënyrë kolektive, po ashtu në mënyrë kolektive bëhet edhe lutja e ushqimit, lutja e ndërtimit të ndonjë shtëpie, lutja e martesës, duaja e leximit të Kuranit (hatmes), duaja që bëjmë kur nisemi në udhëtime të ndryshe, duaja nëpërmjet së cilës falënderojmë Allahun për dhunti apo për ndonjë begati të ndryshme, duaja e prerjes së kurbanit, duaja në namazin e vitrit, lutjet që këndohen në hutben e xhumasë etj. Arsyet se pse këto lutje bëhen në mënyrë kolektive mund të jenë të ndryshme, mirëpo ajo që vlen të theksohet është: duke qenë se shumica e njerëzve nuk e njohin lëmin fetare, imami apo dikush tjetër që ka njohuri fetare prin në lexim - këndimin e lutjeve ditore në namaz, apo në një rast tjetër. Në një pikëpamje, kjo ndikon edhe në mësimin e lutjeve nga xhemati dhe nga të pranishmit që i dëgjojnë.

Nëse ndalemi dhe shikojmë nëse Pejgamberi (a.s.) i ka bërë lutjet haptazi apo kolektivisht, do të hasim në mënyra të shumëllojshme të bërjes së lutjeve. Ai (Allahu e mëshiroftë) ndonjëherë i ka bërë lutjet në heshtje, ndonjëherë me zë, e ndonjëherë tjetër edhe në tubime të ndryshme - në mënyrë kolektive. Të gjitha këto mënyra ia lehtësojnë besimtarit mësimin dhe praktikimin, e në të njëjtën kohë e ndihmojnë edhe në afrimin e tij me Krijuesin, duke marrë si shembull mënyrat e lutjes së Pejgamberit (a.s.). Por duhet të dimë se lutjet e Muhamedit (a.s.) kanë qenë përherë korrekte dhe gjithmonë janë pranuar, në dallim nga lutjet e besimtarëve të tjerë që ndodh edhe të mos pranohen.

Më tej, Allahu i Madhëruar i përgëzon besimta-

rët duke u treguar se çdo vepër të mirë që ata bëjnë ka për t'ua shpërblyer me dhjetëfishin e saj, por dhe u tërheq vëmendjet dhe shikimet atyre, që të mos e humbin shpresën në Allahun. Në këtë kontekst, i Lartmadhërishti kërkon përsëri nga besimtarët që, edhe pse të zhytur në mëkate, të drejtohen nga Ai përmes lutjeve, duke thënë:

**"Thuaj: O robërit e Mi, të cilët e keni ngarkuar me shumë gabime veten tuaj, mos e humbni shpresën ndaj mëshirës së Allahut, pse Allahu i fal të gjitha mëkatet, Ai është që fal shumë dhe është mëshirues!"** (Zumer, 54)

Që lutjet të jenë të pranuar, kërkohet që ato t'i drejtohen vetëm Allahut, që lutësi të mos i bëjë ato sa për sy e faqe, që ai të ruhet nga mëkate të tjera, të mos fusë dikë tjetër mes lutjes dhe Allahut. Preferohet që lutja të bëhet në kohët që ka caktuar Pejgamberi (a.s.) si: në pjesën e tretë të natës, në mes të ezanit dhe namazit, në mes të ezanit dhe hutbes së xhumasë, para perëndimit të diellit, gjatë udhëtimit, gjatë muajit të ramazanit, vizitës së Qabes etj. Të gjitha këto ndikojnë që Allahu të tregojë mëshirë ndaj robit të Tij dhe t'ia pranojë lutjen.

Në këtë mënyrë, gjatë çdo ulje të namazit, të gjithë besimtarët kërkojnë mbrojtje nga Allahu, begati dhe falje të prindërve, duke lexuar ajetin: **"Zoti ynë na jep të mira në këtë jetë, të mira edhe në botën tjetër, dhe na ruaj prej dënimit me zjarr!"** (Bekare, 201)

Po ashtu, ndikim të madh do të ketë edhe leximi i ajetu'l-kursijj dhe ajeti:

**"Zoti ynë, mos na i lako zemrat tona pasi na drejtove, na dhuro mëshirën Tënde, pse vetëm Ti je dhuruesi i madh". "Zoti ynë Ti je ai që në një ditë do t'i tubosh njerëzit, ditë që për të cilën nuk ka dyshim. Allahu nuk shkel premtimin e vet."** (Ali Imran, 8-9)





# Roli dhe karakteri i Profetit (a.s.)

Sejid Husejn Nasr

Në mjaft vargje të Kuranit Fisnik, si XXXIV:50, XL:55 dhe XLVII:19, përmendet fakti se Profeti i Islamit ishte njerëzor e jo hyjnor në kuptimin e një mishërimi, mirëpo këto ajete nuk e mohojnë aspak madhështinë përparësore të Profetit të Bekuar, si më i përkryeri i qenieve njerëzore, si "xhevahiri mes gurëve" në vargun e famshëm poetik. Përndryshe, si mundet po ai Kuran të pohojë se ai ishte zgjedhur si shembulli (*usve*) më i mirë për t'u ndjekur. Pikërisht në sajë të përsosjes së mbartur prej tij, ai u ka shërbyer si shembull i përkryer brezave të muslimanëve. Nuk ka asnjë dyshim se atij iu dha nga Zoti një shquarje e atillë, që është e pazakontë dhe jo thjesht njerëzore, siç përdoret kjo fjalë sot, ndonëse teologjikisht ai nuk ishte me prejardhje hyjnore, por njeri. Nuk ka provë më të mirë të shquarjes së tij të jashtëzakonshme, sesa pagabueshmëria e tij (*'ismeh*), pra fakti që ai ishte i mbrojtur nga Zoti prej gabimit, qoftë në kuptimin e veçantë - që vetë lënda e tij kish qenë që prej fillimit imune nga mëkati, ose që ai ishte "larë" dhe kulluar nga engjëjt - siç dëshmon ngjarja e treguar më lart për larjen e kraharorit të tij nga melekët. Gjithsesi, nuk ka rrezik më të madh për muslimanët e sotëm se ai i të reduktuarit të madhësisë së mrekullueshme të Profetit të Bekuar në terma mendjengushta njerëzore, me justifikimin e jashtëm se ai ishte thjesht njeri, por duke i shërbyer në të vërtetë [me këtë reduktim] humanizmit mbizotërues të Perëndimit modern. Fakti se Profeti i Bekuar ishte njeri, nuk do të thotë se ai ishte i zakonshëm si çdo qenie njerëzore, por që gjendja njerëzore e zotëron mundësinë e madhësisë dhe plotësisë të shpalosur nga personaliteti dhe karakteri i tij. Të përsiaturit mbi jetën, virtutet dhe arritjet e Profetit të Bekuar, do të thotë të kuptohet jo vetëm madhështia e fuqisë së Zotit dhe e profetëve të tij, por edhe fakti se njerëzimit si tërësi jeton kaq poshtë nivelit të ekzistencës. Janë pikërisht ata, që e ngrejné shpalosin njerëzimit mundësinë totale më të lartë dhe njeriut s'i bëhet dot dëm më kuptimin e fjalës "njeri" në rasën e saj në standartet mendjengushta dhe i madh se sa të reduktuarit e tyre të njeriut modern; në vend që shpesh të papërfillshme të shembuj të përhershëm, t'i mbajnë si ideale që ndihmojnë njerëzit ta realizojnë (të paktën në njëfarë shkaktërësore dhe të plotë të gjendjes të gjendjes njerëzore.



Për breza të tërë myslimanësh, para se humanizmi i botës moderne të ndotte mendjet dhe shpirtrat e shumë prej tyre, Profeti i Bekuar e përmbushi një mision të tillë në nivelin më të lartë dhe ai mbetet e do të mbesë, për sa kohë që Islami të jetojë si fe, shembulli i epërm për t'u ndjekur nga njerëzit. Profeti i Bekuar, në njëfarë kuptimi, e kaloi plotësisht gjithçka njerëzore për t'ia dalë në përmbushjen e këtij funksioni, ashtu siç depërtoi Islami në çdo aspekt të jetës njerëzore, që të mund ta integronte krejt jetën në Qendrën, që i shenjtëron dhe u jep kuptim të gjitha gjërave.

Nuk ekziston praktikisht asnjë aspekt i jetës njerëzore, të cilin Profeti i Islamit të mos e ketë përjetuar. Në nivelin personal dhe njerëzor, ai provoi humbjen e prindërve në moshë të njomë, vetminë, trysnitë shoqërore, varfërinë materiale dhe praktikisht çdo lloj vështirësie që mund të kalojë një i ri në shoqëri.

Më vonë, ai do të dëshmonte çdo formë pikëllimi, humbjen e gruas së tij të dashur Hatixhe, vdekjen e hershme të djemve, tradhtinë e anëtarëve të fisit, kërcënime të vazhdueshme të jetës, të pronës e të familjes së tij, pa përmendur rreziqet e vazhdueshme që ndeshi kauza për të cilën ai ishte zgjedhur dhe së cilës ia kishte kushtuar tërësisht vetveten: Islami.

Ngaqë jeta njerëzore është e thurur me fije gëzimi e pikëllimi, Profeti i Islamit u bekua gjithashtu me përvojën e çdo gëzimi të mundur për qeniet njerëzore, duke filluar sigurisht me atë gëzim më të lartë, e në fakt ekstazë, që është njohja dhe dashuria e Zotit, dhuntia supreme që iu dha si bekim i veçantë nga Qielli, me një gradë ekzaltimi e intensiteti të papërfytyrueshëm për qeniet e tjera njerëzore. Por, në nivelin më të zakonshëm të jetës njerëzore, ai u bekua me gëzimin e një martese shumë të lumtur me Hatixhen, e të paturit të një bije si Fatimja, e një kushëriri dhe dhëndri si Aliu, devotshmëria e të cilit ndaj Profetit dhe përkushtimi ndaj thirrjes së tij janë të jashtëzakonshme me çfarëdo lloj standartesh që të gjykohen. Profeti i Bekuar kishte po ashtu shokë e nxënës të përkushtuar si Ebu Bekrin dhe Selmanin dhe e kishte shijuar kuptimin e plotë si të miqësisë njerëzore, ashtu dhe të Hyjnores (duke qenë vetë miku i Zotit, *habib-Allah*). Ai kishte provuar aspekte të natyrës njerëzore, që nga pozita e favorshme

e të qenit jetim i varfër, tregtar i suksesshëm, udhëheqësi i rrezikuar i një bashkësie gjysëm-klandestine dhe prijësi ngadhënjimtar i një shoqërie të re, e cila së shpejti do të pushtonte pjesën më të madhe të botës. Ai u kishte shitur mallra tregtarëve të vegjël, si dhe u kishte dërguar letra perandorëve e sundimtarëve më të fuqishëm mbi dhé, duke i ftuar në kauzën e Islamit. Ai kishte shijuar si humbjen, edhe fitoren, e madje ishte bekuar me mundësinë e përjetimit të gëzimit të pakrahasueshëm të faljes së armiqve të tij më të këqinj në çastin e çlirimit të Mekës. Së fundi, ai kishte shijuar edhe dështimin edhe suksesin. Ai ngulmoi për vite të gjata me durim e mbështetje te Zoti, duke dëshmuar dështime të hidhura dhe pastaj u destinua të shijonte ëmbëlsinë e sukseseve të njëpasnjëshme, deri në shkallën sa të realizonte, para vdekjes, gjithçka

që kishte synuar të arrinte. Me siguri ka pak gjë, që një musliman mund të kalojë dhe pak situata që mund të ndeshë në jetën njerëzore, pa pasur një precedent në jetën e Profetit, që mund t'i shërbejë si model dhe burim frymëzimi e udhëzimi.

Përsa u përket funksioneve themelore në shoqëri, përsëri i Dërguari i Allahut ishte destinuar nga Zoti t'i përmbushte thujtë të gjitha. Ai ishte mësues, kryefamiljar, tregtar, prijës politik e shoqëror, udhëheqës ushtarak, gjykatës dhe sundues suprem, për të mos folur për funksionet specifike si sjellja e një Ligji Hyjnor dhe Fjalës së

Zotit për njerëzimin, duke i udhëzuar njerëzit si në dije ezoterike, ashtu dhe ekzoterike, i dhuntisur me njohje të plotë të natyrës njerëzore dhe psikologjisë së njerëzve në çaste të ndryshme e raste të larmishme, etj.

Në secilin prej këtyre funksioneve, ai la pas një trashëgimi të vyer, e cila është bërë pjesë thelbësore e Islamit dhe e kulturës së tij. Si mësues, Profeti i Bekuar ishte jashtëzakonisht i suksesshëm në përcjelljen e diturisë së niveleve të ndryshme tek tipa shumë të ndryshëm njerëzorë. Në të vërtetë, ai ishte mësuesi i epërm. Ai ishte aq i suksesshëm si mësues, sa që ende sot mbetet mësuesi më i rëndësishëm për muslimanët. Thëniet dhe veprat e tija, mendimet dhe veprimet e tija e mësojnë akoma bashkësinë e tij ditë e natë, ndërkohë që udhëzimet më intelektuale e shpirtërore të kumtuara

*Të përsiaturit mbi jetën, virtytet dhe arritjet e Profetit të Bekuar, do të thotë të kuptohet jo vetëm madhështia e fuqisë së Zotit dhe e profetëve të tij, por edhe fakti se njerëzimi si tërësi jeton kaq poshtë nivelit të njerëzores së vërtetë.*

prej tij vazhdojnë të formësojnë dhe të mbrujnë mendjet e shpirtat e atyre anëtarëve të bashkësisë Islame, që janë në kërkim të përsosjes shpirtërore.

Si kryetar familjeje, Profeti i Bekuar krijoi një shoqëri në miniaturë dhe në fakt një univers, struktura dhe marrëdhëniet e brendshme të të cilit u interesojnë pamasë myslimanëve të devotshëm edhe sot e kësaj dite. Mënyra e tij e sjelljes me bashkëshortet, fëmijët dhe nipat e tij të vegjël, Hasanin e Huseinin, detyrimet dhe funksionet brenda shtëpisë, ndjenja e përgjegjësisë ndaj familjes, ngulitja nga ana e tij e dashurisë dhe besimit mes anëtarëve të familjes e shumë elemente të tjera janë pjesë e Sunnetit dhe përbërës të karakterit të tij. Këto e bëjnë atë një shembull për t'u ndjekur e emuluar jo vetëm si individ, por edhe në kontekstin e familjes njerëzore. Po ashtu, mënyra në të cilën ai silllej kur ishte tregtar, kur gjykonte një rast, ose vepronte si prijës ushtarak në mejdan, apo sundonte një bashkësi njerëzore a vendoste mbi një problem diplomatik, zbulojnë secila aspekte të një qenieje që ishte zgjedhur për të përm-bushur tërë mundësitë e ndodhura në natyrën njerëzore. Është kthjelluese të mbahet mend se i njëjti person që udhëhoqi betejën e Bedrit dhe i cili më vonë sundoi një segment të tërë të universit, përgjunjej në dyshemenë e shtëpisë së tij modeste, që nipat t'i hypnin shpinës e ta ngisnin nëpër dhomë. Vetëm një peygamber mund të arrijë një përsosje të tillë madhështie e përlulesie, fuqie dhe bujarie, por fakti se mund ta arrinte këtë tregon se sa i madh mund të jetë njeriu, sikur vetëm ta dinte se kush është.

Sigurisht, çdo profet dhe sidomos i fundit prej tyre i zotëron të gjitha virtytet njerëzore, por në rastin e secilit profet veçohen dhe theksohen një sërë virtytesh, që lidhen me strukturën e fesë së sjellë në këtë botë prej tij. Virtyti i dallueshëm i disa profetëve ka qenë dashuria dhe i disave tërheqja, frika e Zotit e asketizmi. Sa i përket Peygamberit, virtytet e tij dalluese ishin sinqeriteti ndaj Zotit e të Vërtetës, bujaria ndaj të gjitha qenieve dhe varfëria e përshpirtshme e shoqëruar me thjeshtësi dhe përlulesi.

Profeti i Bekuar ka thënë: "Varfëria është krenaria ime" (*el-fekr' fakhri*) dhe spiritualiteti islam quhet shpesh "varfëria muhammedane" (*el-fekr el-muhammedi*). Kjo nuk nënkupton se Peygamberi ishte kundër njerëzve të pasur apo se i përbuzte të mirat e kësaj bote. Fundja, vetë bashkëshortja e tij Hatixhja ishte tregtare e pasur. Ajo çfarë ky *fekr* donte të thoshte, ishte në thelb përlulesia dhe vetëdija për hiçin tonë para Zotit, duke parapëlqyer thjeshtësinë ndaj zbukurimeve e luksit. Profeti i Bekuar ishte i rreptë ndaj vetes dhe kërkonte vazhdimisht ta disiplinonte veten. Ai gjithmonë e theksonte përlulesinë, ndonëse ishte më i madhi i njerëzve dhe pa dyshim i ndërgjegjshëm për natyrën e tij. Por shumë nga Sunneti dhe *edebi*, ose mënyra e sjelljes së tij, ekziston me qëllimin e rrënjosjes së virtytit të përlulesisë (*teuadu' apo hushu'*), forma më e lartë e të cilit është vetëdija jonë e të qenit asgjë përpara Zotit, e simbolizuar edhe nga sexhdet gjatë namazit të përditshëm.

Profeti i Bekuar ishte gjithashtu plot bujari e zemërgjerësi (*keramet* ose *sheref*). Po aq sa ç'ishte i rreptë me veten, ai ishte bujar me të tjerët. Fisnikëria e karakterit do të thotë edhe të japësh edhe të marrësh, dhënien e vetes dhe përpjekjeve, mendimeve e zotërimeve tuaja të tjerëve e faljen e gabimeve të tyre dhe asaj që të kanë bërë. Jeta e Profetit të Bekuar ishte plot me raste, në të cilat ai u dha të tjerëve e ishte bujar në kuptimin më të plotë të termit, si dhe me çaste faljeje, ndër të cilat pushtimi i Mekës është shembulli i epërm. Këtu u shpalo fisnikëria e karakterit në majën e saj, sepse ai ua fali, duke qenë në kulmin e fuqisë, atyre që i kishin bërë padrejtësi në mënyrën më të keqe përgjatë viteve. Gjatë disa çasteve kur vepronte si gjykatës dhe nuk i falte shkeljet e dikujt, ai kishte ndërmend drejtësinë e Zotit dhe mirëqenien e bashkësisë. Ai nuk veproi si individ, por si funksionues i një kolektiviteti




njerëzor. Përndryshe, nuk pati kurrë ndonjë ndjenjë hakmarrjeje personale ose shpagimi në veprimet dhe trajtimin e të tjerëve prej tij.

Së fundi, Profeti i Bekuar zotëronte virtytin e sinqeritetit (*ihlas*) në plotësinë e vet. Nuk ka veprim që ai kreu ose fjalë që shqiptoi pa sinqeritet të plotë. Por mbi të gjitha, ai qe i sinqertë me Zotin dhe sinqeriteti i tij ishte i njëjtë si besnikëria (*siddk*) e tij. Fakti se ai u quajt el-Emin (i besuari) qysh në rini do të thotë se kjo cilësi ishte e pranishme në mënyrë të dallueshme tek ai që nga fëmijëria e ishte përsosur kur ai u zgjodh si i Dërguar i Zotit. Jo vetëm që Profeti nuk gënjente kurrë, por si rezultat i këtij virtyti të sinqeritetit dhe të besnikërisë, ai mundi ta vendoste gjithçka në vendin e vet, të ishte i logjikshëm dhe objektiv në gjykimin e ngjarjeve, ideve e personave dhe të shmangte shtrembërimet subjektive e individualiste. Por mbi të gjitha, kjo donte të thoshte se ai ishte i prirur të shihte të vërtetën e ta merrte atë pa ia ndryshuar natyrën dhe përmbajtjen. Ja përse ai u bekuar me dijen e më të thellës të së vërtetave, që është *La ilahe il-la'Llah* dhe u zgjodh për ta përhapur këtë të vërtetë qendrore dhe thelbësore mbi faqen e dheut.

Karakter i Pejgamberit të Bekuar, i stolisur me virtytet e sinqeritetit, bujarisë dhe përlësisë ose besnikërisë, fisnikërisë dhe thjeshtësisë, u spërkat po ashtu edhe nga parfumi i butësisë dhe gufimi i lumturisë, me të cilat ai kujtohet edhe sot anekënd botës islame. Kur termi "karakter muhammedan" (*el-khulk el-muhammedi* në arabisht dhe *khuj-i mohammedi* në persisht e urdisht) përdoret në disa gjuhë islame, ai nënkupton gjithmonë këtë ndjesi butësie dhe gëzim i

të shoqëruar me thjeshtësinë, fisnikërinë dhe besnikërinë e përmendur më lart. Kur pohohet se filani ka *khu* ose *khulk-i muhammedi*, do të thotë se ai është i bekuar me këto virtyte, se nuk zemërohet pa shkak, se është i qetë dhe i përmbajtur, se ka durim e mirësi ndaj të tjerëve, se rri në gjendje gëzimi e lumturie dhe nuk jepet pas agjitimit e ankimit të vazhdueshëm. Myslimanët nuk dështojnë të kujtojnë se Profeti i Bekuar qeshte gjithmonë dhe kishte një ndjesi lumturie e gëzimi, që i buronte nga fytyra, sigurisht pa përjashtuar "zemërimin e shenjtë", kur ndeshte kundërshtuesit e së Vërtetës. Por gjëja e mahnitshme është se në shpirtin e tij ekzistonte si fuqia, ashtu edhe butësia, si ashpërsia dhe pastërtia e shkretëtirës, ashtu dhe puhiza e parfumi i trëndafilishtes. Ai e shndërroi botën dhe kreu detyrat më të jashtëzakonshme, nën vështirësi të pabesueshme, por gjithnjë me mirësinë e bujarinë që i karakterizon të dashurit e Zotit (*eulija*). Në të ishin bashkuar përsosjet më të larta. Ai ishte me të vërtetë njeriu i përkryer, para të cilit engjëjt u urdhëruan të përuleshin. Ja përse Zoti dhe engjëjt e Tij e lavdërojnë dhe e bekojnë atë, dhe besimtarët urdhërohen që edhe ata ta lavdërojnë dhe ta bekojnë, duke i modeluar jetët e tyre sipas tij. Ç'është e vërteta, lavdërimi i Profetit është akti i vetëm që njeriu e ndan me Zotin dhe me engjëjt.

*Karakter i Pejgamberit të Bekuar, i stolisur me virtytet e sinqeritetit, bujarisë dhe përlësisë ose besnikërisë, fisnikërisë dhe thjeshtësisë, u spërkat po ashtu edhe nga parfumi i butësisë dhe gufimi i lumturisë, me të cilat ai kujtohet edhe sot anekënd botës islame.*



# Disiplina trup-shpirt në Ramazan

*Ali Riza Jemel*

Meqë në shekullin tonë qytetërimi është shndërruar në fuqi dhe linja fizike, puna më e madhe e njeriut i kushtohet mbajtjes në formë të trupit, veprimtaritë sportive të organizuara në sektor më vete, degët e ndryshme të sporteve, ministrinë përgjegjëse për mbarëvajtjen e veprimtarive sportive dhe drejtoritë e përgjithshme që varen prej tyre, degët e mjekësisë të specializuara në kurimin e sëmundjeve fiziologjike, dietat e praktikuar për të ruajtur dhe zhvilluar formën fizike, të gjitha këto tregojnë se rëndësia e një fiziku të mirë ka dalë në plan të parë, duke lënë pas dore kujdesin për një shpirt të bukur.

Ndërsa shprehemi në këtë mënyrë, nuk kemi aspak qëllim të nënvlerësojmë rëndësinë e një shëndeti të mirë dhe një fiziku të fuqishëm, sepse gjithsesi trupi është kafsha mbartëse e shpirtit.

Lidhjen që ekziston mes trupit dhe shpirtit, mendimtari Gazali e krahason me rastin e haxhiut që shkon në haxh së bashku me devenë e tij. Nëse ai do ta shpenzonte të gjithë kapitalin që ka për devenë e tij, atëherë ai do të mbetej trokë, por nga ana tjetër, nëse e nënvlerëson ushqimin dhe fizikun e devesë me të cilën po udhëton, atëherë ka për të mbetur në mes të rrugës. Zgjidhja me e logjikshme është t'u japë secilës prej tyre, hakun që meritojnë, duke vendosur kështu një ekuilibër.

Kohët e fundit janë duke u rekomanduar dieta të ndryshme për të humbur kilet e tepërta e për t'u ruajtur nga sëmundjet që burojnë nga të ushqyerit e tepërt dhe lëvizjet e pakëta, arsye për të cilën janë duke u shpenzuar vlera të mëdha parash.

Ofrohen receta ushqimore për t'u praktikuar në periudha tre-ditore, javore, mujore apo gjashtëmujore. Pirja vetëm e ujit për periudha të caktuara, apo të ushqyerit vetëm me shalqi a pjepër, ngrënia e përzjerje të caktuara të ushqimeve apo dhënia gjak, janë vetëm disa prej praktikave të kryera me këtë qëllim.

Si është e mundur që njerëzit, të cilët bëjnë shpenzime të mëdha dhe pehriza të rënda vetëm që të shpëtojnë nga sëmundjet fizike, nuk e marrin aspak në konsideratë dietën fizike e shpirtërore që përmban muaji i Ramazanit, një dietë nëpërmjet së cilë mund të ruhen nga sëmundjet shpirtërore që përbëjnë rrezikun e tyre të vërtetë?

Kur Profeti (a.s.), qe shprehur **“Agjëroni që të jini të shëndetshëm”**, ka pasur për qëllim shëndetin si në planin fizik, ashtu edhe në atë shpirtëror. Programi i agjëritimit dhe i muajit Ramazan, të cilin ua porosiste njerëzve (si edhe e praktikonte vetë), kryente detyrën e “dietës” më të vlefshme në formimin e një personaliteti të përkryer.

Sëmundjet moralo-shpirtërore janë më të rënda se sëmundjet fizike për njeriun, ndërsa ndikimi negativ i llojit të parë të sëmundjeve ka efekt më shkatërrues për individin e për shoqërinë. Prandaj, për të shpëtuar nga sëmundjet shpirtërore duhet që Kuranin ta konsiderojmë si një kartë, agjërimin si një spital, ndërsa muajin e Ramazanit si një saunë që na pastron nga ndotjet shpirtërore.

Ka lloje të ndryshme sëmundjesh shpirtërore, si: injoranca, përtacia, kopracia, egoizmi etj. Me një dietë të rreptë të zbatuar gjatë muajit Ramazan është e mundur të shpëtojmë nga këto sëmundje.

Ilaçi i parë që duhet marrë për të shpëtuar nga injoranca, është të lexojmë tekstin dhe komentet e Kuranit, në të cilin urdhri i parë i zbritur qe “Lexo”, ndërsa më pas duhet t’i zbatojmë ato që lexojmë e të nxjerrim mësim, të mësojmë prej tyre. Leximet pjesë-pjesë të Kuranit gjatë natës apo gjatë ditës, leximet individuale dhe përsiatjet mbi ajetet kuranore, duhet të na ndriçojnë me rrezet e Kuranit. Gjatë muajit Ramazan duhet ta bëjmë hatme Kuranin në kushtet që sapo treguam, të paktën një herë.

Për të shpëtuar nga përtacia duhet që namazet t’i falim në kohën e tyre, të falemi së bashku me xhemat. Në mënyrë të veçantë nuk duhet të na ikin namazet e teravisë, madje po të jetë e mundur t’i falim ato nëpër xhami të ndryshme e të ngrihemi për syfyr. Në mënyrë të veçantë janë namazet ato që formojnë një program të disiplinuar për jetën.

Për të shpëtuar nga sëmundja e koprracisë ka rrugë shërimi siç janë dhënia e zeqatit, e sadakai fitrit dhe e lëmoshave të tjera, si dhe shtruarja e sofrës së iftareve për agjëruesit e tjerë. Për të na treguar se sa mjet i mirë është zeqati për pastrimin shpirtëror, Zoti thotë në Kuran: **“Pranoje një pjesë të pasurisë së tyre si sadaka që do t’i pastrojë ata nga gjynahet dhe do t’i pastrojë shpirtërisht.”** (Tevbe, 103) Sa më shumë që të dhurojë njeriu,

aq më shumë i shtohet fuqia e tij për të dhuruar, ndërsa kur nuk dhuron, kopracia i shndërrohet në shprehje të karakterit të tij.

Dieta kundër sëmundjes së përgojimit, veçanërisht kur je agjërueshëm, është ta zotërosh fjalën që thua, dhe kur të tjerët kërkojnë të hyjnë në konflikt me ty nëpërmjet fjalëve, atëherë duhet të largohesh nga rrethi i thashethemeve dhe i ngatërresave, duke u shprehur ashtu siç na ka mësuar Profeti (a.s.): **“Unë kam agjëruar sot”**. Agjërimi i personave që bëjnë thashetheme, që përgojnë dhe kërkojnë të grinden me fjalë, nuk është gjë tjetër përveç se të rrinë me barkun bosh. Ilaçi më i mirë për parandalimin e përgojimit, është të lexosh sa më shumë Kuran dhe të bësh sa më shumë dhikr.

Që të shpëtosh nga sëmundja e mosmirënjohjes, duhet të pranosh përherë e më shumë begatitë kur përjeton ndjenjën e urisë, të meditosh se çfarë do të kishte ndodhur me ne po të mos ishin këto begati, si dhe ta falënderosh Zotin që na i ka dhuruar këto begati të pafundme. Ndodh shumë herë që njeriu të mos e kuptojë begatinë që zotëron, por vlerën e tyre e kupton vetëm atëherë kur i mohohen ato begati. Në këtë kuptim agjërimi është një mjet falënderimi.


Mënyra e duhur për kurimin e egoizmit dhe të mungesës së mëshirës është të mendosh për hallet e të uriturve dhe të të mjerëve, t’i vizitosh ata, të mund tua fitosh zemrat dhe të marrësh dua prej tyre. Uria dhe pamundësia që përjetojmë gjatë agjëritimit duhet të na shtyjë të mendojmë më shumë rreth jetës së përditshme të njerëzve të uritur dhe të varfër.

Siç vihet re, Kurani dhe muaji i agjëritimit, Ramazani, përbëjnë një dietë të vlefshme dhe një muaj të tërë kurimi, krejtësisht të lirë nga aspekti ekonomik dhe të lehtë për t’u përmbushur, por që të shëron nga një numër të madh sëmundjesh si shpirtërore, ashtu edhe fizike.

Lutem që edhe muaji i Ramazanit që po vjen të shndërrohet në një dietë të fortë dhe në një stinë kurimi për shpirtrat e sëmurë që kanë etje të kurohen. Për sa kohë që nuk pastrohemi nga mëkatet, të cilat janë burimi i vërtetë i sëmundjeve, nuk do të jetë e mundur të jetojmë të shëndetshëm në këtë botë, ashtu siç nuk do të jetë e mundur as të hyjmë në vendin e prehjes së përhershme që është parajsja.

*Ilaçi i parë që duhet marrë për të shpëtuar nga injoranca, është të lexojmë tekstin dhe komentet e Kuranit, në të cilin urdhri i parë i zbritur qe “Lexo”, ndërsa më pas duhet t’i zbatojmë ato që lexojmë e të nxjerrim mësim, të mësojmë prej tyre.*





XHAMIA E PARRUCËS  
SHKODËR - MARUBI 1912

# FOTOJA E MUAJIT



# Një Ajet

*Me emrin e Allahut,  
të Gjithëmëshirshmit, Mëshirplotit!*

**“O ju që besuat! Agjërimi u është bërë obligim siç ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm.”** (Bekare, 183)

Agjërimi është një adhurim, obliguar për çdo mysliman, ashtu siç ka qenë detyrim edhe për të gjithë popujt e tjerë para islamit. Si çdo adhurim tjetër edhe agjërimi ka dobi të shumta individuale dhe shoqërore. Përveç se është adhurim që shpreh nënshtrimin e plotë ndaj vullnetit të Allahut, agjërimi njëkohësisht luan një rol të rëndësishëm, duke kontribuar në procesin e ndryshimit të vetvetes dhe ripërtëritjen shpirtërore. Ai ka ndikime të mëdha në përmirësimin e sjelljeve të njeriut dhe, për pasojë edhe përmirësimin e sjelljes kolektive. Agjërimi ka qëllime dhe përfitime me interes, jo vetëm për vetë agjëruenin, por edhe qëllime e përfitime që shkojnë në interes të të gjithë shoqërisë islame.

Agjërimi nuk është thjesht privim nga ngrënia dhe pija, por më tepër është privim i përkohshëm i së lejuarës, për të lehtësuar ndalimin e përhershëm të së ndaluarës. Së pari, ramazani sjell ndryshime dramatike në mënyrën gastronomike dhe, në këtë mënyrë, jep shenjë e parë për ndryshime rrënjësore që duhet të ndodhin gjatë muajit të agjërit në qenien e njeriut. Ndryshimit të kohës dhe mënyrës së të ushqyerit, i shtohet ekstra edhe namazi i teravive, mbas namazit të jacisë. Kështu, fiziku i përshtatet këtij ndryshimi, duke u hapur rrugë ndryshimeve shpirtërore. Të gjitha këto ndryshime horizontale që sjell agjërimi, pasohen me një sërë ndryshimesh vertikale, si privimi i plotë nga çdo ndjenjë negative, duke shprehur mirësjellje, dashuri dhe respekt ndaj njëri-tjetrit. Në këtë fazë, çdo organ merr përsipër detyrën dhe përgjegjësitë e veta. Kështu, goja nuk privohet vetëm nga ushqimi, por edhe nga fjalët e pahijshme. Në të njëjtën kohë, agjëron edhe zemra, duke iu drejtuar Allahut me sinqeritet të plotë. Ky është muaji i ndryshimit edhe për faktin se është muaji, në të cilin ka zbritur Kurani Famëlartë, nëpërmjet të cilit ndryshoi e gjithë historia e njerëzimit. Muaji i ramazanit thërret në solidaritet dhe e nxit njeriun për bamirësi. Për këtë arsye, në muajin e ramazanit kemi edhe institucionin e sadekatit-l-fitrit, i cili u jepet të varfërve dhe kjo tregon se muaji i ramazanit është muaj i solidaritetit dhe i bamirësisë.

Të gjitha këto ndryshime që sjell agjërimi, janë në funksion të qëllimit të tij kryesor, i cili është devotshmëria. Sepse devotshmëria është faktori kryesor që motivon njeriun në kryerjen e veprave të pëlqyera nga Allahu teala dhe largimin prej veprimeve që janë të urryera nga Ai. Devotshmëria e mban besimtarin larg çdo mëkati, sado i vogël qoftë. Besimtarët që janë të vetëdijshëm për rëndësinë e devotshmërisë, e shohin si një qëllim që duhet arritur me një dëshirë të zjarrtë. Dhe agjërimi na shfaqet si rrugë, si mjet për të arritur këtë qëllim fisnik.



# Një Hadith

*Transmetohet nga Ubade ibn Samit (r.a.)  
se Resulullahi (s.a.o.s.) i ka thënë:*



*"Kush agjëron muajin e Ramazanit, duke qenë besimtar dhe duke shpresuar shpërblimin prej Allahut, atij do t'i falen të gjitha mëkatet e shkuara."*

Pranimi i veprave dhe ibadeteve nga ana e Allahut, bëhet i mundur vetëm me plotësimin e dy kushteve: besimit dhe sinqeritetit, siç shprehet qartë në hadithin e mësipërm me shprehjet duke "qenë besimtarë dhe duke shpresuar shpërblimin prej Allahut". Nga këto që thamë, mund të na vijë ndërmend pyetja se si mundet një njeri të shfaqë vepra besimtari, pa qenë besimtar? Por fatkeqësisht, realiteti me të cilin përballemi, është me të vërtetë jo i këndshëm. Shumë njerëz, megjithëse jobesimtarë, për arsye nga më të ndryshmet kryejnë një sërë ibadetesh. Nuk janë të pakta rastet, kur individë të ndryshëm besojnë se puna që kryejnë është obligim nga ana e Allahut teala, por, kur bëhet fjalë për zbatimin e saj, e përziejnë me hipokrizi, duke e kryer për shkaqe nga më të ndryshmet. Këto lloj veprash, sado të duken si ibadete, nuk e arrijnë gradën e vlefshmërisë. Dhe konkretisht, hadithi në fjalë tërheq vëmendjen për këtë anë të rëndësishme të ibadeteve, duke i përgëzuar ata që i plotësojnë këto kushte në agjërimin e tyre se do t'u falen të gjitha mëkatet e kaluara. Shprehjen "falen mëkatet", dijetarët e kanë komentuar si mëkate të vogla dhe, në rastet kur nuk ka mëkate të vogla, një agjërim i kryer sipas përshkrimit të hadithit, lehtëson mëkatet e mëdha. Përsëri duke u bazuar te hadithi, dijetarët kanë arritur në konkluzionin se, edhe nëse një person, për shkaqe të arsyeshme nuk arrin ta plotësojë muajin e ramazanit, futet në grupin e të përgëzuarve në hadith për sinqeritetin në qëllim. Në hadith nuk përfshihen vetëm njerëzit që kanë mëkate, por edhe ata që nuk kanë mëkate për t'u falur, të cilët me anë të agjërimit arrijnë pozita më të larta tek Allahu teala. Vetëm nëpërmjet mënyrës së agjërimit, sipas përshkrimit të hadithit, agjërimi i ramazanit mund të luajë rolin e vet në ndryshimin dhe ngritjen shpirtërore të njeriut. Ramazani është epiqendër për përforcimin e fuqive shpirtërore, psikike e morale në jetën e popullit apo të individit. Myslimani, i cili agjëron me vullnet të lirë e bindje të plotë, për hir të Zotit e afrimit ndaj Tij, merr pjesë aktive në rindërtimin e vlerave fisnike.

## **Mësimet që nxjerrim nga hadithi:**

1. Kush beson në obligueshmërinë e ramazanit dhe shpërblimin e pret vetëm prej Allahut, atij do t'i falen gjynahet e shkuara.
2. Besimi tek Allahu dhe shpresa e shpërblimit vetëm tek Ai, është kusht për vlefshmërinë e ibadeteve.



## SINQERITETI NË DHURIM

Ihlasi është sinqeriteti në robëri dhe pastërtia në qëllim. Takvaja dhe Ihlasi janë dy anët e fshehta të robërisë, të cilat nuk ndahen nga njëra tjetra, ashtu si dy forma të ndryshme shprehjeje që synojnë të përcjellin të njëjtin mendim. Ihlasi është takimi i njeriut në zemrën e tij me Krijuesin, ose thënë ndryshe shpërfaqja në zemër e cilësive të bukura të Allahut, si: mëshira, dhembshuria, falja, qetësia shpirtërore, si dhe e cilësive tjera të bukura. Ihlasi është të kërkuarit e pëlqimit të Allahut në çdo gjendje, në çdo veprim, madje në çdo frymëmarrje.

Kur zemra e njeriut zhvishet nga sinqeriteti, atëherë njeriu i dorëzohet tërësisht interesave të egos së tij. Fundi i këtij udhëtimi nëpër shtigjet e interesave të egos përbën të robëruarit ndaj diçkaje tjetër përveç Zotit, të paktën me zemër. Në një ajet kuranor thuhet:

**“A e ke parë ti atë, që epshin e vet e ka marrë për zot? A do t’i bëhesh mbrojtës atij?”** (el-Furkan, 43)

Në lidhje me mungesën e ihlasit në veprimet e njeriut, Pejgamberi (a.s.), shpreh:

**“Më shumë, në lidhje me umetin tim, më frikëson shirk-u. Me fjalën shirk nuk nënkuptoj adhurimin e hënës, të diellit apo adhurimin e idhujve, por kam parasysh çdo vepër që bëhet për çdo qëllim tjetër përveçse për të fituar kënaqësinë e Allahut, dhe egon e fshehtë (dëshira për t’u shfaqur e dukur).”** (Ibn Maxhe, Zuhd, 21)

Për këtë arsye, të gjitha adhurimet që nuk kryhen për të fituar kënaqësinë e Zotit, por për servilizëm e për t’u dukur, ngjajnë me një gjeometri të thatë e të zbratur, janë vepra, mirësia e të cilave është shkatërruar. Jo më kot në një hadith profetik thuhet:

**“Veprat shpërblehen sipas qëllimit...”** (Buhari, Iman, 41)

Kështu, Sinqeriteti në Dhurim është dhënia vetëm e vetëm për hir të Allahut, duke pasur si qëllim vetëm kënaqësinë e Tij, duke menduar se je duke ia blatur këtë dhuratë Lartmadhërisë së Tij.

Hazreti Pejgamberi (a.s.) ka thënë:

**“Çdo sadaka (lëmoshë) që jepet nga malli hallall, është Allahu i Gjithëmëshirshëm që e merr me dorën e tij duke e pranuar.”**

**“S’ka asnjë dyshim që sadakaja (lëmosha) kalon në dorën e Allahut pa kaluar ende në dorën e nevojtarit.”** (Munavi, Kunudhul Hakaik, fq. 34)

Gjatë aktit të dhurimit ne kemi të bëjmë drejtpërsëdrejti me Allahun e Lartmadhëruar, arsye për të cilën duhet të tregohemi të kujdesshëm dhe të jemi në një gjendje të lartë shpirtërore. Duhet të arrijmë të japim e të dhurojmë, duke thënë **“O zoti im, vetëm e vetëm për Ty”**, pa pritur asnjë lloj komplimenti apo urimi nga qeniet e përkohshme (njerëzit), duke qëndruar larg dëshirës për t’u dukur, larg dëshirës për famë, pa u pushtuar nga nefsi dhe pa pasur kurrfarë qëllimi tjetër tokësor. Kjo përbën gjënë më thelbësore në ihlasin e dhurimit.

### SHENJA E IHLASIT: TË MUND TË GJESH NEVOJTARIN E VËRTETË

Të përpiqesh t’i japësh sadakanë atij që e meriton, është një kusht i rëndësishëm i dhurimit. Pra, ideja nuk është të jepet në mënyrë të pakujdesshme duke neglizhuar interesimin se kujt i jepet zekati. Në ajetin kuranor: **“Ata që bëjnë përpjekje për të dhënë zekatin”** theksohet rëndësia që ka dhënia e zekatit me vetëdijen e adhurimit, gjithnjë duke u përpjekur të gjejmë personin që e meriton atë ndihmë.

Ashtu siç tregohemi të kujdesshëm në rastin kur dëshirojmë të blejmë diçka për vete, të njëjtin interesim duhet të shfaqim edhe në lidhje me kujdesin që amaneti i të Madhit të shkojë tek i zoti, duke treguar përkushtim kohor dhe energji. Dhurimi është tregti shpirtërore nëpërmjet së cilës, duke dhënë një pjesë nga begatitë e kësaj jete të përkohshme, të cilat edhe ato janë dhuruar nga Allahu, të mund të blejmë mirësitë e botës tjetër, që është e përhershme. Përmbushja e kësaj tregtie në mënyrën sa më të

mirë të mundshme lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me kërkimin dhe gjetjen e nevojtarit të vërtetë. Gjithashtu, kjo tregon edhe nivelin e lartë të ihlasit që ka në zemër ai që dëshiron të dhurojë diçka për hir të Allahut.

Në një ajet kuranor thuhet:

***“(Lëmosha) u takon të varfërve, të cilët kanë hyrë në rrugën e Zotit e nuk janë në gjendje të udhëtojnë (për të fituar). Kush nuk i njeh ata, kujton se janë të kamur, për shkak se ata nuk lypin. Do t’i njohësh nga pamja e tyre...”***  
(surja el-Bekare, 2/273)

Kur lëmosha është e sinqerë, tek njeriu lind dhe zhvillohet një aftësi shpirtërore për ta njohur në fytyrë nevojtarin që e meriton shumën që i është lënë amanet për t’ia dhënë atij.

Në një hadith, Hazreti Pejgamberi (a.s.) ka thënë:

*“I varfër i vërtetë është ai, i cili edhe pse nuk zotëron të ardhurat të mjaftueshme për të mbuluar nevojat e tij të domosdoshme, edhe pse nuk e ndihmon askush nga ata që ia dinë hallin, prapëseprapë nuk del të lypë e të kërkojë nga njerëzit e tjerë.”* (Buhari, Zekat, 53)

Duke u frymëzuar nga këto të vërteta, Hazreti Emir Kylali e këshillon kështu nxënësin e tij, Hazreti Bahaudin Nakshibendiun:

*Shiko të lumturosh ndonjë zemër, bëju hyzmeqar i të dobtëve! Mbroji të dobtit dhe ata që e kanë zemrën e thyer! Ata*

*janë njerëz të atillë, që edhe pse nuk kanë asnjë të ardhur nga populli, prapëseprapë e shtynjë jetën me qetësi shpirtërore, me modesti dhe shqetësim. Kërkoji dhe gjeji ata!*

Ja pra, virtyti i vërtetë është të mund të mbash në dorën tënde një nevojtar të tillë. Në ajetin e mësipërm, Allahu urdhëron që t’i gjejmë këta besimtarë të devotshëm të cilët e fshehin nga turpi gjendjen e tyre të keqe ekonomike; gjithashtu, na urdhëron ta kultivojmë zemrën deri në atë masë sa të arrijmë t’i njohim këto njerëz që nga pamja e jashtme. Sigurisht, ky nivel shpirtëror arrihet nepërmjet fitimit hallall të të ardhurave dhe nga sinqeriteti që ke në zemër.

Dhurimi i bërë me gjithë shpirt, duke pasur si qëllim vetëm fitimin e kënaqësisë së Allahut nga pasuria hallall, me ndihmën e Zotit nuk shkon dem por arrin tek nevojtarët e vërtetë.

Ndërsa, kur ndihmohet një person që i është përkushtuar rrugës së Allahut, kjo është më e vlefshme se ndihma që mund t’i bëhet njëqind personave. Me përkushtimin që ka ndaj Allahut, ai nuk do të shpenzojë kot as edhe një qindarkë.

Hazreti Pejgamberi (a.s.) shfaqte interesim të veçantë ndaj “as’habu suffe”, duke i nxitur sahabet e tjerë të kamur që të kontribuonin me mundësitë e tyre ekonomike për plotësimin e nevojave të domosdoshme të “ashab-i suffice”, të cilët i ishin përkushtuar



*“Më shumë, në lidhje me umetin tim, më frikëson shirku. Me fjalën shirk nuk nënkuptoj adhurimin e hënës, të diellit apo adhurimin e idhujve, por kam parasysht çdo vepër që bëhet për çdo qëllim tjetër përveçse për të fituar kënaqësinë e Allahut, dhe egon e fshehtë (dëshira për t’u shfaqur e dukur).”*

tërësisht njohjes së Islamit.

Gjithashtu, sa i takon rëndësisë që ka kujdesi që duhet të tregojmë në lidhje me gjetjen e nevojtarit të vërtetë e për t'i dhënë atë që është e tija, amanet, i cili na është lënë nga Allahu, Hazreti Mevlana shprehet: *“Çfarë është drejtësia? Është të ujisësh pemë frutore. Çfarë është padrejtësia? Është të ujisësh gjembat...”*

Është e rëndësishme të tregojmë kujdes ndaj infakut, që të mund ta dimë nëse do të gjelbërojnë kopshtet tona të shpirtit apo gjembat e egos e të nefsit tonë.

Vlera e dhurimit (infakut) është në raport të drejtë me masën e hallallit të mallit tonë. Me ndihmën e Zotit, mirësitë që bëhen me mallin hallall shkojnë tek ai që e meriton më shumë atë. Nga ky këndvështrim, infaku është skaneri (rontgeni) shpirtëror i fitimeve (të ardhurave) tona.

Njërin nga miqtë e Allahut, Ebu Abbas Nihavendin, e pati pyetur në lidhje me zekatin një prej nxënësve të tij që merrej me tregti. Ebu Abbas Nihavendi i qe përgjigjur:

***“Jepja atij që të thotë zemra!”***

Pasi largohet nga mësuësia e tij, nxënësi takon në rrugë një lypsar të verbër. Meqenëse i vjen keq për të, nxjerr nga xhepi një qese me florinj dhe ia jep si zekat. Lypësi i verbër, pasi e kontrollon mirë qesen dhe bindet se ajo është plot e përplot, largohet gjithë gëzim prej aty. Të nesërmen e asaj dite, nxënësi në fjalë kalon në të njëjtën rrugë dhe sheh se i verbëri i djeshëm, të cilit i kishte dhënë zekatin ishte duke folur me një shok të tij, i cili ishte gjithashtu i verbër. Nga biseda që po bënin dy shokët e verbër, atij i zuri veshi këto fjali:

*“Dje, një njeri fisnik më dhuroi një qese plot me florinj. Dhe unë shkova në mejhane dhe piva për qejfin tim...”*

Kjo gjë e mërzi shumë nxënësin. Ai shkoi menjëherë tek Hazreti Ebu Abbasi. Sapo arriti atje, ende pa filluar t'ia sqarojë mësuësit të vet meselenë, Hazreti Ebu Abbasi kërkoi prej tij që t'i dhuronte personit të parë që do të haste në rrugë një shumë parash, të cilën e kish fituar nga shitja e një qylafi.

Nxënësi largohet menjëherë për të kryer detyrën që i la mësuësi. Ashtu siç qe porositur, shumë e parave ia dhuroi njeriut të parë që takoi në rrugë. Më pas u bë kurioz dhe filloi ta ndjekë atë nga pas. Burri në fjalë hyri

në një rrënojë aty afër. Nxori nga rrobat e tij një thëllënzë të ngordhur dhe e la aty. Teksa ai po largohej prej aty, nxënësi i doli përpara dhe e pyeti:

- O njeri! Më thuaj çfarë po ndodh, pushë hatrin e Zotit! Çfarë është kjo thëllënzë e ngordhur që sapo i hodhe këtu?

Kur shikoi parballë njeriun, që pak më parë i kishte dhuruar shumë e parave, burri tha me zërin që i dridhej nga emocionet:

- Tash shtatë ditë nuk kam mundur të siguroj kurrfarë ushqimi për fëmijët e mi. Unë dhe gruaja po e duronim urinë, por fëmijët nuk ishin në gjendje të duronin më!.. Megjithatë, s'më bëhej të dilja për të lypur. Duke u sjellë andej këndej me gjithë këtë shqetësim, gjeta në rrugë këtë thëllënzë të ngordhur. Në pamundësi për të siguruar ndonjë ushqim tjetër, mendova ta çoja në shtëpi këtë shpend të ngordhur prej ditësh. Ndërkohë, po i lutesha

Allahut me gjithë shpirt: *“O Zoti im, më ndihmo të dal nga kjo gjendje kaq e vështirë!”*. Pastaj, para syve të mi u shfaqte ti. Unë e falënderova Zotin me të gjithë forcën e shpirtit dhe e flaka atë shpend të ngordhur që do të hanim me pahir. Tani do të shkoj në Pazar dhe do t'i blej familjes diçka për të ngrënë me atë shumë parash që më dhurove ti ...

Shumë i çuditur nga kjo situatë, nxënësi vra-poi drejt mësuësit të tij shpirtëror. Kur nxënësi arriti te Hazreti Ebu Ab-

basi, ky i fundit nuk i dha fare kohë të shpjegohej, por i tha:

*“O biri im! Nga e gjithë kjo histori, unë po kuptoj se gjatë punës tënde ti nuk paske treguar kujdes të veçantë ndaj gjërave të dyshimta ose gjërave haram. Kështu që, edhe pse ti u përpoqe të zgjidhje të varfërin, zakati yt shkoi për konsum vere. Gjërat, ashtu siç fitohen, po ashtu edhe largohen nga dora jonë. Urtësia, e cila bëri të mundur që ajo shumë parash të arrinte te i varfëri i vërtetë, qëndron në faktin se ato para ishin krejt hallall...”*

Mundësia e arritjes së sadakasë tek ai që e meriton lidhet direkt me mënyrën se si ajo është fituar. Mund të themi se tek paraja ekziston ligji i tërheqjes së ngjashmërive, *pra paraja hallall terheq njeriun hallall, ndërsa ajo haram tërheq njeriun që është po ashtu haram*. Paraja është si gjarpëri: del nga po ajo vrimë që hyn. Fitimi hallall bëhet shkak për punë të mira dhe të hajrit, ndërsa fitimi haram



humbet në rrugë të mëkatit. Parë nga ky aspekt, qenia e një malli hallall apo haram mund të vërtetohet duke parë se nga shkon kjo pasuri, pra ku dhe si harxhohet.

Pozita shpirtërore e infakut mund të vërehet lehtësisht. Kur ajo çka dhurohet fal kënaqësi dhe qetësi shpirtërore, atëherë mund të dëshmojmë për hallallin e fitimit të asaj pasurie.

Feja jonë nxit dhënien apo dhurimin në çdo situatë. Në qoftë se ky detyrim kryhet me ihlas (sinqeritet), atëherë Allahu bën të mbijnë prej saj mirësi të veçanta. Madje, edhe atëherë kur duket se ajo që dhurohet nuk ka shkuar tek personi i duhur, mundet që në një të ardhme ajo ta zgjojë përfituesin nga gjumi i indiferencës dhe të bëjë që në zemrën e tij të fillojnë të çelin filizat e prirjeve të natyrshme drejt mirësisë.

Në lidhje me këtë të vërtetë, Hazreti Pejgamberi (a.s.), është shprehur:

Dikur një burrë bëri nijet të jepte sadaka dhe në terr të natës ia dha sadakanë një hajduti. Natën e dytë ia dha një prostitute, ndërsa natën e tretën ia dha sadakanë një të pasuri. Me ta marrë vesh këtë, populli e kritikoi me shprehje fyese e denigruese, por personi në fjalë, si rezultat i sinqeritetit të tij, tregoi se gjatë gjumit atë natë u bë dëshmitarë i këtyre shpjegimeve:

***“Sadakaja që i ke dhënë hajdutit ndoshta do ta bëjë atë të turpërohet dhe të heqë dorë nga ky ves i shëmtuar. Mbase prostituta do të bëhet pishman e do t’i kthehet një jete të pastër e të ndershme. Kurse i pasuri mund të marrë mësim, dhe në të ardhmen mund të dhurojë sadaka nga pasuria që i ka dhuruar Allahu atij.”*** (Shih. Buhariu, Zekat, 14; Muslim, Zekat, 78)

Një shembull të ngjashëm me atë të mësipërmin e shohim edhe në jetën e njerit prej miqve të Zotit Sami Efendiut (k.s.).

Në një udhëtim drejt Anadollit, në Yrgyp, një udhëtar kërkon nga Shejh Sami Efendi një shumë lekësh për të blerë duhan.

Edhe pse shumica e atyre me të cilët po udhëtonte Shejhu nuk ishin dakord, duke shprehur kundërshti dhe habi, Sami Efendiua ia dha fakirit shumë e parave të kërkuara, duke thënë: *“Meqë i kërkon paratë, duhet t’ia japim”*. Pasi i mori me gëzim ato para, po në atë çast dhe në mënyrë të pavetëdijshme i varfëri ndërroi nijetin dhe ndërsa po largohej tha: *“Me këtë shumë parash po shkoj të marr pak bukë”*.

Ja pra ndikimet pozitive që mund të bëjë sadakaja tek marrësi, kur dhurohet me sinqeritet e vetëm për hatër të Zotit!

Për këtë arsye, Shejh Saadiu na tërheq vëmendjen:

***“Mirësinë mos e hidh në një qese e mandej t’ia mbyllësh grykën! Mos e kurse mirësinë tënde ndaj asnjërit!”***

***Mos thuaj ky është hipokrit e ky tjetri hileqar! Ata le të jenë si të duan, çfarë po të intereson ty kjo!?”***

## NË QOFTË SE E KE QËLLIMIN E PASTËR ALLAHU E SHTON MIRËSINË

Allahu ia shton bereqetin, një personi që është i sinqertë në nijetin e tij. E shpërblen me shumë sevape për një vepër të mirë që ka bërë, qoftë ajo edhe e vogël. Një dirhem i dhuruar me gjithë shpirt vlen më shumë se një mijë dirhem të dhëna pa shpirt. Nuk është e rëndësishme sasia e shumës së dhuruar, por është e rëndësishme të dihet raporti që ekziston mes pasurisë që zotërojmë dhe shumës së dhuruar, si dhe me sa shpirt dhurohet kjo shumë.

Në një hadith, profeti Muhamed (s.a.v.s.) ka thënë: ***“Nijeti i besimtarit është më me vlerë se vepra e tij.”*** (Sujuti, Xhamiu’s – Sagir, II, 194)

Parë nga ky këndvështrim, një vepër e mirë, sado e vogël që të jetë, rritet kur bëhet me sinqeritet. Dhurimet materiale që kryhen me shpirt, i bëhen kefaret gjynaheve.

I Dërguari i Allahut (s.a.v.s.) na bën të ditur se një grua gjynahqare fitoi xhenetin vetëm duke treguar mëshirë ndaj një qeni të etur, të cilit i dha ujë për të pirë në mes të shkretëtirës. Nga ana tjetër, një grua e përkushtuar në jetën adhurimore dënohet më hyrje në xhehenem vetëm për shkak të keqtrajtimit të maces së saj, pra vetëm për shkak të mungesës së mëshirës ndaj maces së saj. (Shih. Muslim, Selam, 151-153)

Kështu, mund të themi se për t’u përsosur si besimtarë duhet të bëjmë përpjekje serioze e me plot sinqeritet në rrugën e fitimit të kënaqësisë së Allahut, duhet të tregohemi të gatshëm e të etur për të bërë punë të mira, pa shikuar nëse ajo punë është e vogël apo e madhe. Koncepti ynë i dhurimit duhet të shtrihet edhe përtej dhurimeve që u bëjmë njerëzve, pra duhet të përfshijë edhe kafshët, gjë që do të thotë se duhet të përvetësojmë shikimin mëshirues që Krijuesi ka ndaj krijesave.

Një nga shfaqjet shumë të rëndësishme të mirësisë që derdh Allahu i Lartmadhëruar kur sheh se tek njeriu gjendet sinqeriteti në dhurim, është edhe jetëgjatësia e shërbimit të institucioneve që ndërtohen për hir të Allahut. Institucionet që ndërtohen me sinqeritet dhe nëpërmjet pasurisë hallall, e sigurojnë vazhdimësinë e tyre për aq kohë sa të jetë i pranishëm plani shpirtëror.

Historia islame është e mbushur me shembuj që lidhen me këtë temë. Ne po përmendim vetëm njërin prej tyre, atë të kompleksit Sulejmanije që ka furnizuar Stambollin me energji shpirtërore për vite me radhë. Kanuni Sulltan Sulejmani, i cili e ndërtoi këtë kompleks, ishte një njeri që i frikësohej hakut të njerëzve, e që gjithashtu ishte një halife që përpiqej të ishte i drejtë. Kur përfundoi së ndërtuari kompleksi, gurin e themelit të së cilit e vendosi Shejhulislam Ebussuud Efendi, Kanuni i mblodhi të gjithë,

që nga arkitektët e deri tek punëtorët e thjeshtë, të cilët kishin kontribuar në ndërtimin e kësaj veprë madhështore. Pasi falënderoi Allahun, ai u tha:

*“O vëllezërit e mi të fesë, ndërtimi i kësaj xhamije me ndihmën e Zotit përfundoi. Në qoftë se gabimisht ose për shkak të harresës dikush nga ju nuk është paguar (pra nuk ka marrë pagën ose shpërblimin) ose i është ngrënë haku, le të vijë këtu e ta marrë tani atë çfarë i takon. Mundet që ndonjëri të mos jetë i pranishëm tani. I lutem atyre që ndodhen këtu, që t’ua përcjellin këto fjalë atyre që mungojnë.”*

Madje edhe për kafshët që do të përdoreshin aty për të punuar, kishte një program të veçantë. Kishte orare të veçanta pushimi dhe ushqyerjeje për kuajt, gomerët dhe mushkat. Siç shihet, është treguar një kujdes i veçantë edhe ndaj të drejtave të kafshëve. Mbase kujdesi i treguar ndaj të drejtave të njeriut dhe të kafshëve gjatë ndërtimit të kësaj faltoreje mund të jetë një nga arsyet themelore të rrezatimit shpirtëror të kësaj faltoreje.

Ndërtimin e kësaj faltoreje madhështore e ka realizuar gjeniu dhe njeriu me personalitet të lartë, arkitekt Sinani. Madje gjatë ndërtimit të faltores, ky njeri me grada të larta shpirtërore ka bërë kujdes që edhe gurët të mos të preken pa abdest. Fjalët që qarkullojnë në popull janë tërësisht të vërteta:

*“Pronari i Sulejmanijes është Sulltan Sulejmani, ndërsa imani dhe besimi i saj është arkitekt Sinani...”*

Në ceremoninë e inagurimit të xhamisë në fjalë, në shenjë mirënjohjeje Kanuni tha:

- Këtë faltore të shenjtë le ta hapë Sinani! Ai ka punuar më shumë!

Ndërsa Sinani i tha përzemërsisht Padishahut:

- Mbreti im! Hattati<sup>1</sup> Karahisari humbi dritën e syve duke bërë shkrimet e kësaj xhamije. Le t’ia dhurojmë atij këtë nder.

E kështu, pas gjithë këtyre sjelljeve të virtutshme, kjo faltore e shenjtë u hap nga hattati Karahisar.

Në arkitekturën e xhamisë Sulejmanije ndihet kudo atmosfera shpirtërore e adhurimit. Kjo e emocionon besimtarin dhe e shpie në një gjendje të thellë shpirtërore. Në atë xhami ka fituar kuptim jo vetëm guri, por edhe dheu. Kjo faltore është

1. Piktori që bën shkrimet e brendshme të xhamisë.

pasqyrimi i islamit në materie, në mënyrën më të shenjtë. Kjo faltore është si një njeri që hesht, por që me heshtjen e tij flet shumë.

Atmosfera shpirtërore e brendësisë së xhamisë ndikon shumë në shpirtin e njeriut. Kjo është diçka që vihet re shumë qartë. Madje edhe turistët që i përkasin feve të tjera, pohojnë se u qetësohet shpirti e zemra nga atmosfera shpirtërore që përmban kjo faltore monumentale.

Ja pra, kjo është mirësia e dhurimit me sinqeritet. Që prej pesë shekujsh, kjo vepër madhështore vazhdon të qëndrojë krenare në këmbë edhe pas disa termeteve të rëna kohët e fundit. Ajo e mbron popullin me bukurinë e artit islam, por gjithashtu zbulon qiejt me zërin e ezaneve. Sigurisht, jetëgjatësia e kësaj faltoreje është një mirësi, që Allahu ia dhuroi sinqeritetit...

### ATË ÇFARË JEP DORA E DJATHTË TË MOS E DIJË DORA E MAJTË



*“T’i jepni lëmoshat haptazi  
është gjë e mirë, por t’ua jepni ato  
të varfërve fshehurazi,  
është edhe më mirë dhe ju shlyen  
disa nga gjynahet tuaja.  
Allahu e njuh mirë çdo vepër që ju bëni.”*

(Bekare, 271)



Veprat e mira që bëhen nga shpirtërat e mbetur pa sinqeritet, pra që bëhen të nxitura nga hipokrizia dhe dëshira për tu dukur, nuk kanë asnjë vlerë. Në këtë pikë, rreziku më i madh qëndron në faktin se personi që bën një dhurim, mund ta bëjë këtë për ndonjë përfitim vetjak apo për ndonjë interes material që lidhet me këtë botë. Një ndër rrugët më të efektshme për të shpëtuar nga kjo sëmundje e zemrës, e cila asgjëson sevapet dhe shkatërron sinqeritetin, është aplikimi i dhurimit në fshehtësi.

Në një ajet kuranor thuhet:

*“T’i jepni lëmoshat haptazi është gjë e mirë, por t’ua jepni ato të varfërve fshehurazi, është edhe më mirë dhe ju shlyen disa nga gjynahet tuaja. Allahu e njuh mirë çdo vepër që ju bëni.”* (surja el – Bekare, 271)

Pra, atij që dhuron diçka në mënyrë të fshehtë, Allahu ia mbulon të metat dhe gabimet. Një dhurim i tillë, ashtu siç i bëhet keqet gjynaheve, i bëhet pengesë prirjes së mendjemadhësisë apo nevojës që ka njeriu për tu dukur, duke mos lejuar shkatërrimin e sevapeve.

Në një hadith thuhet:

*“Allahu i Lartmadhëruar ia shkruan të fshehtë shpërblimin një robi që e kryen atë në mënyrë të fshehtë. Në qoftëse ky njeri e bën në mënyrë të hapur këtë vepër, atëherë Allahu i Lartmadhëruar e regjistron atë tek veprat publike. Në qoftëse veprën që ai ka bërë e tregon, atëherë Allahu ia shkruan atë në fletoren e hipokrizisë.”* (Ihja, I 595)

Sipas ajetit të mësipërm, ata që e fshehin infakun e tyre, do të jenë të lumtur në botën tjetër nën hijen e arshit, në tmerrin e Ditës së gjykimit. (Shih. El- Bekare 271; Buhari, Ezan, 36)

Por, ngadonjëherë, është mirë që infaku të bëhet në mënyrë të hapur. Kështu, nxiten edhe të tjerët për të dhuruar. Në lidhje me ajetin: **“T’i jepni lëmoshat haptazi, është gjë e mirë, por t’ua jepni ato të varfërve fshehurazi, është edhe më mirë dhe ju shlyen disa nga gjynahet tuaja. Allahu e njuh mirë çdo vepër që ju bëni.”** (surja el – Bekare, 271), mufesirët kanë thënë se zekati duhet dhënë haptazi, në mënyrë që të nxiten edhe të tjerët në dhënien e tij, ndërsa sadakaja dhe mirësitë e tjera të ngjashme me të duhen bërë fshehtas.

Si përfundim, mund të themi se punët e mira duhen bërë fshehtazi apo haptazi në varësi të kushteve dhe situatave. Nëse ruhet pastërtia e njetit të zemrës, nuk ka asnjë të keqe që dhurimi material të bëhet publikisht, sepse kjo do të nxisë edhe njerëzit e tjerë të bëjnë të mira, madje, në raste të veçanta duhet të jepet haptazi. Në të dy rastet e dhurimit të infakut, në dhënien e diçkaje fshehurazi apo haptazi, thelbësore mbetet ruajtja e zemrës nga hipokrizia dhe nga dëshira për t’u dukur, pra ruajtja e devotshmërisë dhe e sinqeritetit.

Te disa njerëz, dhënia e sadakasë haptazi mund të sjellë zhvillimin e paturpësisë; mospasja turp, tek disa njerëz mund të sjellë për pasojë pritshmëri të larta nga ti, por kjo nuk duhet të bëhet shkak të humbasë përpjekja dhe puna e bërë për t’iu gjendur afër njerëzve në nevojë nëpërmjet infakut. Dhënia publikisht e infakut mund të sjellë zhvillimin e krenarisë, të mendjemadhësisë dhe të vetëkënaqësisë tek personi që e jep. Gjithashtu, mund të lëndohet edhe individi, të cilit i jepet infaku. Në raste të tilla, si këto që përmendëm më sipër, është më e preferuar të dhurosh diçka në mënyrë të fshehtë, jo publike.

Hazreti Omeri (r.a.), gjatë netëve merrte mbi shpinë thasë me miell dhe endej lagjeve të varfra, pa u parë prej askujt, që të gëzonte zemrat e fukarenjve.

Nipi i Hz. Aliut, Hz. Imam Zejnelabidini mbante netëve mbi shpinë thasë me ushqime, të cilat i linte fshehurazi në dyert e shtëpive të nevojtarëve të Medinës.

Një mënges ata vërejtën që nuk kishin më thasë me ushqime pas dyerve të tyre. Atë ditë u hap lajmi që Hz.

Imam Zejnelabidini, nipi i Hz. Aliut kishte ndërruar jetë. Trishtimi i asaj dite u përjetua nga të gjithë.

Kur po lanin trupin e pajetë të Hz. Imam Zejnelabidinit, vërejtën që në shpinën e tij kishte disa plagë. Pasi u pyetën të afërmit për arsyen e kësaj, u kuptua që plagët ishin shkaktuar nga pesha e rëndë e thasëve të ushqimeve që ai u shpërndante të varfërve.<sup>2</sup>

Ja pra, këto janë rrezatimet e sinqeritetit të një zemre besimtare të mbushur me mëshirë, e gjithashtu ky është kujdesi që shfaq ky lloj besimtari i sinqertë ndaj **apencialitetit** dhe ndaj përkëdheljeve të krenarisë nga të tjerët.

Të parët tanë kanë qenë shumë të kujdesshëm në këtë pikë. Ata janë modele shembullore për t’u ndjekur. Fatih Sulltan Mehmet Han, në një nga pikat e rregullores së një shoqate bamirësie shprehet kështu:

**“Unë, ngadhënjyesi i Stambollit, një rob nevojtari i Zotit, Fatih Sulltan Mehmeti, 136 dyqanet e mija të fituara me djersën e ballit ia dhuroj këtij vakëfi, sipas kushteve**

**të mëposhtme: Në vendin e gatimit që unë kam ndërtuar në kompleksin tim, të gatuhet ushqim për gratë e shehitëve, për jetimët dhe të varfërit e Stambollit! Të sëmurëve që nuk mund të vinë e të marrin ushqimin apo të ushqehen këtu, t’u dërgohet ushqimi në enë të mbyllura, në të errur të ditës, në mënyrë që të mos shihet nga askush.”**

Siç e shohim, në rregulloren e kësaj shoqate bamirësie, Fatih Sulltan

Mehmet Hani ka vendosur rregulla në mbrojtje të individëve nevojtari dhe të dobët të shoqërisë.

Të parët tanë e kishin traditë që ta fusnin zekatin në zarf dhe ta vendosnin nën disa gurë të posaçëm që gjendeshin në xhamitë e vendit; kështu, ai që e jepte zekatin nuk e shihte atë që e merrte dhe e anasjellta. Në këtë mënyrë, personi që merrte zekatin nuk vihej në siklet, por njëkohësisht as tek dhënësi nuk mund të lindte ndjenja e epërsisë dhe mendjemadhësisë.

**Allahu e bëftë bashkësinë tonë prej asaj bashkësie që bën çmos në ruajtjen e sinqeritetit, dhe na bëftë prej vepërmirëve që i kryejnë veprat me sinqeritet! Allahu përcjelltë tek ne copëza nga gjendjet e bukura shpirtërore të evlijave dhe të të parëve tanë!**

**Amin!**

2. Shih. Ibn-I Kesir, el-Bidaye, IX, 112, 122; Ebu Nuajm, Hilje, III, 136.

# Mbi pasqyrimin e transcendencës hyjnore në artet pamore

Edison Çeraj

Nëse do e përmblihdhim me dy fjalë thelbin e trajtesës së mëposhtme, mund të themi se arti evropian (Greqia e Lashtë, Rilindja dhe të gjitha periudhat pas saj) synon/kërkon të Vërtetën, ndërsa ai lindor (arti islam në veçanti) e manifeston atë; thënë ndryshe është një lloj zgjatimi konkret, – domethënë pamor – i saj, për aq sa kjo e fundit i ka dhënë tagër.

Pikërisht për këtë arsye, arti perëndimor është aq i ndryshëm nga lindori; sepse kanë qëllime të ndryshme; sepse i qasen krejt ndryshe njeriut dhe jetës.

Letërsia greko-romake ka njohur parimin e hyjnizimit përmes idealizmit. Në këtë proces, konkretja (një qenie njerëzore ose një objekt në natyrë) ndahej prej shembullit apo konkretizimit të vet individual, me qëllimin për të përforcuar cilësitë e saj. Kur këto cilësi kishin arritur shkallën më të fundit të mundshme, objekti paraqitej si ai që natyra duhej ta prodhonte dhe dëshironte ta prodhonte, por që nuk ia kishte dalë ta bënte përmes ngurrimit dhe njëmijë e një përpjekjeve të saj. Në këto përpjekje ajo mund të kishte pasur vetëm sukses të pjesshëm. Arti është më i aftë se natyra; në të artisti mund të prodhojë, por kurdoherë dështonte ta bënte këtë. Vepra e artit, për këtë arsye, nuk është një imitim i natyrës, siç mendonte Platoni; e as që është ky një përgjithësim empirik prej asaj që është e dhënë në natyrë. Është *a priori*, e kështu, transcendente apo hyjnore, duke qenë se është produkt i një procesi idealizimi të zbatuar deri në shkallën më të plotë e përfundimtare.<sup>1</sup>

Perënditë e Greqisë së lashtë nuk ishin realitete transcendente, as krejtësisht e ontologjikisht tjetër gjë, përveçse natyrë. Ata ishin prodhim i të njëjtit proces idealizimi, të zbatuar prej gjenisë njerëzore. Ata ishin njerëzorë, që të gjithë tepër njerëzorë; qejflinj, ngurrues, urrejtës, dashurues, komplotistë e kundër-komplotistë kundër njëritjetrit; përfaqësues të çdo aspekti të personalitetit njerëzor, të çdo force të natyrës, prej së cilës ata ishin idealizimi përfundimtar.<sup>2</sup>

Këto perëndi bashkëpunonin me heronjtë apo me njerëzit që kishin një pozitë të caktuar në shoqëri, për

1. Faruki, I. (2006) "Transcendencë hyjnore dhe shprehja e saj", f. 60. Përkth.: Edvin Cami. Tiranë: Erasmus.

2. Po aty, f. 60-61.

të arritur kështu një qëllim i cili ishte projektim i dëshirës njerëzore për të zotëruar diçka, për të ngadhënjyer apo për të mbërritur te një ideal që përthyej te tokësorja si tepër tokësor. Kështu, njerëzorët i zotëronin perënditë, pavarësisht të papriturave që këta të fundit u caktonin, pasi edhe këto të papritura për njerëzorët rrëfeheshin nga poetët si domosdoshmëri e vendosjes së një dallimi apo kufiri të "pamundur" ndërmjet së epërme dhe së poshtme.

Kur skulptori i paraqiste ata në mermer apo poeti në vetëzbulimin e tij dramatik, çdo njeri që kuptonte gjuhën belbëzuese të natyrës, do të thërriste: "Po, pikërisht kjo është ajo që natyra ka dashur të thotë!" Ky është natyralizëm dhe lashtësia klasike ishte shembulli më i mirë i tij. Ndaj dhe është mashtruese e çorientuese të flasësh për transcendencë në lashtësinë greko-romake. Do të ishte më mirë të flitej për imanencë. Imanenca kërkon natyroren, korrekte dhe empirike, për arsye se ajo është një përmasë e kësaj. Ajo nuk e shmang konkretin, për arsyen se është një idealizim i natyrores, dhe pa natyroren ajo nuk mund të arrihet. Kjo është edhe arsyeja se pse arti i Greqisë dhe i Romës është figurativ; dhe interpretimi i figurave të caktuara në art, apo portretizimi, është në nivelin më të lartë.<sup>3</sup>

Evropa e rigjeti trashëgiminë e saj të lashtësisë dhe u rivu në zotërim të saj pas një mijëvjeçari, në kohën e Rilindjes. Gjatë atyre njëmijë vjetëve, Krishtërimi u përpoq nën një estetikë të trazuar dhe të errët, e cila gërshetonte elementet e trashëgimisë greke me disa elemente të asaj semite. Rrjedhimi që Bizanti, arti i të cilit nuk u ngrit kurrë përtej ilustrimit. Pika më e fortë e artit bizantin, pra, ikona, ishte jonatyraliste në formë (e kështu, pra, semite, në ndjekje të trashëgimisë çifute) dhe natyraliste në përmbajtje, për arsye të ideve diskursive që ajo shprehte në figura apo drejtpërdrejt në titujt që u caktoheshin figurave prej artistit. Elementi semit u shkund tej prej artistëve të Rilindjes, që prodhuan imazhe të Jezuit, të Marisë, të Atit e të shenjtorëve, në përputhje me kuptimet e krishtera që u njiheshin atyre, drejtpërdrejt përmes vetë figurave, në stilin e Greqisë së lashtë.

3. Po aty, f. 61.



Megjithëse autoritetet e Krishtërit, në fillim, e dënuan natyralizmin si kthim në paganizëm/idhujtari, ata u pajtuan me të, më në fund, për arsye të lidhjes së hyjnisë me natyrën, implicite në mishërim. Që nga ajo kohë, arti i Krishtërit ka qenë kryesisht figurativ dhe idealizues. Duket se kjo u pa si e kënaqshme, pasi transcendenca në mendjen e të krishterit nuk shtronte kurrë kërkesa që arti figurativ të mund të mos i përmbushte. Pra, krejt ndryshe nga mendja e myslimanit, që pranonte transcendençën absolute të Hyjnisë, siç lexojmë në Kuran: "Asgjë nuk i shëmbëllen Atij. Ai i dëgjon të gjitha dhe i sheh të gjitha." (42/11)

Siç e vëmë re, ndryshe nga i krishteri, myslimani pranon transcendençën e plotë dhe absolute të Hyjnisë. Pra, kjo nuk mund të pajtohej në asnjë mënyrë me imanencën e zbutur që toleronte shprehjen e hyjnisë në figura, pasi Zoti nuk ishte "tjetër" veç së natyrshmes, përveç idealizimit të Tij përfundimtar. Realiteti përfundimtar, për të cilin merakoset myslimani, prej të cilit mundohet, vullnetin e të cilit ai është gjithmonë në kërkim për ta gjetur, urdhrin të të cilit ai mundohet kurdoherë që t'i bindet dhe përmendjen e të cilit e ka kurdoherë në buzë nga mëngjesi gjer në mbrëmje, në thujtje çdo fjali, është një realitet transcendent, thelbi dhe përkufizimi i të cilit është se ai është krejt tjetër nga i gjithë krijimi, qoftë kjo pjesa e dukshme dhe e zbuluar e krijimit, qoftë pjesa e padukshme apo e pazbuluar e tij. Duke qenë se ky realitet qëndron në anën tjetër të krijimit, ai është "krejtësisht tjetër" dhe i papasqyrueshëm prej asgjëje në krijim. Por ndryshe nga çfarë kanë bërë çifutët, që, pikërisht për këtë arsye kanë hequr dorë krejtësisht nga përpjekja për estetikë, duke mëtuar se transcendenca hyjnore nuk lejon hapësirë për arte pamore, artisti mysliman i pranonte artet pamore dhe u njihje atyre si detyrë të parë të shpallurit se natyra nuk është një mjet artistik.<sup>4</sup>

Si stilizimi, ashtu edhe idealizimi e tjetërsojnë të natyrshmen dhe konkretin. Po, nëse idealizimi tjetërson aq sa për ta bërë më të natyrshëm, më përfaqësues të gjinisë së vet, stilizimi e tjetërson aq sa ta mohojë konkretin bashkë me gjininë e vet. Stilizimi e shndërron natyrën në një mënyrë të tillë, sa të mohojë natyrshmërinë e saj. Vetëm figura e stilizuar sugjeron atë që i përket figura. Figura është zbratur nga përmbajtja e saj dhe mbetet një guaskë, përdorimi i së cilës është për të shprehur mohimin. E njëjta gjë është e vërtetë për figurat njerëzore dhe të kafshëve, për hardhinë, gjethen dhe lulen në artet e Islamit. Stilizimi i tyre është mënyra e artistit mysliman për t'i thënë jo natyrës, shembullit të saj konkret dhe formës së saj ideale. Ideja se asgjë në natyrë nuk përbën një mjet të përshtatshëm për shprehje artistike, që është qëllimi i dukshëm i të gjithë artit pamor islam, është i barasvler-

4. Po aty, f. 63.

shëm me pjesën e parë të dëshmisë së besimit, në të cilën pohohet se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Zotit. Ashtu sikurse teologjia islame, që na ka treguar se asgjë, absolutisht asgjë në natyrë nuk është Zot, apo hyjnore në ndonjë mënyrë (i gjithë krijimi është krijimi dhe, si i tillë është profan), ashtu edhe artisti mysliman, në shprehjen e tij estetike, na tregon se asgjë në natyrë nuk mund të përbëjë një shprehje të Hyjnisë.<sup>5</sup>

Sa më shumë që artisti mysliman është përsosur në stilizim, aq më shumë ka feksur në të mendimi se transcendenca e Zotit kërkonte më shumë sesa stilizim, nëse ajo duhej të shprehej me sukses në estetikë. Kështu, ai zbuloi se tërësia e natyrës mund të mohohet *en bloc*, nëse ai e braktiste stilizimin e objekteve natyrore dhe u rikthehej figurave gjeometrike. Këto janë krejt e kundërta e natyrës për mënyrën si ajo kuptohet prej nesh. Në të vërtetë, ato qëndrojnë në një përfundim logjik të procesit të stilizimit, ku stilizimi i vreshtit, i kërcellit, i gjethes dhe i lules arrin qëllimin e tij përfundimtar. Të ngresh figurën gjeometrike në mjet të vetëm të arteve pamore, është një vendim krejtësisht në përputhje me dëshminë *La ilahe il-la Allah*. Në tërësinë e krijimit nuk ka asgjë që të jetë Allah apo që

të jetë pjesë e Allahut apo që, në çfarëdo mënyre, të jetë e shoqëruar me Allahun.

Edhe *Katrori i zi* i Malevich-it mund të shihet si demonstrim *par excellence* i mohimit (jo refuzimit) të natyrës dhe sendores konkrete të saj si mundësi e pamundur.

Si qenie transcendente, Allahu nuk i nënshtrohet kurrë ndijimit dhe, në këtë mënyrë, nuk mund të bëhet kurrë objekt i një intuited ndjesore.

Për artistin, puna e të cilit është që të paraqesë një intuitë ndjesore

të subjektit, Zoti është një rast absolutisht i pamundur. Ndërgjegjja myslimane drithërohet ndaj çdo mendimi për paraqitjen ndjesore të Zotit. Pikërisht në këtë pamundësi dëshpëruese të artistit mysliman erdhi edhe zbulimi i madh. Duke pranuar se transcendenca e largonte Allahun përtej çdo përfaqësimi apo shprehjeje estetike, a është e njëjta dukuri e vërtetë edhe për papërfaqësueshmërinë apo pashprehshmërinë e Tij estetike? Përgjigjja është mohore. Zoti është vërtetë i pashprehshëm, por nuk është e tillë pashprehshmëria e Tij. Kjo pashprehshmëri u kthye në objekt të shprehjes estetike, si dhe në objekt të pavetëdijshëm të artistit mysliman. Stilizimi dhe baza e tij, figura gjeometrike, përbënin mjetin, të shprehurit e pashprehshmërisë së Zotit përbën qëllimin. Gjenisë artistike të myslimanit i mbetej të krijonte skicën që, pasi të zbatohet ndaj mjetit, të mbërrinte qëllimin e saj.

Kjo u përmbush përpara fundit të shekullit të parë islam, kur zejtarët ishin ende në pjesën më të madhe të krishterë që kishin lënë Krishtërimin, por ende të përkushtuar ndaj formave artistike të Bizantit. Në pallatet e emevinjve të

5. Po aty, f. 63-64.

Jordanisë, në Kubenë e Shkëmbit në Jerusalem, si dhe në Xhaminë Emevije të Damaskut, të cilat datojnë nga gjysma e dytë e shekullit të parë hixhri, ka tregues të shumtë që tregojnë se zejtarët ishin bizantinë në zejtarinë e tyre, por islamë në një pjesë të punës së tyre. Gjithashtu, ata, ose *maître de travail*-i i tyre, duhet të jetë nxitur prej vlerësimeve fetaro-estetike, të ndryshme nga ato që nxitën Bizantin.

Arti krahinor bizantin dhe romak e kishte njohur si stilizimin, ashtu edhe figurën gjeometrike, por kompozimit të tyre u mungonte vrulli (*momentum*). Ai ishte statik. Artisti mysliman zhvilloi një kompozim, në të cilin vëzhguesi ndihej i detyruar të zhvendosej nga një lule, kërcell a figurë në një tjetër, për arsye se pasuesja ishte në proces të formimit (domethënë, të të qenit e vërejtur) pikërisht në çastin kur segmentet e të pasuarës po shtyheshin në vetëdije. E thënë ndryshe, kompozimi ishte i tillë, që ishte e pamundur të perceptoje plotësisht figurën e parë pa përfshirë një pjesë të figurës së dytë, të krijoje një konceptim të plotë të së dytës, pa përfshirë një të tretë e kështu me radhë. Kjo krijonte vegimin e një *élan*-i apo të një vrulli (ecuri e qëllimshme) për të shkuar përherë e më tutje prej pikës në të cilën binte fillimisht shikimi. Përsëritja dhe simetria atëherë u zbuluan për të përforcuar këtë vrull duke i mundësuar atij që të shpërndahej në të gjitha drejtimet. Figura fraksionale, që bëhej e nevojshme prej sasisë së pamjaftueshme të hapësirës materiale, siguronte një shtytje për imagjinatën, që të rikrijonte fraksionet që mungonin përtej *objet d'art*-it material.<sup>6</sup>

Ndërthurja e stilizimit, e moszhvillimit, e joorganikes, e fraksioneve që nxisin imagjinatën të prodhojë plotësuesit, simetrinë dhe çastin e tyre që gjeneron përsëritje – të gjitha e shtrëngonin përfytyrimin e shikuesit të vëmendshëm që të riprodhojë gjithnjë e më shumë pamje në të njëjtin ritëm *ad infinitum*. Natyra jozhvilluese, joorganike e pamjeve, diktonte që prodhimi apo vazhdimi i skicës<sup>7</sup> në imagjinatë të ishte i pafund, pasi nuk ka asnjë pikë në të cilën ajo, logjikisht, të mund të përfundonte.<sup>8</sup>

Kështu, *objet d'art*-i bëhej një fushë e pamjes, e prerë në mënyrë arbitrare prej kufijve të saj materialë nga një fushë e pafund; dhe, sikurse fusha e pamjes së një mikroskopi, dhuronte një perceptim të shtrirjes së pafund përtej saj.

Shtrirja e përtejshme dhe vazhdimi i modelit në të janë një ide e arsyes që ushtron trysni mbi përfytyrimin për ta prodhuar atë për vetëdijen. Sigurisht, nën efektin e të dhënës në fushëpamje dhe të vrullit që ajo ka gjeneruar, përfytyrimi e përmbush me aftësi urdhrin dhe fillon prodhimin. Nëse ai përfytyrim është i fuqishëm, do të mbahet për një kohë të konsiderueshme dhe në hapësirë të konsiderueshme, por, për nga natyra, ai nuk mund ta

përmbushë atë që pritet prej tij, që do të thotë, vijimësinë e pafund. Ndaj edhe, herët a vonë, atij do t'i duhet të kuptojë se detyra e tij është e pamundur, se përpjekja e tij është e pashpresë, sepse e pafundmja është diçka që nuk mund të bëhet kurrë objekti i një intuente ndjesore, qoftë kjo edhe në përfytyrim. Në këto kushte, përpjekja e përfytyrimit rrëzohet dhe vetëdija fiton përmes rrëzimit një intuitë të shkakut të rrëzimit, të pamundësisë për të përmbushur synimin e përpjekjes. Një intuitë e tillë është intueta e pafundësisë dhe pafundësia është përbërësi thelbësor i transcendencës.

*Objet d'art*-i në Islam është estetikisht, domethënë, nga pikëpamja e bukurisë, kompozimi që ai mbart. Kompozimi është quajtur "arabeskë" (*arabesque*). Është skicimi, si dhe parimet estetike, mbi të cilat vetë kompozimi është ndërtuar. Arabeska nuk është vetëm një zbulim në një sipërfaqe të rrafshët, por parimi i mishëruar në një sipërfaqe të islamizuar, në ballinën e ndërtesës islame, në dyshemenë e saj, në kompozimin dhe në ngjyrën e qilimit, në faqen e stolitur të dorëshkrimit, në përshtatjen ritmike dhe tonike të një pjesë të muzikës islame, në përshtatjen e lulëzimit dhe/ose të pemëve plot lule në kopsht, të kro-

jeve të akuakulturës që lindin e rrjedhin. Arabeska është quajtur "dekorim" prej historianëve të artit lindor. Si e tillë, ajo është parë si një flakërim hedonik i ngjyrës, një përsëritje monotone, një kompozim i zbrazët për të mbushur sipërfaqet, apo, së fundi, si një teknikë kompensuese për të kapërcyer frikën e ndërjegjshme të zbrazëtisë së shkretëtë. Kur këta "dijetarë" shtojnë edhe anën teologjike, argumentojnë se gjenia myslimane u dha e tëra pas stolisjes

me arabeska, për arsye se Islami e ndalonte riprodhimin e figurave. Ata nuk kanë as kohë e as energji për të pyetur se pse Islami e ndaloi paraqitjen e figuratives. Në të vërtetë, arabeska nuk është aspak dekorim. Ajo nuk është sipërfaqësore ndaj *objet d'art*-it, por është thelbi dhe bërthama e tij.

Në të vërtetë, të mbulosh çfarëdo objekti me arabeskë, do të thotë ta transsubstancializosh atë aq shumë, sa që arti i arabeskës, i të ashtuquajturit "dekorim", është, në fakt, arti i transsubstancializimit. Në ndikimin e arabeskës, *objet d'art*-i humb materialitetin/sendoren, konkretësinë, pa-tejdukshmërinë, individualitetin e tij, kufijtë e vetë qenies dhe të real-ekzistencës së tij, edhe nëse do të kishim të bënim me ndërtesën më të rëndë, më të madhe dhe më të ngurtë. Ajo bëhet një erë-dritë, e tejdukshme, perde fluturuese e kompozimit dhe e ritmit, që shërben si një pistë mbi të cilën përfytyrimi ngrihet dhe nis fluturimin e vet – një fluturim, i cili përfundon në katastrofë për përfytyrimin, por në ndjesinë më të madhe e më të thellë të transcendentës së mundshme për njeriun.

Këtu qëndron edhe *mundësia* e qenësishme që na jep arti.



6. Po aty, f. 65-66.

7. Ose i modelit *sui generis*.

8. Po aty, 66.

# Ashku hyjnor, qëllimi sublim

Xhafer Bekirollu

**S**htrenjtë! Duhet ta dish se miqtë e Allahut kanë thënë: "Ashku është pika e fundit e dashurisë. Udhëzimi dhe përkujdesja e Zotit për miqtë e Tij. Ashku dritë përmbi dritë, në zemër dhe në shpirt. Ashku hyjnor nuk di kurrë të zërë karar dhe të qetësohet. Prandaj edhe zjarrri i ashkut e djeg përherë nga brenda ashikut. Ashiku e ka braktisur të menduarit gjerë e gjatë rreth arsyeve materiale dhe lojës me fjalë".

Enigmat shkojnë drejt zemrës së ashikut, sepse tek ai janë pleksur me njëra-tjetrën fjala dhe vrojtimi. Burimi i ashikut nuk ka të ngjashëm, sepse ai është burimi i njësimi dhe udhës së Zotit. Ashiku e konsideron veten të nënçmuar dhe të pavlerë, sepse vetëm kështu arrin ta madhërojë dhe ta respektojë "Atë" për të cilin ka rënë në ashk. Hallet dhe qederet i duken ëmbëlsira ashikut. Për njeriun që arsyeton sipas kësaj bote, ato janë fatkeqësi.

Nëse në një shpirt shkëlqejnë si vetëtima rrezatimet e të Dashurit, dije mirë se aty ka lindur dielli i dashurisë. Dashuria nuk është forma e jashtme, por kuptimi i shpirtit, sepse në çastin e vdekjes duket qartë se si shpirti nuk e dashuron trupin e pajetë. Në këtë mënyrë, ashiku i formës është i mashtruar dhe fatkeq. Ashiku i shpirtërores është i lumtur, sepse ashku i tij është i vërtetë.

Në qoftë se në zemrën tënde dashuria për Zotin është dyfishuar, dije se edhe Ai të do ty. A mund të lëshojë tinguj një dorë e vetme, pa u përplasur me një tjetër?!

I eturi qan se ku mund ta gjejë ujin që do t'i shuajë etjen, ndërsa uji gurgullon duke thirrur për të eturin. Etja e shpirtit është një tërheqje e pashembullt. Ne ekzistojmë për hir të Tij...

Fundi i ashkut është qëndrimi i përhershëm me të dashurin. Por fillimi i përherësisë, për ashikut është shumë i rëndë, sepse ai kalon nga vetja tërësisht. Ashku është aq i virtytshëm, saqë njeriut i zhvlerëson ekzistencën e tij.

Mosnjohja e dëshirave të errëta të nefsit dhe e madhështisë së ashkut, e ka bërë njeriun shumë injorant dhe zullumqar. Lepuri i doli para luanit, kur shkoi pas nefsit të tij. U hodh në krahët e tij me dëshirën e vet, për shkak të injorancës. Megjithëse është kaq injorant dhe zullumqar, në këtë botë njeriu ka nënshkruar vepra shumë të drejta dhe ka grumbulluar njohuri të shumta. Ai e ngarkoi veten shumë rëndë kur pranoi të merrte përsipër amanetin që edhe toka edhe malet ngurruan ta marrin...



# Ekilibri ndërmjet fesë dhe botës

Doç. dr. Sulejman Derin

Parimet kryesore të besimeve dhe ideologjive përcaktohen nga këndvështrimet e tyre ndaj kësaj bote dhe besimit në ahiret. E rëndësishme për mendimet filozofike si komunizmi, është bota në të cilën jetojmë dhe ndarja e saj me të tjerët. Sipas kësaj filozofie, bota është e vërteta e vetme, kështu që besimi në ahiret nuk ka kuptim.

Ndërsa kapitalizmi, megjithëse i bën idhuj pasionet e njerëzve, nuk e refuzon tërësisht besimin në ahiret. Madje, kur i leverdis, e përdor lehtë edhe fenë për interes. Në të njëjtën mënyrë edhe ithtarët e feve hyjnore kanë nxjerrë teza të ndryshme me njëra-tjetrën, në lidhje me këtë botë dhe botën tjetër.

Sipas ithtarëve të feve të tjera, çifutët e kanë tepruar në përfitimin nga mirësitë e kësaj bote. Kur po përparonin në rrugën e shpëtimit hyjnor që ua tregoi Musai, alejhisselam, ata nuk mundën të sakrifikonin qoftë edhe kënaqësitë shumë të vogla të kësaj bote, si qepët dhe hudhrat.

Nga ana tjetër, kristianët shpikën murgërinë, hoqën dorë totalisht nga kjo botë dhe e konsideruan mëkat nevojën njerëzore më themelore.

Islami, si shpallja e fundit që i ka ardhur njerëzisë, qëndron larg këtyre dy ekstremeve. Islami ka vendosur ekilibrin ndërmjet fesë dhe botës. Këtë botë e pranon si arë të ahiretit dhe sugjeron që të përdoret në rrugë të Allahut (xh.xh.). Sipas Islamit, fusha më e rëndësishme në të cilën sprovohet myslimani, është lidhja e tij me këtë botë. Kur bota të përdoret për fenë dhe të jetë një mjet për ahiretin, atëherë është arritur qëllimi.

Por për fat të keq, mashtrimi dhe joshja e kësaj bote i ka devijuar shpeshherë njerëzit nga rruga e drejtë. Për këtë arsye, të mëdhenjtë e misticizmit i kanë paralajmëruar njerëzit e thjeshtë dhe ata të elitës në lidhje me çështjen e mashtrimit të kësaj bote.

Në këtë material do të ndajmë me lexuesit tanë këshillat e Imam Rabbanit, të cilat na ndihmojnë që të vendosim ekilibrin ndërmjet fesë dhe kësaj bote. Sipas Imam Rabbanit, realiteti i kësaj bote është ky:

*“O bir! Kjo botë është një vend sprovimi dhe vështirësie. Aparenca e saj është e stolitur dhe e zbukuruar me çdo lloj stolie. Fytyra e kësaj bote, me makiazhin me pikëla dhe vija ngjyra-ngjyra që ka bërë, me gërshetat dhe me faqet fallso që mezi i ka zbukuruar, i ngjan një gruaje të shëmtuar. Me shikim të parë duket joshëse, e bukur, e freskët, e re dhe vezulluese. Ndërsa në të vërtetë, i ngjan një kërmë mbi të cilën është hedhur erë e mirë dhe një vendi plehrash, drejt të cilit vrapojnë qentë dhe mizat. Ajo është një helm, e shfaqur si vegim në shkretëtirë dhe si diçka e ëmbël, të cilën njeriu i etur e pandeh se është ujë.” (Letra e 73.)*

Me të vërtetë edhe sot, shumë njerëz mashtrohen ndaj kënaqësive të përkohshme të kësaj bote dhe punojnë për dynjanë, sikur nuk do të vdesin asnjëherë. Ata jetojnë dhe brengosen vetëm për këtë botë, duke e harruar ahiretin. Të shpëtosh nga këto lloj brengosjesh si një njeri me vlerë, është shumë e vështirë. Në këtë situatë, Imam Rabbani na këshillon që ta lëmë këtë botë, të paktën ligjërisht:

*“Atij njeriu që dëshiron të fitojë ahiretin, i takon që ta lërë këtë botë. Për shkak se sot është e vështirë që ta lësh këtë botë në kuptim të plotë, atëherë është obligim që të lihet ligjërisht. Lënia e botës ligjërisht do të thotë:*

*Të lidhesh ashtu siç duhet pas ligjeve të shariatit të lartë në çështjet fetare, të respektosh kufijtë ligjorë në çështjet e ngrënies, pirjes dhe banimit. Të mos e teprosh në këto çështje, të japësh zekatin e pasurisë dhe të kafshëve, i cili është obligim. Nëse është e mundur që të stolisemi me ligjet e shariatit, është e mundur që të shpëtojmë edhe nga dëmet e kësaj bote. Ja, pikërisht atëherë është arritur ekilibri ndërmjet botës dhe fesë.” (Letra e 72.)*

Sipas Imam Rabbanit, myslimanët që janë mashtruar pas jetës së kësaj bote, janë ata që nuk kanë zbatuar urdhrat e fesë në lidhje me çështjen e pasurisë që kanë fituar. Këtë klasë njerëzish, Imam Rabbani e përkufizon kështu:

*"Nëse një njeri nuk mund ta lërë këtë botë, qoftë edhe ligjërisht, ky lloj njeriu është jashtë temës sonë. Besimi i tij në këtë formë, nuk do t'i bëjë dobi në ahiret."* (Letra e 72.)

Imam Rabbani tregon se është shumë e vështirë për të ikur nga kjo botë dhe se janë shumë të paktë ata myslimanë që mund të shpëtojnë nga shërrti i saj. Ai thotë:

*"Sa fatmirë është ai njeri që e dëgjon këtë fjalë të drejtë, edhe pse në këtë botë ka shumë shërbëtorë që shtiren, ushqime të shijshme dhe rroba të bukura që e ndihmojnë."*

*Ai që e ka mbyllur veshin ndaj thirrjes sime, nuk dëgjon!  
Ia shpjegoj, qaj, por ai nuk pranon!"* (Letra e 72.)

Hazreti Imam Rabbani e përkufizon kështu këtë botë, e cila nënçmohet në Kuran dhe në hadithe:

*"O bir! A e di çfarë është kjo botë? Kjo botë është çdo gjë, si gratë, fëmijët, pasuria, fama, pozita, argëtimi dhe loja që të largojnë nga Allahu Subhanehu ve Teala dhe të pengojnë që të arrish te Ai."* (Letra e 73.)

Faktikisht, këto mirësi janë krijuar për njeriun. Problemi nuk është në përdorimin e tyre, por, kur të përdoren, të mos humbasë synimi bazë dhe të mos lejohen që të pengojnë arritjen te Allahu Teala.

Ata, të cilët largohen nga Allahu, duke u kënaqur me këtë botë, janë njerëz që e kanë humbur ekuilibrin mendor. Ata janë njerëz që e kanë këmbyer të përhershmen me të përkohshmen dhe të bukurën me të shëmtuarën. Njëkohësisht e kanë harxhuar edhe kapitalin e përjetësisë që kanë në duart e tyre:

*"Ai që është dashuruar me të (dynjanë), konsiderohet shpërdorues dhe i marrë. Ai që ndjek atë, është i çmendur dhe i mashtruar. Kush jepet pas aparençës së atij njeriu, në fytyrë i vendoset vula e humbjes së përhershme."* (Letra e 73.)

Sipas Imam Rabbanit, njeriu së pari duhet ta njohë mirë mashtrimin e kësaj bote, në mënyrë që të mbajë ekuilibrin ndërmjet fesë dhe botës. Përndryshe, kjo botë e mashtron njeriun dhe e bën ta harrojë ahiretin.

*"I mençur është ai që nuk mashtrohet pas një kënaqësie të tillë të thatë dhe që nuk ndjen interes për një gjë të prishur si kjo. Për këtë arsye, fakihët (juristët myslimanë) kanë thënë: "Nëse një njeri ua lë testamentin e pasurisë së tij njerëzve të mençur, pasuria e tij u jepet njerëzve asketë." Sepse ata nuk ndjejnë interes ndaj kësaj bote. Kjo tregon mentalitetin dhe zgjuarsinë e lartë të tyre."* (Letra e 50.)

Këto fjalë të Hazretit Imam Rabbanit janë për ata njerëz të cilët mashtrohen ndaj bukurive të përkohshme të kësaj bote. Sikundër kësaj, Hazreti Imam Rabbani në letrat e tij është bërë shkak që t'u plotësojë nevojat e kësaj bote shumë njerëzve dhe që mundësitë që kanë njerëzit, të përdoren në shërbim të fesë. Ai e shprehte kështu faktin se pasuria që harxhohet për të ngritur lart sheriatin te Allahu do të ketë shpërblim të pafund, duke thënë:

*"Nëse me mijëra florinj harxhohen për të lartësuar sheriatin dhe fenë, edhe virtyti i tyre do të jetë shumë i lartë. Madje, edhe një grosh që harxhohet me këtë qëllim, është i barabartë me mijëra florinj që harxhohen për qëllime të tjera."* (Letra e 48.)


Të mëdhenjtë nakshibendij kanë vendosur parimin: "Dora në punë, Zemra te Zoti", për t'i mbajtur në ekuilibër punët e fesë dhe ato të kësaj bote. Njerëzit e mëdhenj, si Musa Topbashi, që ishte prej të mëdhenjve të zinxhirit të hoxhallarëve dhe që e kemi humbur në një kohë të afërt, fitonin për hir të Allahut dhe pasurinë e tyre sa malet e harxhonin për të.

Kur këta miq të mëdhenj të Allahut shpenzonin për vete, ishin shumë kursimtarë, ndërsa kur bëhej fjalë për fenë e Allahut, xhelle xhelaluh, jepnin me lehtësi pasuri shumë të madhe, madje pa përdorur emrat e tyre.

Në këtë mënyrë e shtruan dynjanë poshtë këmbëve të tyre për hir të fesë, në vend që të harxhonin fenë për hir të kësaj bote dhe pasurisë e saj, që është arma më e madhe e shejtanit për të mashtruar myslimanët, e bënë kurban në rrugë të Allahut, Subhanehu ve Teala. Shkrimin tonë le ta mbyllim me këto fjalë të Hazretit Imam Rabbanit:

*"Prejetikës së misticizmit është edhe parimi që ta ndash shumë pasurinë dhe të mos e kursesh atë, por pa i lënë në pozitë të vështirë fëmijët dhe gruan. Ai që e njuh Allahun, thesaret e Tij i shikon si një det, ndërsa veten e tij si një njeri të ulur në breg të atij deti. Ai, i cili qëndron në breg të detit, nuk ka nevojë që të mbartë ujë, për shkak se gjithmonë është pranë ujit."* (Sadik Dana, Ligjëratat e Alltënollukut, III, 52.)

I Nderuari Hz. Musa Topbash e vendosi lidhjen që kishte me këtë botë në një themel të tillë dhe harxhoi në rrugë të Allahut pa iu trembur syri. I lutemi Allahut të Madhëruar që edhe ne të na ndihmojë ta arrijmë këtë moral shembullor që kishin miqtë e Tij me karakter të lartë.



# Universi i Kuranit

*Nexhat Ibrahimi*

## **PËRSIATJE HYRËSE**

Kurani zë vendin qendror në islam. Ai është ligjërim i amshueshëm dhe Fjalë e amshueshme që iu shpall Pejgamberit Muhamed (a.s.), të cilin e zgjodhi për këtë detyrë vetë Allahu i madhërishëm.

Kurani është shpallja e fundit e Zotit për njerëzimin, testamenti i fundit i Allahut për njeriun. Ai paralajmëron se rrugëtimi njerëzor në Tokë dhe në këtë gjithësi nuk është i kotë, se veprat njerëzore nuk janë pa përgjegjësi e pa një synim më të lartë.

Edhe pse njeriu është dëbuar nga xheneti, ai nuk është braktisur nga udhëzimi i Providencës hyjnore. Nga Amshueshmëria e Tij - Leuhi Mahfudh, Allahu i lartësuar ia zbrit njeriut Fjalën e Tij përmes felajmëruesve, siç ndodhi me suhufet, Tevratin, Zeburin, Inxhilin dhe Kuranin. Ky komunikim i vazhdueshëm ndodhi për shkak se njerëzimi fliste gjuhë të ndryshme, por edhe për shkak të zhvillimit e të pjekjes graduale të tij.

Islami na mëson se Kurani i njeh dhe i pranon të gjitha shpalljet pararendëse në formën e tyre origjinore, pa ndërhyrjen e historisë. Kurani është e gjithë shpallja, që nga fillimi e deri në fund, kurse Muhamedi (a.s.), është i gjithë cikli pejgamberik, nga Ademi e deri te Isai (a.s.).

Kurani filloi të shpallet në muajin ramazan të vitit 610. Kjo shpallje e ardhur nga Zoti te Pejgamberi nëpërmjet melekut Xhibril, është objekt i krijimeve më të bukura, si në shkencën e tefsirit, ashtu edhe në gjinitë e tjera shkencore e letrare. Në përfundim të shpalljes filloi faza tjetër, ajo horizontale, pra futja e Kuranit nga amshueshmëria në kohë, në gjuhën arabe, në tokën arabe, destinuar për njerëzit e të gjitha gjuhëve, të të gjitha ngjyrave, të të gjitha diversiteteve. Shkronja e tij, fjala e tij, fenomeni i librit, i lapsit, i letrës, u prit me kujdesin dhe respektin më të lartë të mundshëm, madje u shndërrua në kult. Për këtë arsye, edhe sot e kësaj dite myslimani nuk e dëmton letrën, por e ruan atë dhe e ngre në lartësitë më të mëdha, për shkak se në të shkruhet edhe Fjala e Allahut... Në anën tjetër, Kurani ka bërë që nga faqet e tij të burojë entuziazmi më i madh i mundshëm në histori. Aty janë faqet më të mira të kodekseve jetësore dhe të mirësjelljes, të kulturës së banimit dhe të veshmbathjes, të kuzhinës dhe pikëpamjeve të tjera jetësore. Shtëpitë e drejtura nga dielli, minaret që futen thellë në qiell, shatërvanët dhe krojet si shenja xheneti, xhamitë dhe hamamet si manifestim i pastërtisë shpirtërore dhe fizike, bibliotekat dhe medresetë si mjete meditimi e mësimi, të gjitha këto janë manifestim i thesarit që myslimanët dhe bota i kanë

para vetes, me ose pa vetëdije.

### **KURANI ËSHTË KOZMOSI QË FLET, KOZMOSI ËSHTË KURAN QË HESHT! (IBN ARABIU)**

Lexuesi i Kuranit që takohet me këtë libër, qoftë në origjinal ose në përkthim, sidomos lexuesi i papërgatitur për leximin e Kuranit, nuk do të ndihet mirë. Nga librat e tjerë ai është mësuar ta shohë fillimin, përpunimin dhe përfundimin logjik të temës, por këtë mënyrë nuk do ta gjejë në Kuran. Përse? Sepse, Kurani me pazakonshmërinë e tij u ngjan viseve të egra në natyrë, të cilat nuk janë të tematizuara, të sistematizuara; natyra e egër nuk është prekur dhe mbikëqyruar nga njeriu, në dallim nga vendet e gjelbëruara në jetën e njeriut. Në Kuran do të gjejmë shenja të shumta kozmike, të cilat i janë drejtuar qëllimisht veshit të njeriut, sikurse edhe shenjat kozmike që i janë drejtuar qëllimisht syrit të njeriut. Syri i atij njeriu që sheh rend e unitet në kozmos, do të gjejë rend e unitet edhe në Kuran.

Kurani përmend çdo gjë; në të ekziston çdo gjë. Por, si të zbulohen tërë ato thesare, si të shpjegohen tërë ato mistere, si të bëhen të dukshme tërë ato vlera!? Këtë detyrë të vështirë e kanë marrë mbi vete komentuesit e Kuranit. Prej shekujsh të tërë ata gjurmojnë, meditojnë, analizojnë dhe, mund të themi se, pak a shumë, e kanë kryer me sukses detyrën e tyre; nga mushkonja e milingona deri te njeriu, toka dhe qiejt në horizont. Kurani i përmend gjërat që shihen, por edhe ato që nuk shihen apo që s'do mund të shihen ndonjëherë (*Pasha ato që ju, krijesat, i shihni dhe ato që nuk i shihni*). Kurani pyet! Pyetjet e tij sfidojnë. Sfidat e tij nxisin, si lexuesin (syrin) ashtu edhe dëgjuesin (veshin).

Ja disa shembuj të mrekullueshëm:

***“A e keni parë farën që e hidhni? A jeni ju që e krijoni atë apo jemi Ne krijuesit e saj? Ne e caktojmë vdekjen tuaj dhe askush nuk mund të na pengojë që t’jua ndryshojmë trajtën dhe t’ju rikrijojmë ashtu si nuk e dini (në Ditën e Ringjalljes). Sigurisht, ju e dini krijimin e parë (prej një pike fare), atëherë përse nuk mendoni?! A shihni atë që mbillni? Vallë, ju e bëni atë që të mbijë apo jemi Ne rritësit e saj? Nëse duam, Ne e lëmë fyçkë dhe ju do të çuditeni (e do të thoni): “Ne jemi të dëmtuar, madje jemi krejt të privuar (nga furnizimi)! A e shihni ujin që pini? Vallë, ju e zbrisni atë prej reve apo Ne e zbresim? Nëse duam, Ne e bëjmë atë të njelmët, andaj përse nuk jeni mirënjohës?! A e shihni zjarrin që e ndizni? Vallë, ju i keni bërë drutë për të apo Ne i kemi bërë?! Ne e kemi***

***bërë atë përkujtues (të zjarrit të Xhehenemit) dhe, që t’u sjellë dobi nevojtarëve, prandaj lavdëroje emrin e Zotit tënd të Madhërishëm! Beto hem në çastin e perëndimit të yjeve, e ky është betim i madh, veç sikur ta dinin.”*** (El-Vakiah, 58-76).

Ky është Kurani, natyra në fjalë! Këtë mund ta kuptojë vetëm ai që ka një njohje sa i takon unikalitetit të universit ose të kozmosit, sepse pikërisht kur ne mendojmë se e arritëm përgjigjen përfundimtare, që ajo, pra përgjigja na zbulohet pas perdes qiellore, Kurani na e kthen vëmendjen te njeriu dhe te eshtrat e tij të kalbura: ***“Vallë, pasi të vdesim e të bëhemi pluhur?”***. (Kaf, 3) Kjo na përkujton detyrën tonë njerëzore, që në çdo gjë ta shohim praninë e Zotit, shenjën e Zotit, gjurmët e Zotit dhe afërsinë e Zotit. Së këndejmi, është e domosdoshme që Kuranit t’i qasemi hapur dhe me synime të pastra, siç thotë babai i Muhamed Ikbalit: ***“Sikur të na shpallet vetë neve”***.

### **NJERIU NË EPIQENDËR**

Ndonëse edhe qiejt, edhe Toka, edhe bimët e kafshët janë të përsukuara nga mëshira e Allahut, njeriu, pikëpamja antropologjike dhe etike e tij mbetet pika qendrore e Kuranit. Të gjithë privilegjoohen me shpallje të drejtpërdrejta, por vetëm njeriu është pranues i shpalljes së Allahut në formë fjale, flete apo libri. Ai është qenie e botës, qenie e alternativës, e lirisë, por edhe zëvendës (halif) i Allahut në Tokë. Për t’iu shmangur rrëmujës, dhunës e mungesës së rendit, njeriu në aleancë (mithak) me Krijuesin kryen misionin e tij fisnik të ndërtuesit, të vlerave, të halifit, të të diturit (*ue al-leme Adem’el-esmae kul-leha...*). Njeriu nuk

e zotëron gëzofin për ngrohje, por arrin ta thurë atë nga bota bimore e shtazore. Njeriu nuk ka kthetra e nuk ka dhëmbë shqyes, por këtë mangësi e kompenson me dije; vetëm njeriu udhëton larg, punon tokën, i shkruan ngjarjet e tij, ka varreza, krijon art, ka histori... Njeriu di për kohën, njeriu di ta njehsojë kohën, ditët, vitet dhe shekujt. Vetëm ai di ta llogarisë kohën, vetëm ai di edhe të besojë në amshueshmëri e të besojë në Zot. Kjo është arsyeja pse pati të dërguar (*rusul - enbija*) vetëm nga njerëzit, e jo edhe nga krijesat e tjera. Kjo na shtyn të besojmë se veprimet njerëzore përcillen nga “Lart” dhe për to jepet llogari, sepse veprat njerëzore nuk kanë si synim përfundimtar këtë botë, por botën tjetër. Kjo botë (*ed-dunja*) dhe ajo botë (*el-ahiret*) përbëjnë një tërësi që njeriu e mëson në dy etapa. Meqenëse njeriu është qenie harruese, Kurani është këtu që t’ia kujtojë detyrimet e tij ndaj Zotit, por edhe ndaj të tjerëve: njerëzve, shtazëve, bimëve, botëve të njohura dhe të panjohura.

*Kurani është shpallja e fundit e Zotit për njerëzimin, testamenti i fundit i Allahut për njeriun. Ai paralajmëron se rrugëtimi njerëzor në Tokë dhe në këtë gjithësi nuk është i kotë, se veprat njerëzore nuk janë pa përgjegjësi e pa një synim më të lartë.*

## LEXIMI I SHENJAVE (AJETEVE) NË GJITHËSI

Mbreti mesopotam ndërtoi një labirint madhështor. Pastaj ftoi mbretin beduin me qëllim që t'ia bënte të ditur aftësinë dhe fuqinë e tij. E futi në labirint dhe, pas shumë bredhjeshe e kërkimesh, beduini doli nga ai vend. Në shenjë dominimi dhe krenarie, ai e pyeti mbretin beduin nëse kishte ndonjë gjë në mbretërinë e tij që mund t'ia kalonte këtij labirinti. Beduini i tha se kishte dhe e ftoi ta vizitonte atë në shkretëtirë. Kështu, pas një kohe, mbreti mesopotam ia ktheu vizitën mbretit beduin. Pas pritjes dinjitoze që i bëri, beduini e shpuri mbretin mesopotamik në shkretëtirë dhe i tha: *"Ja labirinti im!" "Gjeje rrugën nga ky vend dhe më thuaj se a ka ndonjë çudi mbi çudinë e Zotit!"*

Por, në shkretëtirë çdo gjurmë fshihet shpejt nga era që fryn. Njeriu xhiron kudo që nis, kurse mbi të qëndron **horizonti**, **pafundësia**, që nuk është vepër e njeriut. Në këtë labirint të pafund njeriu kërkon udhërrëfyes, të cilin do ta gjejë në qiellin e yjzuar që ndodhet përmbi ne. Leximi i vendndodhjeve të trupave qie-llore do ta nxjerrë njeriun nga **pafundësia** shkretinore, kurse njeriu do të tregohet si qenie **e orientimit** dhe gjurmues **i lindjes** (*east*) së kuptimit.

Sipas Kuranit, janë dy lloj Fjalësh të shpallura të Zotit:

- **Fjala e Zotit** në një prej librave të mëdha (fletët, Tevrati, Zeburi, Inxhili dhe Kurani)

dhe

- **Bota** si Fjalë e Zotit.

Edhe fjalitë në Kuran, edhe vetë natyra (fenomenet natyrore) në Kuran, quhen **shenja (ajete)** dhe paraqesin çudi të jashtëzakonshme. Para tyre mbeten të nemitura e të habitura edhe mendjet më të mëdha. Janë shkruar shumë komente dhe shpjegime, por as librat e deritanishëm nuk kanë arritur ta shpjegojnë tërësisht, dhe as librat e ardhshëm nuk do ta shpjegojnë atë deri në fund. Prandaj janë themeluar shumë shkencë mbi kozmosin. Por, as fizikat e deritanishme nuk e kanë shpjeguar kozmosin dhe as fizikat e ardhshme nuk do ta shterrojnë dijen mbi kozmosin. Nuk duhet harruar se mjetet për

studimin e ajeteve janë sipas (syrin të) njeriut dhe jo sipas syrit të shpendëve, ndaj edhe rezultatet janë njerëzore e jo shpendore apo diçka tjetër. Sado që të shkruhen komente në lidhje me shenjat e Zotit, ato janë vetëm drita të thyera nëpër kristalet e shpirtit të njeriut.

## NJERIU, SI SHPJEGUES I BOTËS SË KURANIT

Çdo gjë që njeriu ndërtoi, shkroi apo këndoi, është vetëm shpjegim i tij për botën. Këtë e shpjegon edhe mënyra e veshmbathjes së njeriut, e ndërtimitarisë, e kulinarisë etj. Madje, edhe pozicioni i njeriut është pozicion i komentimit (komentuesit?) të botës. Nëse njeriu nuk është në gjendje të bëjë diçka tjetër, ai ka mundësi ta komentojë botën e Kuranit dhe këtë e ka arritur, duke e bërë Kuranin, librin më të komentuar, por njëkohësisht edhe më të pakomentuar në botë. Përse është kjo

gjendje? Sipas mendimit të një komentuesi (Ibn Arabiu), ne jo vetëm që nuk e njohim botën në tërësi, por as nuk e shohim në tërësi. Kjo gjendje është për arsye se vetëdija jonë zhytet çdo ditë *në gjumë*, kurse sytë zhyten çdo çast *në terr!* Për këtë shkak njeriu hamendëson, komenton.

Kurani e përshkruan veten me fjalën *dritë*. Në anën tjetër, njeriu nuk e shikon vetë dritën, por të ndriçuarën. Vetë drita është si xhevahiret në fund të detit. Për të depërtuar në thellësi të ujit e për t'i nxjerrë ato, duhen njohuri. Për ta shikuar vetë dritën, domethënë vetë thesaret e Kuranit, lexuesi duhet ta njohë artin e eksplorimit të tij, sepse nuk duhet harruar se Kurani është një det i thellë pa brigje, i cili i josh dhe fton të guximshmit, të diturit, më të mirët. Ky është Kurani, i cili na mëson që në mënyrë korrekte t'i lexojmë pulset e universit, si të syrit të vogël të njeriut, ashtu edhe të yllit të largët në horizontin e pafund.

## KORNIZAT E NJERIUT, SI FISNIKËRIM

Edhe pse lexojmë se Kurani është burim ligjvënës, burim i kriterëve juridike dhe morale, prapëseprapë në Kuran janë të pakta tekstet me karakter të këtyllë. Megjithatë, kjo nuk e liron njeriun në atë masë, sa të bëhet i pavarur në veprimet e tij. Ai ka shumë kufizime, si të gjinisë, racës, gjuhës, kufizime kohore, kufizime për shkak të sëmundjes, vdekjes etj. Gjithsesi, këto kufizime nuk e pengojnë atë që





të bëhet përfaqësues i Zotit në Tokë dhe zbatues i ligjit të Zotit, nuk e pengojnë për të qenë faktor në zbulimin e rrugëve më të frytshme për aplikimin dhe zbatimin e ligjeve të Zotit. Nga ana tjetër, në rrafshin historik mysliman, komentimet normative, juridike, zënë vend me rëndësi. Atje **çdo gjë** shpjegohet. Madje aty trajtohen hollësisht edhe mënyra e ngrënies dhe e pirjes, mënyra e prerjes së mustaqeve, gjatësia e tyre, rregullat martesore etj. Prandaj është i qëndrueshëm pohimi se pretendimi i këtyre komenteve është që ta kundrojnë jetën në *tërësi* dhe *tërësisht*, gjë e cila është në përputhje me kërkesat islame, që në një vend apo shoqëri të manifestohet Fuqia e Zotit në mënyrë të kufizuar. Përkundrazi, jeta e njeriut është mbirje, gjallëri, të cilën dispozitat kuranore përpiqen ta kultivojnë, e jo ta ngatërrojnë e ta kufizojnë.

### ZOTI ËSHTË NJË I VETMI

Në komentimet e shumta të Kuranit, që na nxjerr përpara historia, gjejmë punë të vyeshme njerëzore. Çdo gjë është studiuar, por më shumë spikat forma më e pastër e monoteizmit, **besimi në Një, të Vetmin Zot**; i pranuar me zemër dhe i komentuar me mendje. Edhe Kurani, nga ana e tij, me përkushtim dhe me devotshmëri, ka dëshiruar të zgjojë brenda nesh mendimin zanafillor mbi Zotin, mbi besimin në Zotin, mbi vetëdijen tonë për Zotin. Ky besim u bë botëror, global dhe në çdo sekondë përgjatë 24 orëve dëshmohet se Ai është Një, i Vetmi. Ai nuk ndryshohet, siç mund të ndryshohen shkollat besimtare e juridike ose sistemet politike.

Po ashtu, duke lexuar Kuranin, lexojmë se njeriu është **abd**, rob i Zotit. Ky përcaktim i njeriut në Kuran: të jesh me vetëdije rob i Zotit do të thotë të jesh qenia më e lirë ndër të gjitha krijesat, sepse, të jesh **rob** vetëm i Zotit, të Pavarur dhe të Gjithëmundshëm, i Cili nuk ka nevojë për asgjë, do të thotë të jesh mirëfilli i lirë.

### KURANI DHE KOMENTIMET E TIJ, HISTORIA MË BESNIKE MYSLIMANE

Kurani, gjatë historisë së tij 14-shekullore, kurrë nuk ka qenë në gërshetim më të ngjeshur e më divergjent mes komentimesh e metodash. Mund të thuash se nuk ka sistem e metodë teologjike, letrare, politike e filozofike në Lindje e Perëndim, që të mos e ketë përqendruar vëmendjen në Kuran. Këtë e kushtëzon jo vetëm karakteri planetar i qytetërimit modern, por edhe universaliteti dhe aktualiteti i porosisë kuranore. Rrënjët e kësaj gjendjeje do të duheshin kërkuar, ndër të tjera, qysh në zanafillën, në kohën kur porosia kuranore çau historinë dhe hyri

në hapësirën tokësore, duke shënuar atë që i përket të shkuarës, të tanishmes dhe të ardhmes. Kjo logjikë na shtyn që interesimin për Kuranin ta kemi jo vetëm nga vetë myslimanët, por edhe nga jomyslimanët. Në fund të fundit, çdo komentim bashkëkohor i Kuranit do të ishte i cunguar pa përfilljen "e kritikës" judaiste, kristiane, manikeiste të Kuranit, si edhe pa "kritikën" myslimane të tij.

Myslimanët e hershëm gjetën në Kuran "**çdo gjë**" që u nevojitej: ata gjetën përgjigje për sfidat politike e ekonomike, por edhe për sfidat filozofike e religjioze greke, persiane, hinduse etj.

Por, a mund të jetojmë ne myslimanët e sotëm duke u ushqyer me lavdinë e brezave të hershëm?! A do të ishte e ndershme e dinjitoze të mburremi me ta, teksa ne vetë të lavdërohemi me përtacinë konstante?! Natyrisht jo! Para brezit tonë qëndron një punë shumë serioze, e lodhshme: leximi i serishëm i Kuranit, përkthimi i serishëm i Fjalës së Allahut.

Koha, në të cilën dominon shkenca, karakterizohet si kohë e terrorit shkencor. Andaj shtrohet pyetja: a është shkenca moderne shkencë e përgjegjshme, dhe a çan kokën kjo shkencë për dijen drejt së cilës synon? Gjatë një periudhe të gjatë që po kalon kjo shkencë, ne nuk vërejmë përhapje të dashurisë, të kujdesit, të mëshirës e të ndihmës së ndërsjellë. Sot, për fat të keq, ne po shohim vetëm shtrirje të urrejtjes, tmerrit e dhunës. Për herë të parë në histori shtrirja e kufijve të dijes shkon drejt **të panjohurës së rrezikshme**, por vetëm si rezultat i dijes pa Zot, e jo i dijes së fesë, duke mos e pasur atë nën kontroll dhe në dobi të njeriut. **E panjohura e fesë ka nxitur artin, kurse e panjohura e shkencës nxit frikën dhe tmerrin!**

Njerëzimin, e sidomos myslimanët, i pret leximi i ri i Kuranit. Çdo periudhë që pati qasje aktive dhe të sinqertë ndaj Kuranit, u shpërblye me dhurata të çmueshme. Varrësisht nga angazhimi në këtë detyrë, do të pasojë edhe pjesëmarrja dinjitoze në jetën e botës aktuale. Rrjedhat aktuale në botë nuk duhen të neglizhohen, as të anatomen, sepse një qasje e tillë do të na kushtonte shumë.

Kurani është shpallje përfundimtare, por perceptimi dhe shpjegimi i tij nuk është përfundimtar, ashtu sikundër çdo shi bie në Tokë si rezultat i kushteve gjithnjë të ndryshme, edhe pse teksa bie nga qielli duket gjithnjë i njëjtë.

# DYZIMI I NJERIUT

Në botën e sotme, qenia mbi të cilën flitet më shumë pa asnjë lloj mëdyshjeje, është njeriu dhe vendi që zë ai në botë dhe në univers. Nga ana tjetër, njeriu është njëkohësisht edhe qenia më e sulmuar, për t'u zhbërë si njeri, si personalitet. Kjo goditje ndaj të qenësishmes së njeriut nuk mund të ndodhë spontanisht, aksidentalisht, rastësisht. Ajo çfarë po synohet sot, është shndërrimi i njeriut në shumësi kopjesh, për të përmytur origjinalin, unin e qenësishëm. Mundësia e dyzimit të qenies njerëzore është prezente përmes procesit të formimit të një uni paralel, me unin fillestar, me unin origjinal. Ky un paralel apo pseudoun merr përsipër të luajë rolin e unit origjinal, duke prodhuar ndjesinë se njeriu është duke vepruar në përputhje me unin origjinal. Në këtë mënyrë, pseudouni ka vendosur nën kontroll veprimtarinë njerëzore, duke sfumuar, zvetënuar pothuajse tërësisht, unin autentik, unin origjinal dhe të parëhershëm. Fakti që njeriu mund të luajë shumë role, pors i një kameleon, në marrëdhëniet me të tjerët, nuk do të thotë se shumësia e roleve kapërcen unin origjinal, porse shumësia e roleve vjen si rezultat i formimit të pseudounit, që mbizotëron veprimtarinë e këtij njeriu, duke e kameleonizuar. Pavarësisht kësaj situatë, ku uni është i mbytur nga pseudouni, uni fillestar është aty, i struktur nga stuhia e pseudounit, që në një situatë të çfarëdollojshme të fillojë të rilulëzojë, duke u ridimensionuar sipas atyre ndjesive fillestare, origjinale, autentike, që kanë qenë të ndrydhura, për shkak se kanë qenë nën trysinë e pseudounit, që më shumë sesa për respektimin e origjinalitetit të unit fillestar, merakoset për konformizmin, përshtatjen, me shpresën se duke u konformizuar, nuk do të konfrontohet me pjesën tjetër të shoqërisë, paçka se humbet origjinalitetin dhe rrezikon anonimat, madje këto të fundit janë të parapëlqyerat e pseudounit. Duke u dyzuar dhe nën trysinë e pseudounit, humbet sigurinë në vetvete, gjykimin e shëndoshë, sepse tashmë nuk është më vetvetja, edhe pse mund të kujtojë se është vetvetja. Meqë më shumë se sa për origjinalitetin e unit, shqetësohet për atë se çfarë të tjerët kërkojnë të shfaqë, ndihet krejtësisht i zhgënjyer dhe i pasigurt në personalitetin e tij, sepse forca e të tjerëve, e modelit sundues të shumicës është më e fortë se forca e personalitetit të ndërtuar mbi pseudounin. Pamundësia për të dalë në kundërrymë, paçka se të tjerët janë aty, e bën të ndihet konfuz, i paqartë, madje dhe i depresionuar shpeshherë dhe konformiteti e përshtatshmëria duket sikur e qetësojnë, por nuk mund t'ia largojnë dobësinë

e paqëndrueshmërisë së personalitetit të sunduar nga pseudouni. Ky njeri i konformuar dhe i përshtatur ndaj modelit sundues të shumicës, nuk jeton më për veten, por jeton për të tjerët. Personaliteti i tij nuk formohet përmes përpjekjeve për të ruajtur origjinalitetin njerëzor, përmes njohjes së qenies së tij, por formohet ashtu si të tjerët dëshirojnë të formohet. Fjalët, sjellja, veprimet e tij nuk mund të jetësohen pa marrë më parë miratimin e të tjerëve, qoftë edhe përmes heshtjes, sepse nuk gjen dot forcë në vetvete për të thyer akullin me emërtimin "modeli sundues i shumicës", që akullzon personalitetin e tij. Përshtatshmëria ndaj modelit sundues të shumicës, konsiderohet si e vetmja kurë për të qenë "i qetë", nga shigjetimet, etiketimet e kësaj shumice, që nuk mund ta gëlltisë dot faktin se dikush prej qenieve njerëzore qenka rebeluar ndaj modelit sundues, duke ndjekur një model kryekëput të ndryshëm, madje të mospërputhshëm dhe krejtësisht kundërvënës në thelbin e vet, ndaj modelit sundues. I gjendur në një sipërmarrje të kësaj natyre, fare e panatyrshme për shumicën e të tokësorizuarve, nuk mund të përjashtohen edhe epitete stigmatizuese ndaj kësaj qenieje. Paçka situatës në të cilën kjo qenie gjendet dhe jo pa urtësi, dritësimi që buron nga parimet e epërme dhe shkakësitë parake e mëkojnë pandalshëm dhe, pikërisht ky dritësim që formëson personalitetin e qenies njerëzore, është e vetmja forcë që mund të thyejë akullin e modelit sundues të shumicës. Ashtu sikundërse modeli sundues manifeston vetveten, ashtu edhe qenia rebeluese ndaj këtij modeli ka të drejtë ta manifestojë vetveten në origjinalitetin e vet, sepse ky nuk është manifestim i vetëreklamimit në kufijtë e vetvetes, por manifestim i fuqisë së të vërtetës nëpërmjet qenies njerëzore. Në rast se nuk do të kemi personalitete të ndërtuara sipas parimeve të së vërtetës, tjetërsimi, depersonalizimi dhe tëhuajësimi do t'i shfaqen këtij njeriu si "vlerat" që janë të domosdoshme për të "qenë" vetvetja. Kjo është logjika e pamundësisë së shkëputjes nga grupi, masa, turma, ku njeriu nuk është më njeri, por grup, turmë, masë, kategori, tek të cilat shkarkon dhe përgjegjësinë personale për zgjedhjet e tij, pavarësisht se zgjedh mbi dëshirën e të tjerëve, sepse personaliteti i tij anonim projektohet tek masa dhe turma. Kështu humbet dhe shkrihet personaliteti njerëzor, si nisja në oqean, shkrihet prej së cilës humbet dramën e të qenit njeri, humbet atë çfarë në të vërtetë e bën të jetë njeri, lirinë.

# Shenjat e një familjeje të lumtur

M. Sami Ramazanogllu

Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve sellem, ka thënë:

*"Tri gjëra e bëjnë të lumtur njeriun në këtë jetë dhe e bëjnë të pikëlluar, në qoftë se nuk i zotëron ato. Ato që e bëjnë njeriun të lumtur janë: një bashkëshorte e mirë, besimtare dhe e ndershme, një kafshë transporti e mirë, e lehtë dhe e shpejtë, si dhe një shtëpi e gjerë dhe e rehatshme. Ndërsa jetën njeriut ia bëjnë të vështirë tri gjëra: një shtëpi e keqe, e ngushtë dhe me probleme, një kafshë transporti e keqe dhe një bashkëshorte e paedukuar."* (Ebu Davud)

Me kafshën e transportit nënkuptohet çdo lloj kafshe apo mjeti transporti. Rasti i shtëpisë që nuk është e ngushtë, e keqe dhe me probleme, duhet trajtuar në varësi të gjendjes ekonomike të individëve të ndryshëm, sepse ka shtëpi të ngushta, që për një pjesë të njerëzve konsiderohen të mëdha.

*"Martohuni, sepse unë do të mburrem me numrin e pasuesve të mi përpara umeteve të tjera."* (Taberani)

*"Martohuni dhe mos u divorconi, sepse Allahu nuk i do, as meshkujt dhe as femrat, të cilëve u intereson vetëm qejfi dhe rehatia e tyre."*

*"Njeriu më i keq është ai që përdor dhunën ndaj familjes së tij."* (Taberani)

Autori i librit Menavi, shkruan se hadithi nga është shkëputur kjo pjesë, është kështu:

Sahabët e pyetën profetin:

- O i Dërguar i Allahut! Si mund të bëjë presion njeriu mbi familjen e tij?

Ai tha:

- Kur njeriu vjen në shtëpi, e shoqja dridhet nga frika dhe fëmija nuk do t'i vijë pranë, ndërsa kur ai del nga shtëpia, gruas së tij i qesh fytyra. Familja e tij bie sërish në qetësi dhe prehje, kur ai largohet.

*"O të rinj! Ai që ka mundësi ekonomike të martohet, le të martohet, sepse martesë është pengesa e syve kundër haramit dhe zgjidhja që ruan nderin. Ai që nuk ka mundësi ekonomike të martohet, le të agjërojë nafile, sepse agjërimi do ta ndihmojë atë të mbrohet nga harami. Agjërimi e gjunjëzon nefsin dhe e zhdruk epshin."* (Buhari, Muslim)

*"Gruaja që sjell me vete më shumë bereqet, është ajo që ka kërkesa më të pakta ndaj burrit."* (Ahmed b. Hanbel)

Gratë, një pjesë e të cilave, si në martesë ashtu edhe pas tyre hapin dyert e shpenzimeve të llojllojshme, të panevojshme, duke e lodhur për këtë arsye, si familjen e tyre, ashtu edhe shoqërinë me këto shpenzime, si rezultat i të cilave shkaktohen mosmarrëveshje, ndarje dhe divorcime të shumta, duhet t'ia vënë veshin këtij hadithi të Profetit Muhamed, në qoftë se janë besimtare:

*"Në qoftë se Allahu zgjon në zemrën e një personi dëshirën që të martohet me një grua apo një vajzë të re, nuk është gjynah që mashkulli ta shohë femrën me të cilën dëshiron të martohet."* (Ibn Maxhe)

Kushti që të dëshirosh të shohësh me synim martesën, jo vetëm që e ndalon mashkullin të shohë me epsh, por edhe e pengon të shohë femra që nuk janë të së njëjtës sërë (kufv) me të. Ashtu siç kuptohet edhe nga komentatorët e këtij hadithi, mashkulli do të mjaftohet vetëm duke parë duart dhe fytyrën e femrës, me të cilën dëshiron të martohet. Ai mund ta shohë atë më shumë se një herë.

*"Martesë më e hairit është ajo që nuk sjell vështirësi dhe probleme ekonomike."* (Ebu Davud)

*"Në qoftë se gruaja lyhet me erë të mirë, që ta nuhasë dikush tjetër përveç burrit të saj ka, për të fituar me këtë veprim vetëm zjarrin e xhehenemit."* (Taberani)

# PËRKUJDESJA MADHËSHTORE E ALLAHUT

*Shpëtim Kelmendi*

Të përfshirë në rrjedhën e turbullt të botës materiale, njerëzit shpeshherë ankohen ndaj vështirësive të jetës, ndaj mungesave sado të thjeshta, ndaj padrejtësive, ndaj pamundësisë së realizimit të dëshirave, ndaj zhgënjimeve të ndryshme që u ndodhin gjatë harkut të shkurtër kohor në të cilin shtrihet ekzistenca e tyre. Në gjendje dëshpërimi ata humbasin durimin dhe ankohen me veten e tyre ose me zë, shpeshherë duke menduar se Zoti i ka lënë pas dore dhe në një farë mënyre i ka nxjerrë nga vëmendja e Tij. Kësisoj, me apo pa vetëdije, përbluajnë pakënaqësi brenda vetes dhe u duket sikur Zoti po vonon për t'u dhënë një përgjigje gjendjeve të tyre. Mungesa e durimit është një tipar që shfaqet tek njerëzit, për shkak të mosdijes, besimit të pakët, dashurisë së tepruar për dynjanë dhe mospasjen e një ideje të qartë mbi përmasat e pafundme të mëshirës që Allahu ka për krijesat e Tij.

Allahu i madhnueshëm, as nuk vonon e as nuk nxiton në përmbushjen e vullnetit të Tij që lidhet me krijimin dhe krijesat e gjalla, sepse Ai është gjithashtu edhe Krijuesi i përpikmërisë dhe përpikmëria

Vetë. Allahu është i drejtë në përmbushjen e vullnetit të tij! Duke qenë se të gjitha cilësitë e tij kanë vlerë absolute, duke qenë se Ai është edhe krijuesi i vetë kohës, është krejtësisht e pamundur që Ai të vonohet në përmbushjen e vullnetit të tij dhe të nevojave tona. Ndiqja e Tij shfaqet në kohën e duhur, në vendin e duhur, në personin e duhur, me një saktësi dhe një masë të përkryer.

Allahu i di nevojat tona shumë më mirë se sa ne. Është pikërisht Ai, që na ka krijuar me dashurinë dhe mëshirën e Tij të pakrahasueshme, që kapërcejnë çdo lloj përfytyrimi njerëzor. Ai e do secilin prej nesh pafundësisht, më tepër nga sa ne arrijmë ta duam veten tonë, fëmijët tanë, të afërmit tanë. Shpeshherë, ajo që ne gabimisht konsiderojmë dashuri dhe mëshirë për veten, s'është gjë tjetër veçse ego e sëmurë, poshtërim i vetes dhe hapi i radhës drejt një vetshkatërrimi të pandalshëm. Mund të na duket sikur e duam veten dhe sikur po kërkojmë më të mirën

për të, por në të vërtetë, në shumicën e rasteve ne thjesht e dëmtojmë veten tonë. Pavarësisht se kemi shumë dëshira të cilat shpresojmë t'i përmbushim, është veç Allahu Ai që e di se ç'është e mirë dhe ç'është e dëmshme për ne. Sa rëndë gabojmë kur sukseset tona në këtë botë ia mvëshim vetes dhe krenohemi me to, kur në të vërtetë, të gjitha falënderimet, të gjitha përlëvdimet, të gjitha adhurimet, i takojnë Atij, më të mirit, Allahut të madhnueshëm. Dhe Ai kurrë nuk urdhëron që ne ta adhurojmë për hatër të Tij, sepse Ai është i lirë nga çdo lloj nevoje për të qenë i adhuruar, sepse Ai është i Vetëdijshëm për të qenët shumë i Lartë. Ai do që ne ta adhurojmë e të besojmë në të, veç për hir të vetes sonë, për hir të asaj që na bën njerëz të vërtetë dhe besimtarë të devotshëm, që të meritojmë begatitë e Tij në këtë botë e në botën e përjetshme.

### **PROFETI MUHAMED (A.S.), LAJMËTARI I DRITËS**

Nëse në hierarkinë madhështore të krijimit universal njeriu shfaqet si kurora më e lartë dhe si drita më vezulluese në konstelacionin e krijimit, Profeti Muhamed (a.s.), shfaqet si modeli më i përkryer dhe më i pakrahasueshëm midis njerëzve që e kanë banuar ndonjëherë këtë botë. Ai ishte dhe mbetet një lajmëtar, por një lajmëtar i dritës, sepse lajmi hyjnor që ai solli, ka depërtuar përmes errësirës së epokave kohore të kësaj bote, si një shtizë e ndritshme, duke u hedhur përtej kohës e përtej imagjinatës. Duke qenë se zbatimi dhe përmbushja e porosisë së madhe që ai solli në këtë botë na mundëson lumturinë e botës së përjetshme, atëherë na rezulton se edhe lajmi që ai solli, pra Islami, është i përjetshëm. Po ashtu, Profeti Muhamed (a.s.), është ura e mrekullueshme e komunikimit që lidh vullnetin e Allahut me vetëdijen njerëzore, është një pikë e pashmangshme orientimi për të kuptuar dhe për ta ndjerë më qartë e më thellë dashurinë, mëshirën, bujarinë dhe drejtësinë e Allahut. Personaliteti i Profetit Muhamed përbën modelin më të mirë të mundshëm që duhet të ndjekim, nëse duam të arrijmë në majat më të larta të virtytit njerëzor. Zoti e begatoi botën tonë



duke sjellë në të Profetin Muhamed (a.s.), i cili u shfaq me thjeshtësi, si të ishte njëri prej nesh, por i ngarkuar me një mision të jashtëzakonshëm të cilin nuk mund ta përmbushte askush tjetër përveç tij. Jemi mësuar të themi se ai ishte njëri prej nesh, që jetoi e vuajti në këtë botë si ne, por nuk do harruar se, përsa i takon fuqisë së besimit, bukurisë së virtytit, mirësisë, dhembshurisë dhe të gjitha cilësive të tjera, ai qëndron më lart se çdo krijesë njerëzore që ka jetuar apo që do mund të jetojë ndonjëherë në këtë botë. Në rrafshin njerëzor ai e mbështeti jetën e tij mbi një parim fare të thjeshtë, por që në të njëjtën kohë është parim madhështor: njësimi i fjalës me veprën. Kurrë në jetën e tij Ai nuk tha diçka të cilën s'e shndërroi në vepër, s'la pa përmbushur asnjë nga premtimet e tij dhe asnjëherë s'kërkoj nga të tjerët diçka të cilën s'ia kish kërkuar më parë

vetes. Ky personalitet i mrekullueshëm e kaloi jetën e tij në këtë botë me një thjeshtësi të pamagjinueshme që qëndron përtej përfytyrimit tonë mbi thjeshtësinë, duke u mjaftuar vetëm me të domosdoshmen dhe pa e njohur asnjëherë teprimin. Profeti Muhamed (a.s.), është një ndër bekimet më të mrekullueshme që Allahu i madhëruar i ka bërë njerëzimit.

### **MREKULLIA E BESIMIT NË ALLAHUN**

Ka njerëz që jetojnë në këtë botë dhe mendojnë se janë të gjallë. Ata lindin, rriten, jetojnë, kryejnë funksione njerëzore normale, krijojnë marrëdhënie me njëri-tjetrin dhe me botën materiale që i rrethon. Aktiviteti i pareshtur që ata ushtrojnë gjatë ekzistencës së tyre, i bën të mendojnë se janë të gjallë. Por, prapëseprapë, për të pohuar se je gjallë, nuk mjaftojnë as këto e as një mori bëmash të tjera me të cilat njeriu krenohet e mburret gjatë ekzistencës së tij në këtë botë. Ata nuk e kuptojnë se vetëdija e tyre e të qenit gjallë nuk është gjë tjetër veçse një iluzion i mendjes. E pra, ajo që e përcakton qenien gjallë nuk është mendja, por zemra. Dhe jo çdo zemër, por vetëm ajo që është e mbushur me besim ndaj Allahut. Nëse një zemër është e zhveshur nga besimi në Allahun, ajo është e vdekur. Dhe, nëse një zemër njerëzore është

e vdekur, atëherë njeriu s'është hiç më shumë se hija e atij që duhej të ishte. Në këtë rast, njeriu nuk gjallon, por thjesht ekziston. Në këtë rast mund të thuhet se ai pothuajse nuk ka lindur fare!

Besimi në Allahun e Madhëruar është e vetmja mënyrë për të pohuar se jemi gjallë. Besimi në Allahun është lindja jonë e vërtetë, është udha e mrekullueshme e gjallnisë së përjetshme që shpaloset para nesh, është shfaqja më e bukur e ngjyrave, e tingujve dhe e bukurive hyjnore, është begatia më e madhe me të cilën Zoti mbush zemrat tona. Kur në zemër shfaqet besimi, marrin arratinë frika, arroganca, injoranca, ligësia, e sa e sa vese të tjera dhe në vend të tyre shfaqen dashuria, mirësia, dhembshuria, bujaria, bukuria, shfaqet prania e mrekullueshme e Zotit.

### **NJË PIKË UJI NË OQEANIN E NJËSISË SË ALLAHUT**

Në një vështrim të parë, njeriu është një pikë e vogël uji. Ai e fillon ekzistencën duke u ngjizur nga një pikë uji, por edhe mbetet përnjëmend një pikë uji, nëse e krahasojmë me oqeanin e pafundëm të Njesisë së Allahut. Nëse qëndron e shkëputur, ajo mbetet diçka e vogël, e papërfillshme, e pavlerë, duke të kujtuar vazhdimisht një pikël vese që avullon çilembyll sytë nën rrezet e para të agimit. Një pikël uji është diçka, por një diçka e vogël dhe pa ndonjë vlerë të konsiderueshme. Njeriu është diçka, por ç'vlerë ka kjo diçka, nëse nuk i bashkohet tërësisë për t'u shndërruar në gjithçka? Me përkushtimin e lartë shpirtëror, me besimin e thellë në Allahun, me asgjësimin e egos, e cila e mban të shkëputur e të veçuar duke e katandisur në diçka të vogël, me zgjimin e vetëdijes hyjnore, me rizgjimin e kujtesës shpirtërore të origjinës, kjo pikël e vogël uji përfshihet e tretet në oqeanin e pafundëm të njesisë së Allahut. Tashmë kjo pikël uji resht së qeni diçka e vogël dhe e pavlerë, madje resht së qeni diçka, për t'u bërë pjesë e madhësisë absolute. Pra, nëse mbetemi të veçuar e me ndjesinë se jemi diçka, kjo do të thotë se jemi thjesht të burgosurit e egos sonë. Por nëse shkrihemi në oqeanin e pafundëm të

besimit në Allahun, atëherë mund të themi se jemi përjetësisht të lirë.

### **JETA TOKËSORE PËRBALLË PËRJETËSISË**

Jeta e kësaj dynjaje është e shkurtër dhe e shpejtë si rrahja e krahëve të një fluturë. Përballë frymëmarrjes së përjetësisë, kjo jetë tokësore nuk zgjat as dhe një sekondë. Kjo jetë e shkurtër e kësaj bote nuk ka rëndësi në vetvete, por ka rëndësi në përgatitjen e njeriut për udhëtimin e pandalshëm të përjetësisë dhe të shkrirjes në njësinë e Allahut. Kjo jetë është provimi që secili prej nesh duhet të kalojë, për të shtyrë portën e përjetësisë e për të përqafuar mrekullinë e pasosur të hyjnitetit e të begative të Zotit. Allahu na e ka thënë këtë nëpërmjet librit, por po aq përsosmërisht na e ka përcjellë nëpërmjet mënyrës se si jetoi në këtë botë Pejgamberi i Tij më i lartë i dërguar ndonjëherë në këtë botë, profeti Muhamed (a.s.). Nëse ato që thuhet në Kuranin famëlartë kanë marrë ndonjëherë një formë të gjallë në mënyrë të plotë dhe janë trupëzuar tërësisht në një personalitet njerëzor, ky personalitet është pa asnjë dyshim profeti Muhamed (a.s.). Pra, ky zotëri i lartë është Libri i shndërruar në njeri. Ai jetoi në këtë botë, por nuk jetoi për këtë botë. Florudha e udhëtimit të tij e kapërcen ku e ku jetën tokësore dhe shkon në përjetësi.

Ai nuk erdhi për të jetuar në këtë botë, nuk erdhi për ta shijuar këtë botë, nuk erdhi për t'u lidhur pas kësaj bote, por erdhi thjesht për të na mësuar si jetohet dhe për të na kujtuar se jeta e kësaj bote është veçse një hije e zbehtë e botës së vërtetë, se jeta e kësaj bote është vetëm një tingull i vetëm përballë simfonisë së jashtëzakonshme të përjetësisë. Dhe të gjitha këto i bëri duke u hedhur përtej kuptimit të rëndomtë të fjalëve. Ai nuk tha fjalë, por u shndërrua në Fjalën. Dhe Fjala e tij ishte gjest, dhe Fjala e tij ishte vepër, dhe Fjala e tij ishte një mënyrë e përkryer të jetuari, e cila do të mbetet shembull i gjallë për njerëzit në të gjitha kohët, përtej kohëve, në jetë të jetëve.





# Tri këshilla

Një ditë një njeri kapi një zog. Zogu i tha; “Unë nuk të duhem ty asgjë, përse kohë që jam i burgosur. Liromë e do të të jap tri këshilla të çmuara”.

Zogu premtoi t’ia jepte këshillën e parë teksa ishte ende në duart e njeriut, të dytën kur do të mbërrinte në degën e një peme, ndërsa të tretën kur do të qe i lirë të ngjitej lart në majën e një mali. Njeriu pranoi dhe kërkoi këshillën e parë.

- Nëse humbet diçka, - tha zogu, mos e vajto më edhe nëse mund ta dëshirosh sa jetën tënde.

Njeriu e lëshoi zogun dhe ky fluturoi për të qendruar në degën e një peme.

- Mos u beso kurrë gjërave që bien në kundërshtim me të kuptuarit normal, pa kërkuar më parë prova - tha zogu duke ofruar kështu këshillën e dytë.

Mandej zogu fluturoi në majë të malit, prej ku thërriti: Oh, fatkeq! Brenda trupit tim gjenden dy smeraldë gjigandë. Sikur thjesht të më kishe vrarë, tashmë ata do ishin tuat!

Njeriun e bëri të vuajë mendimi i asaj që paskej humbur dhe i tha zogut: Ma jep së paku këshillën e tretë!

- Je me të vërtetë idiot!, - iu përgjigj zogu. Vazhdon të rrish ende këtu duke më kërkuar këshilla, kur nuk mendove as dhe për një çast për dy të parat! Të thashë që të mos vuash për humbjen e diçkaje e të mos besosh në gjëra që bien në kundërshtim me të kuptuarit normal. Dhe është pikërisht kjo, ajo çfarë po bën në këto çaste! Po fillon të besosh në absurditete qesharake dhe po vuan prej se paske humbur diçka! Po a nuk e shikon se nuk jam aq i madh sa për të patur brenda vetes dy smeraldë gjigandë? Je fare budalla! Për këtë arsye do vijosh të mbetesh i robëruar brenda kufinjve të zakonshëm që i janë vënë çdo njeriu.

Nga: Kuvendi i zogjve

## Zoti të pret të pendobesh, kurse ti refuzon?!

Çfarëdo të ketë bërë njeriu, sado të mëdha të jenë gjynahet, sado të rënda të jenë veprat e liga që ka kryer, nëse ai pendohet dhe kërkon falje prej Zotit, Ai e pranon dhe e fal. Allahu (xh.sh.), thotë: **“O robërit e Mi, që e keni ngarkuar veten me shumë gjynahe, mos e këpusni shpresën nga mëshira e Allahut. Ai i fal të gjitha gjynahet, sepse është Falës dhe Mëshirues.”** (Zumer, 53.)

Sahabët e Pejgamberit (a.s.), kanë thënë: “I dërguari i Allahut (a.s.), nuk është gëzuar me asnjë ajet tjetër, sa është gëzuar kur iu shpall ky ajet.”

Ky ajet është shumë shpresëdhënës dhe shërbën si fasha dhe ilaçi për shërimin e plagës. Ky na mëson se, sado të ketë gjynahe, sado i mbytur në gjynahe qoftë, sido të ketë humbur..., nëse i drejtohet Allahut dhe i thotë: “O Zot, pendohem!”, Ai e pranon dhe e fal njeriun.

Shpresëdhënës për këtë fakt janë vetë fjalët: “O robërit e Mi...!”, megjithëse mund t’u drejtohej me fjalët: “O gjynahqarë!”. Shpresëdhënës janë edhe fjalët: “...Që e keni ngarkuar veten me shumë gjynahe.” Ai nuk i përmend gjynahet që kanë bërë... dhe këtë e bën me qëllim që të mos prekë ndjenjat e askujt.

Çdo kompani dhe institucion ka rregullat dhe normat e tij. Nëse dikush bën diçka në kundër-

shtim me normat dhe rregulloren, fillimisht i tërhiqet vërejtja, paralajmërohet me largim nga puna dhe, nëse vazhdon, atëherë largohet nga puna. Ndërsa Allahu (xh.sh.), nuk largon askënd. Nuk ka gjë që të mban larg mëshirës së Zotit, pasi një nga cilësitë dhe emrat e Tij është emri Et-Tevvab (Pranues i pendimit).

Vetëm në suren Et-Tevbe pendimi përmendet 17 herë.

Pejgamberi (a.s.), ka thënë: “Allahu gëzohet për pendimin e robit të Tij më shumë se sa gëzohet njeriu në mes të shkretëtirës që gjen devenë e humbur, në të cilën ka ushqimin e tij”. **(Buhari, Muslimi)**. Pejgamberi (a.s.), thotë:

“Çdo bir i Ademit është gabues, por më i miri prej tyre është ai i cili pendohet.” **(Tirmidhi, Ibn Maxhe, Ahmedi, Hakimi, Albani e ka bërë hadithin sahih)**.

Pendimi ka tre kushte:

1. Të pendohesh dhe të bëhesh pishman për ato që ke bërë.
2. Të largohesh nga ato gjynahe, të cilat i ke kryer më parë.
3. Të jesh i vendosur që nuk do t’i bësh më gjynahet e mëparshme.

Në kohën e Musait (a.s.), ndodhi një thatësi e





*“O robërit e Mi, që e keni ngarkuar veten me shumë gjynahet,  
mos e këpusni shpresën nga mëshira e Allahut. Ai i fal të gjitha gjynahet,  
sepse është Falës dhe Mëshirues.”*

*- Zumer, 53 -*

madhe që nuk ishte përjetuar më parë. Populli i Musait (a.s.), u mbledh një ditë. Njerëzit shkuan te Musai (a.s.) dhe i thanë: “O Musa, lute Zotin që të lëshojë shi nga qielli, pasi mund të vdesim”. Atëherë Musai (a.s.), e mbledhi popullin dhe filloi të lutej, ndërsa populli thoshte Amin, pas çdo lutjeje. Megjithatë shiu nuk binte. Atëherë Musai (a.s.), u drejtua nga Allahu (xh.sh.) dhe tha: “O Zot, përse nuk po na lëshon shi, megjithëse të lutemi?” Zoti i thotë: “O Musa, nuk do të bjerë shi, pasi në mesin tuaj është një njeri, i cili ka dyzet vite që bën gjynahe, pa iu skuqur faqja një herë prej Meje. Nuk do të bjerë shi, derisa ai të dalë nga mesi juaj. Atëherë Musai i mbledhi të gjithë njerëzit dhe u tha: “Nuk do të bjerë shi, derisa të largohet prej nesh ai që ka dyzet vite që bën gjynahe”

Personi që kishte 40 vjet që bënte gjynahe, shikoi njëherë majtas dhe djathtas se mos dilte dikush tjetër, por, kur pa që nuk lëvizi kush, e kuptoi që flitej për të. Në ato çaste të vështira, filloi të thoshte me vete: “O Zot, ka dyzet vite që nuk të bindem e kam vazhduar me gjynahe dhe Ti m’i ke mbuluar ato për të mos e marrë vesh asnjë njeri. O Zot, po të dal tani do të dal i poshtëruar dhe, nëse nuk dal, do të vdesim nga

etja. O Zot, unë në këto momente pendohem për ato që kam vepruar, prandaj më fal dhe m’i mbulo të metat”. Në atë çast filloi të binte shi. Musai i habitur, e pyeti Zotin (xh.sh.): “O Zot, si ka mundësi që po bie shi, megjithëse nuk doli kush?” “O Musa, - ia ktheu Zoti, - robi im që bëri gjynahe për dyzet vite, u pendua me sinqeritet në ato çaste dhe Unë ia pranova pendimin, prandaj filloi të bjerë shiu”. Musai (a.s.), iu lut: “O Zot, të lutem ma trego, kush është ai njeri!” Por Zoti ia ktheu: “O Musa, ka dyzet vite që bën gjynahe dhe Unë ia kam mbuluar ato, kurse tani që u pendua dhe i la gjynahet, unë ta zbuloj dhe ta poshtëroj para njerëzve?”

Allahu (xh.sh.), thotë: **“A nuk e dinë se Allahu e pranon pendimin e robërve të Tij.”** (Tevbe, 104.)

Kërkesa për pendim në ajetet e Kuranit nuk u adresohet vetëm gjynahqarëve, atyre që kanë shkëputur çdo lidhje me Zotin, atyre që hezitojnë..., por u drejtohet të gjithë njerëzve, të mirë dhe të këqij, me besim të dobët dhe me besim të fortë. Rreth kësaj, Allahu (xh.sh.), thotë në Kuran: **“Pendohuni tek Allahu, o besimtarë, sepse vetëm kështu do të shpëtoni.”** (Nur: 31.)

# *Tefsiri i Sure-i Asrit*

Kjo sure asht ma e shkurta e sureve të Kurani Qerimit, përmban tre Ajete. Mbas fjalës të lbni Abasit (qofshin të ndjerë) fjala asër asht koha qi ndër ate rjedhin lëvizjet e punimet e njerzis, arabisht i thuhet edhe Dehër. Kuptimet e fjalës Asër janë kto: (1) Koha e njoftime qi falet iqindija (Zëmra). Arabët e kishin zakon si e çkrihin punën dhe si ngëheshin në kohë të Zëmrës mblidheshin (si katunarët e Shqipnis) edhe fjalosshin e bisedofshin, punët e tyne vetjake. Porsi asht e ndiçme se disa herë qëllonte e behëshin fjalë të pa pëlqyme e ngjarje të mëzirçme. Pra këtë kohë e qukshin si një kohë prapësire. Nga ky shkak Zoti betohet për mbi nderin e kësaj kohë që, o njeri ta març vesh se vet koha, as shahet as qertohet, dmth kjo kohë a kjo ditë asht e lumtur dhe bekime edhe kjo kohë a kjo ditë asht e prapë dhe e mallkime të mos thush Goja nuk duhet me u stërvit me e fol kësi soj se në kohnat si punohet pun'e mirë ashtu punohet edhe pun'e keqe. Ahere s'duhet të shahen kohnat por duhen me u sha e me u qertu punët e punëtarve. Se si u tha sipër kohnat janë enë (Zarf) për punët të Zotit, ndër të cilat krijon 'ushqen' disa i nderon 'disa i poshtëron e disa i ngren e disa i rëzon, po nd'ato kohë. Prandaj s'asht e drejtë me u sha koha. Zoti me madhnin e vet n'ajetin e parë të ksajë Suresë urdhnon: (Vel.....) për kohën të pa çume a për kohën e Zëmrës betohem (qi ju po e qertoni).

Në Ajetin e dytë urdhnon: (inne....) pa dyshim gjithë njerëzit me të vërtet janë ndë një damë të math dmth e kan hupë veten e tyne përjetë. Sicilit q'i thuhet njeri edhe asht me ment në krye nga punët e vet gjindet ndë një dam të math e të përherhim. Përjashtonen vetëm ata njerës qi përjashton i madhi Zot n'ajetin qi vjen ma poshtë. Punët e njeriut, po ato vetë kanë ndjelle ligsit e prapësit e jo koha e vendi.

Në gjuhët arabishte fjala gjithë edhe tanë miret prej fjalës (qyl) a (el). Mënyr e përdorimit të këtyne çquhet prej ylemas. N'Ajetin e tretë urdhnon Zoti (illa.....) vetëm ata njerës s'kan ra në dam të përjetçim të cillët kan besu Zotin edhe pejgamberin. D.m.th. nga dami i përjetçim për jashtohen vetëm ata qi i kan zan besë Zotit e pejgamberit edhe e dinë pa dyshim si për ata ashtu edhe për gjithë botën vetëm Zoti i vërtetë kënaqet, zemronet, për të mir për të keqe çpërblimi asht në dorë të tij. Kësi sojë njerës qi besojnë kështu veten e tyne e kan në dorë dhe punojnë ashtu si besojnë.

Besimi i tyne asht një iman i qindrushim jo i lëvisçim.

Për-sëri Zoti urdhënon: (ve ami.....) Mbesojnë edhe ashtu si besojnë me një besim të fortë e të patundcim punojnë punët e mira. D.m.th. ata qi besojnë Zotin e Pejgamberin me at besimin e saktë punojnë punë të pëlqyshme qe ju ka tregum Zoti në Kurani qerimi e u ka dëftum

i madhi peygamber. Punojnë asi punësh qi i bijen dobi si vetes të ti ashtu edhe fëmijës të vet dhe gjith kombit edhe gjith botës mbarë. Nuk punojnë asi punësh qi t'i vijë damë kujt a ti vijë damë fesë a se Atdheut por si e si përpiqen me e ndalum damin e ligsitë prej vëllaznevet tej e tej.

Urdhënon Zoti ma poshtë: (v te.....ve....te) Ata porositin njeri tjetrin me vërtetsi edhe me durim, d.m.th. përjashtohen ngaj dami i math dhe i përherçim ata qi besojnë e punojnë punë të mira si për veten e vet ashtu edhe për gjith botën edhe kurdoherë qi piqen me vëllaznët e tyne njeri tjetrin e porositin për mos me u da nga e vërteta, nga drejtësija dhe porosisin për me duru e me kry gjith punët e hajrit.

Zoti me madhsin e vet ketu përse e veçanëroj porosinë nga punët e mira vetëm të vërtetën edhe durimin?

Si kush qi i bazon punët e veta mbi vërtetsinë dhe mbi durimin aji i ka shti në dorë gjith punët e hajrit edhe ashtu i largon nga gjithë punët e kqija. Kjo gja asht ajo e vërtetë e patundshme qi e kan pat gjith fet e gjithë Sheriatnat. Pra nga ky shkak Zoti i vërtetë për me e shpëtum njerin nga nji dami i tillë vuui shart besimin e vërtetë, punimin e pëlqyshim edhe porsinat me vërtetsi e me durim qi me anën e ktyne katër sendeve bota do ta dinë se c'asht e vërteta dhe asi soj të qindrojnë në vërtesie.

Bota nga hajalatet (nga andrat) duhen zgjum se andrat s'i pranon akli as naksi d.m.th. kush

i thot vetes njeri duhet me punu si i ka urdhnun Zoti r Pejgaber, jo me të sajume.

### PËRFUNDIMI

Kan qenë dy shokë nga sahatet qi kurdoherë qi piqshin njeni me tjetrin deri mos i a këndonin njeni tjetrit kët Sure nuk ndahshin.

Imam Shafuja thotë: Prej Kurani-qerimit të mos kish zbrit tjetër Sure vetëm kjo mjaftonte si për dynja ashtu edhe për Ahiret.

Pra ta shkurtojme me kto fjalë! Oti! Qi i thu vetes njeri! A e beson Zotin e Pejgamberin?

A e ke besum kuranin e Zotit? Ahere puno si ke besum puno si të urdhnnon Kurani ! bëju mirë gjith botës, puno me e shpëtu fenë edhe atdhen. Me cillin do qit ë piqesh mos hiq dorë nga tevasija (Porosija) për të drejtë e për durim d.m.th. mos ki frikë prej kujt, pos si veten ashtu edhe gjith botën e porosit qit ë mos ndahenë nga e vërteta e nga durimi se popogandat qi bannen jashtë këtyne ato e renojnë krejt fenë edhe atdhen. U-murr vesh qi mysliman i vërtetë qhet kush i ka kto katër

sofate: (1) Iman II Ameli-Salih III Tevasi bilhak IV Tevasi bissabër, e kush s'i ka s'asht.

Zoti na çiltë sytë e mos baft kush (tevasi) propaganda jashtë të vërtetesë për me e renu fenë e Atdhenë.

**AMIN!**

**A. J.**

*Marrë nga revista Zani i Naltë  
Nr. 2, Nantuer, Vit' i I.*



# Shkenca dhe Islami

Në historinë e mendimit islam, nuk ka pasur ndonjë përplasje serioze shkencë-fe. Kjo nuk është e vështirë të kuptohet, pasi pikësëpari qëndrimi i Kuranit ndaj shkencës është mjaft pozitiv. Nuk mund të thuhet e njëjta gjë edhe për burimet e feve të tjera. **Richard Robinson**, i cili është një studiues i ungjijve të **Markut, Mateos dhe Lukës**, thotë: *“Jezusi, jo vetëm që nuk këshilloi për dije, por as arsyen si një virtut që na shpie për në dije, kurrë nuk e ka rekomanduar për ta vënë në përdorim... Jezusi gjithnjë na këshillon të besojmë. Dhe me besimin ka ndërmend të besuarit pa iu referuar asnjë burimi, asnjë argumentimi, të besuarit në gjërat e pamundshme.”* (An Atheist's Value, fq. 149.) Cituam **Robinsonin** këtu, jo për të analizuar pohimin e tij se sa i drejtë është, por për të treguar se një qasje e tillë nuk i është adresuar ndonjëherë Kuranit, as nga autorët e Lindjes e as nga ata të Perëndimit.

Sipas Kuranit, Gjithësia si e tërë është vepër e Krijuesit të Ditur, Fuqiplotë, Dhurues dhe Mëshirues. Një teori e tillë sjell me vete edhe këto tri silogjizma:

a. Meqë Gjithësia është krijuar, atëherë ajo nuk është e domosdoshme (*vaxhib*), por është e mundshme (*mumkin*). Metoda që ndiqet për të njohur të mundshmen, është një veprim empirik dhe jo *a priori*. Metoda që Kurani nxit për të arritur dijen është ajo empirike, pra rruga induktive.

b. Meqë Gjithësia ekziston në sajë të një Krijuesi Fuqiplotë, atëherë është e pashmangshme ekzistenca e një qëllimi dhe sistemi. Akti i krijimit nuk detyron kaosin, por kozmosin, pasi, sipas Kuranit, asgjë nuk ekziston fillikot. Gjithçka është vepër e Tij, e madhëron (*tesbih*) Atë dhe është argument në vetvete për ekzistencën e Tij. Mjeshtri i këtij rregulli dhe sistemimi në Botë është vetë Allahu. Asnjë fuqi nuk mund të bëjë të kundërtën e saj.

c. Meqë Gjithësia është e krijuar, atëherë asgjë

që është brenda saj nuk ka fuqi hyjnore. Andaj, asgjë nuk meriton lutje apo adhurim. Pra, Gjithësia ekziston për t'u analizuar, për t'u studiuar dhe në shërbim të njeriut, jo për t'u adhuruar.

Kurani e drejton njeriun që të *shikojë* veten, rrethin e tij shoqëror dhe ato çfarë i ndodhin përreth. Pastaj të *reflektojë* mbi to dhe, pasi të ketë kuptuar domethënien e tyre, të përpiqet t'i japë jetë vetë ai.

Ndikimi që bën Kurani me një qëndrim të tillë, ka bërë që shkenca dhe filozofia të nisin që në kohët e para në botën islame, madje në një mënyrë të furishme. Një shkrimtar perëndimor ka të drejtë, kur thotë:

*“Në çdo ndryshim të mendimit në Perëndim është e mundur të vërehen gjurmët e dukshme të historisë islame. Por ky ndikim shihet edhe më qartazi, vaçanërisht në mentalitetin akademik dhe të shkencave natyrore, të cilat përbëjnë burimin e triumfit, pushtetit dhe të kualitetit të botës moderne.”* (R. Briffault, “The Making of Humanity”, fq. 190.)

Ndërsa **Volteri**, mendimtari i famshëm francez thotë:

*“Pas rënies së Perandorisë Romake, gjatë periudhës së injorancës dhe barbarisë, të krishterët mësuan nga myslimanët: astronominë, kiminë, mjekësinë, shkencat e matematikës dhe gjithçka tjetër.”* (“Islam ez Nazari Voltaire”, fq. 87.)

Filozofi i shquar britanik, **Bertrand Russel**, pasi bën sqarime të zgjatura rreth shkencëtarëve dhe filozofëve myslimanë, shton këtë:

*“Myslimanët u bënë shkak që perëndimorët të shpëtojnë nga jeta primitive dhe shtazore.”* (“Një Histori e Filozofisë Perëndimore”, II, fq. 213.)

Dakord, Kurani mban një qëndrim të hapur pozitiv ndaj dijes, andaj dhe shkenca në botën islame

kaloi një zhvillim marramendës, për një qark kohor relativisht të shkurtër. Mirëpo, vërtet a nuk e ka pasur ndonjëherë shkenca kokën ngusht në Islam? Para se t'i kthejmë përgjigje kësaj, duhet të bëjmë një sqarim të nevojshëm. Duhet bërë një dallim mes raportit fe-shkencë dhe mes raportit shkencëtar -dijetar (fetar). Për shkak të monoteizmit kuranor që karakterizon fenë islame, autoritetet myslimane nuk kanë formuar një klasë klerikale. Mendimi i një dijetari, sipas fesë islame, nuk do të thotë se domosdoshmërisht është mendim i saktë e as që përfaqëson fenë islame detyrimisht, sikurse ndodh në fenë e krishterë, që mendimi i Kishës është automatikisht vendimi i Krishtërit.

Tani le t'i kthehemi përgjigjes së pyetjes së mësipërme. Në historinë islame, ashtu sikur e cekëm dhe më sipër, nuk mund të themi se bëhet fjalë për një përplasje serioze mes fesë dhe shkencës. Por kjo nuk do të thotë se disa shkencëtarë nuk janë përballur me vështirësi të ndryshme. Duhet nënvizuar se shkaku i kësaj përballjeje nuk është feja, por të kuptuarit e fesë.

Shumë nga dijetarët (fetarë) të botës islame, e kanë trajtuar në veprat e tyre këtë çështje dhe kanë treguar se çfarë problemesh mund të sjellë keqkuptimi apo keqcitimi i burimeve themelore fetare. **Ibn Tejmijje**, një nga figurat më radikale të mundshme të botës islame dhe një nga mendimtarët më produktivë, me veprën volumoze me titull "*Der'u tearudil-akli ven-nakli*", ka për qëllim të hedhë pikërisht këtë tezë, që burimet themelore islame, ndërkohë që nuk keqcitohen apo keqkuptohen, është e pamundur që të jenë kundër logjikës së shëndoshë apo shkencës. Një tjetër mendimtar i rëndësishëm i gjysmës së parë të shekullit të kaluar, **Abdul-latif Efendi nga Harputi**, shprehet kështu:

Myslimanët e parë i kuptuan disa ajete të Kuranit nën rrezën e dijes së kohës së tyre. Disa prej tyre ishin të hapur për çdo dije. Ndërkaq, njohuritë që sollën të krishterët apo hebrenjtë e konvertuar në islam, filluan të hynin në tekstet fetare. Kjo vazhdoi gjersa këto njohuri u bënë pjesë e pandarë e literaturës islame. Ja njëri nga shkaqet se përse ndodhin debatet mes fesë dhe shkencës!

Shkaku i dytë është se disa dijetarë myslimanë

ngatërronin "*shpjegimet fetare*" me "*shpjegimet shkencore*". Fjala vjen, kur Kurani flet për tokën, e përmend atë si një "*dyshek i zgjatur*". Qiellin e krahason me një "*tavan pa shtylla*". Qëllimi kryesor i këtyre ajeteve është për të orientuar njeriun se Allahu është Krijuesi i tyre dhe, duke i bërë të reflektojnë, i drejton ata për në besim. Këta dijetarë i shmangen kuptimit parësor të këtyre ajeteve dhe arrijnë në përfundime të gabuara duke u nisur nga fjalët "*dyshek*", "*shtruar*", "*zgjeruar*", "*tavan*" etj., duke thënë se "*botë përbëhet nga një tavan prej qielli dhe një shtresë e sheshtë dhe e drejtë*". Dhe ky gabim bëhet në emër të "*shpjegimeve shkencore*". Ja pra, kjo lloj metode i ka bërë që të gabojnë dijetarët myslimanë. (Shih. Abdul-latif el-Harputi, "*Tenkihul-Kelam*", fq. 445.)

**Harputi** dhe disa mendimtarë të tjerë të kohës së tij, me këtë tezë nuk donin të arrinin në përfundimin se thjesht terminologjia fetare është simbolike. Përkundrazi, ata janë përpjekur të thonë këtë:

Ne nuk mund të mjaftohemi me qasjen racionaliste që ka apologetika dhe me rezultatet relative si pasojë e procesit në evolucion që ka shkenca dhe të kuptojmë ajetet kuranore përmes tyre, duke iu shmangur objektivitetit dhe natyrës "*ekzistenciale*" dhe "*besimore*" që ka Fjala e Zotit. Kurani merr parasysh përvojën njerëzore në tërësi. Kur thuhet se "**Allahu është krijuesi i gjithçkaje**", në këtë rast, kjo formulë ka karakter metaforik, por njëkohësisht tërheq vëmendjen ndaj nesh që të jemi të vetëdijshëm dhe përgjegjës në jetë duke iu referuar asaj.

Dijetarët e kualifikuar myslimanë nuk i kanë "ndeshur" *shpjegimet shkencore* me Fjalën e Kuranit. Sipas tyre, Kurani jo vetëm që nuk ka penguar shkencën dhe mendimin, por e ka bërë obligim angazhimin me shkencë dhe të menduarit. Në një farë mënyre, mund të themi se, nga aspekti metodologjik Kurani ka luajtur një rol si referencë dhe frymëzim për shkencëtarët dhe filozofët myslimanë.



# DISPOZITAT E AGJËRIMIT

Me fjalën agjërim në aspektin etimologjik kuptohet abstenimi, largimi, të përmbajturit në kryerjen e diçkaje, ndërsa në terminologjinë e jurisprudencës islame me këtë shprehje nënkuptohet: "*Largimi-abstenimi nga e gjithë ajo që e prish atë (si f.v. ushqimi, pijet, marrëdhëniet intime bashkëshortore e të ngjashme me këto) në kohën para lindjes së diellit e deri në perëndim të tij.*"

Ky lloj ibadeti është i mbështetur në Kuran, Sunnet dhe Ixhma (vendim kompakt i dijetarëve islamë). Në kaptinën el-Bekare, Allahu (xh.sh.), thotë: "**O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim siç ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm.**"

**"E kush e përjeton prej jush këtë muaj, le të agjërojë..."**

Po ashtu, Pejgamberi (a.s.), ka thënë: "**Islami mbështetet mbi pesë shtylla: shehadeti- dëshmi me të cilën dëshmojmë se nuk ka zot tjetër përveç Allahut, falja e namazit, dhënia e zekatit, agjërimi i muajit të Ramazanit dhe Haxhi.**"

Obligueshmëria e agjërimin është vërtetuar edhe me ixhma. Myslimanët në përgjithësi, kudo që janë në botë, janë të një mendimi se agjërimi është një prej shtyllave të islamit dhe se ai që mohon obligueshmërinë e agjërimin të ramazanit konsiderohet i dalë prej besimit.

Ky lloj ibadeti është bërë obligim në vitin e dytë të hixhrit.

## KUSHTET E VLEFSHMËRISË SË AGJËRIMIT

Agjërimi përbëhet prej këtyre kushteve:

1. Nijeti (qëllimi). Nijeti nuk është kusht që të shqiptohet me gjuhë, ai është i vlefshëm edhe nëse kryhet vetëm me zemër.
2. Largimi nga të gjitha ato gjëra që e prishin agjërimin që nga agimi e deri pas perëndimit të diellit.
3. Femra të mos jetë në kohën e hajzit (menstruacioneve) dhe nifasit (koha pas lindjes).

## KUSHTET E AGJËRUESIT

Agjëruesi duhet të plotësojë këto kushte:

1. **Të jetë mysliman.** Ai, i cili nuk është mysliman nuk obligohet me këtë ibadet, sepse një njeri i tillë nuk ka besim në Allahun (xh.sh.).
2. **Të jetë i mençur.** Personi, i cili është i aftë mendërisht e ka për obligim zbatimin e këtij ibadeti, ndërsa ai që është i çmendur nuk obligohet për të agjëruar.
3. **Të ketë hyrë në moshë madhore.** Personi që e ka detyrim të agjërojë duhet të ketë hyrë në moshën madhore, gjë që nënkupton se mashkulli hyn në moshën madhore qysh në kohën kur i paraqitet polucionit, ndërsa femra hyn në moshën madhore kur i paraqiten menstruacionet.

Nëse ndodh që fëmija të agjërojë ende pa hyrë në moshën madhore, atij i lejohet të agjërojë, gjë për të cilën do të ketë shpërblimin e Allahut (xh.sh.).

## SUNETET E AGJËRIMIT

1. **Të zgjuarit në syfy.** Të zgjuarit për të ngrënë konsiderohet si një prej suneteve të agjërimit, duke u bazuar në fjalët e Pejgamberit (s.a.v.s.):

*"Ngrihuni në syfy, sepse syfyri është bereqet. Hani syfy qoftë edhe gjysëm hurme".* (Muslimi).

2. **Nxitimi për të bërë yftar.** Sapo të mbërrijë koha e yftarit, agjërimi duhet prishur, qoftë edhe me një gotë ujë. Është e këshilluar (mustehab) që çdo agjërues të nxitohet në kryerjen e yftarit, sapo të ketë ardhur koha e tij. Në lidhje me këtë, Pejgamberi (s.a.v.s.) ka thënë:

*"Njerëzit janë vazhdimisht në të mira perderisa nxitohen në të bërit yftar".<sup>1</sup>*

3. **Të bërit dua në kohën e yftarit.** Lutja e preferuar me rastin e yftarit është:

*"O Zoti im, në emër Tënd kam agjëruar, në ty besoj, dhe yftar bëj me atë që Ti më dhurove, shkoi etja, u mbushën damarët dhe u arrit shpërblimi nëse Allahu do".*

4. **Falja e namazit të teravive.**

5. **Dhënia sa më shumë e sadakasë (lëmoshës).**

6. **Bërja sa më shumë e ibadetit, sidomos në dhjetë ditët e fundit të ramazanit.**

7. **Dhënia yftar atyre që janë duke agjëruar, qoftë një hurmë ose së paku ujë.**

## ADABET E AGJËRIMIT

1. Që agjëruesi ta rikujtojë sa më shumë faktin se është duke agjëruar.

2. Që agjëruesi të durojë gjatë agjërimit e të mos ankojë duke thënë që nuk po mundet të agjërojë. Po ashtu, duhet t'u shmangët përdorimit të shprehjeve, që thonë se agjërimi qenka i vështirë e gjëra të ngjashme me këto.

3. Të mos kryejë punë të vështira, të cilat nuk janë të domosdoshme të kryhen.

4. Të jetë sa ma bujar gjatë muajit të agjërimit.

## PERSONAT TË CILËT LIROHEN NGA AGJËRIMI

*Këta persona janë:*

1. **I sëmuri.** Që i sëmuri të jetë i lirë nga obligueshmëria e agjërimit, ai duhet të jetë i sëmurë në atë masë sa që të parashikohet se agjërimi do t'ia përkeqësonte gjendjen, që nga shkakut i agjërimit do mund t'i ngadalësohej procesi i shërimit, ose që do të mund të ndjente dhimbje të mëdha. Nëse ndodh që dikush është i prekur nga ndonjë sëmundje mbi të cilën agjërimi nuk ndikon negativisht, atëherë ky njeri duhet të agjërojë. Sa u takon ditëve në të cilat nuk ka agjëruar, i sëmuri mund t'i zëvendësojë në ditë të tjera (kaza).

2. **Udhëtari.** Allahu (xh.sh.) ka lejuar që udhëtari të mos agjërojë, si lehtësim ndaj tij. Udhëtarit i lejohet të mos agjërojë prej momentit kur ai konsiderohet se është udhëtar, mirëpo nëse ndodh që të udhëtojë brenda ditës

1. Buhariu dhe Muslimi.

duke qenë në agjërime, ai duhet të vazhdojë të agjërojë, sepse nuk ka të drejtë ta prishë agjërimit e asaj dite. Gjithsesi, për udhëtarin është më mirë të agjërojë nëse është i fuqishëm dhe nuk pëson ndonjë dëm, pavarësisht se ka të drejtë të mos agjërojë. Udhëtari duhet t'i kompensojë ditët e paagjëruar me ditë të tjera.

3. **Shtatëzëna dhe gjidhënësja.** Nëse gruaja shtatëzëna ka frikë se mund të pësojë dëm ajo vetë apo fëmija i saj, i lejohet të mos agjërojë. Po ashtu, nëse gjidhënësja frikësohet se për shkak të agjërimit nuk do të ketë më qumësht për të ushqyer fëmijën, i lejohet të mos agjërojë. Shtatëzëna dhe gjidhënësja duhet të kompensojë ditët e paagjëruara një ditë për një ditë.

4. **Uria dhe etja e madhe.** Një personi që ka uri apo etje aq të madhe, sa mund të sëmuret, i lejohet të mos agjërojë. Ai që e prish agjërimit për shkak të urisë së madhe apo etjes së madhe, duhet t'i kompensojë ditët në të cilat nuk ka agjëruar.

5. **I detyruari me forcë për të prishur agjërimit.** Ai, të cilit i bëhet presion për të mos agjëruar, duke e kërcënuar me rrahje, eliminim e gjëra të ngjashme, i lejohet të mos agjërojë. Megjithatë, një person që gjendet në rrethana të tilla, duhet t'i kompensojë ditët e paagjëruara.

6. **Ushtari që është në betejë.** Nëse ushtari mendon se do mund të ndjejë molisje fizike kur të përballlet me armikun, atij i lejohet të mos agjërojë, por duhet t'i zëvendësojë në ditë të tjera, ditët në të cilat nuk ka agjëruar.

7. **I sëmuri që nuk ka shpresë për t'u shëruar.** Njeriu që vuan nga ndonjë sëmundje e pashërueshme si. f.v. sëmundjet kanceroze etj. lejohet të mos agjërojë, ndërsa për ditët e paagjëruara duhet të paguajë fidje (ushqim ditor).

8. **Plaku i moshuar, i cili është i dobët.** Kur arrin në një moshë aq të shtyrë sa që agjërimi i bën dëm dhe ia përkeqëson gjendjen shëndetësore, plakut i lejohet të mos agjërojë. Kompensimi i ditëve të paagjëruara është pagimi i fidjes (ushqim ditor).

## ÇFARË E PRISH AGJËRIMIN

Gjërat që e prishin agjërimit ndahen në dy grupe:

1. Gjëra që e prishin agjërimit e për të cilat duhet bërë *keffaret*<sup>2</sup> dhe *kaza*<sup>3</sup>.

2. Gjëra që e prishin agjërimit e për të cilat duhet bërë vetëm *kaza*.

## GJËRAT QË E PRISHIN AGJËRIMIN, E PËR TË CILAT DUHET BËRË KEFFARET DHE KAZA

Kur ndodh që agjëruesi i plotëson të gjitha kushtet e të qenurit i obliguar me agjërime dhe e prish agjërimit, atëherë ai është i detyruar të bëjë *keffaret* dhe *kaza* në

2. *Keffaret* është të liruarit e një robi, por nëse kjo mundësi nuk ekziston, atëherë duhet të agjërohen dy muaj pa ndërprerje, jashtë Ramazanit, duke pasur kujdes që të mos agjërohen ato ditë në të cilat është e ndaluar të agjërohet, e nëse edhe këtë gjë nuk mund ta bëjë, atëherë duhet të ushqejë 60 të varfër.

3. *Kaza* është të kompensuarit e një dite me një ditë tjetër.

këto dy raste:

**1. Të ngrënët, të pirët dhe të gëlltiturit me qëllim.** Ai, i cili ha, pi apo gëlltit diçka me qëllim, është i detyruar që si kompensim të bëjë *keffaret* (të agjërojë dy muaj pa ndërprerje) dhe *kaza* (një ditë për një ditë) që domethënë dy muaj e një ditë.

**2. Të kryerit marrëdhënie seksuale.** Në një rast të tillë, për të kompensuar, personi e ka si obligim të bëjë *keffaret* dhe *kaza*.

#### **GJËRAT QË PRISHIN AGJËRIMIN E PËR TË CILAT DUHET BËRË VETËM KAZA**

Këto gjërat janë:

**1. Të gëlltiturit e ndonjë sendi që nuk është ushqim.** Si p.sh.: të gëlltiturit e ndonjë monedhe, gozhde a gjëra të ngjashme. Një ditë e tillë duhet të kompensohet veç me një ditë, domethënë të bëhet vetëm *kaza*.

**2. Të ngrënët apo të pirët për shkak të presionit.** Për një ditë të këtyllë duhet bërë vetëm *kaza*.

**3. Të ngrënët apo të pirët pa dashje.**

Fjala vjen, nëse duke marrë abdest njeriu i shkon uji në fyt, apo në rastin kur nëna duke ia përtypur fëmijës ushqimin i kalon pa dashje diçka në fyt etj., për një ditë të tillë duhet bërë *kaza*.

**4. Të ngrënët apo të pirët, si diçka e domosdoshme.** Fjala vjen, nëse dikush është i sëmurë, apo është në udhëtim, arsye për të cilat nuk mund të qëndrojnë pa ngrënë dhe pa pirë, ditë të tilla duhen bërë *kaza*.

**5. Paraqitja e menstruacioneve brenda ditës.** Nëse femrës i vijnë menstruacionet brenda periudhës kur është duke agjëruar, ajo duhet ta prishë agjërimin, ndërsa ditët e paagjëruara i bën *kaza*.

**6. Ejakulimi me anë të masturbimit.**

**7. Të vjellët me qëllim.** Nëse dikush vjell qëllimisht, ai duhet ta kompensojë atë ditë duke e bërë *kaza*.

**8. Kur ndodh që agjëruesi bën ndonjë veprim, rast në të cilin ai mendon se e ka prishur agjërimin dhe ha ose pi.** Po qe se dikush vepron në këtë mënyrë, ai duhet të bëjë *kaza* atë ditë.

**9. Kush ha apo pi pasi ka hyrë koha e namazit të sabahut dhe është në dyshim nëse ka hyrë apo jo koha e namazit të sabahut.** Në këtë rast duhet bërë *kaza*.

**10. Kush ha apo pi duke menduar se ka perënduar dielli, por që në fakt nuk ka perënduar ende sado që mund të jetë krejt afër.**

#### **ÇFARË NUK E PRISH AGJËRIMIN**

Gjërat që nuk e prishin agjërimin janë:

**1. Ngrënia, pirja dhe marrëdhëniet intime për shkak të harresës.** Ai që ha, pi, etj. për shkak të harresës, por që me t'iu kujtuar agjërimi i ndërpret këto veprime dhe vazhdon agjërimin. Në lidhje me këtë rast kemi si argument fjalën e Pejgamberit (s.a.v.s.):

*"Kush ka harruar duke qenë agjërueshëm dhe ka ngrënë apo ka pirë, le ta vazhdojë agjërimin e tij, sepse është Allahu që ia ka dhënë mundësinë të hajë e të pijë".<sup>4</sup>*

**2. Ejakulimi në gjumë.** Nëse agjëruesi ejakulohet teksa është duke fjetur, agjërimi i tij nuk konsiderohet i prishur.

**3. Të qëndruarit i papastër.** Nëse gjatë ditës njeriu është i papastër, agjërimi i tij quhet i vlefshëm, ngase pastrimi nga *xhenabeti* nuk është kusht i agjërimin.

**4. Të gëlltiturit e ballgamit apo të qurrave, a gjëra të ngjashme.**

**5. Të gëlltiturit e tymit, pluhurit etj.**

**6. Futja e ujit në vesh gjatë notimit, pastrimit, ushtrimeve apo flladitjes.**

**7. Të vjellurit pa dashje.**

**8. Të futurit në fyt të ndonjë mize, mushkonje apo gjëra-ve të ngjashme me këto.**

**9. Marrja e injeksioneve muskulare-joushqyese.**

**10. Alivanosja.**

**11. Kontrolli gjinekologjik i femrës.** Edhe nëse gjatë kontrollit gjinekologjik të femrës përdoren mjete, agjërimi nuk prishet. Nëse i jepet ndonjë injeksion në brendësi të mitrës apo brenda në vaginë, agjërimi prishet dhe duhet të bëhet *kaza*.

#### **ÇFARË ËSHTË MEKRUH GJATË AGJËRIMIT**

**1. Të shijuarit e ushqimit duke mos pasur si qëllim shijimin e tij.** Nëse është e mundur që ushqimi të përgatitet pa u shijuar, atëherë është mirë të mos shijohet.

**2. Të mbajturit në gojë ndonjë gjë që nuk tretet.** Si p.sh.: copë druri, gozhde etj.

**3. Të mbledhurit e pështymës me qëllim gëlltitjen para njerëzve.** Kur ndodh që agjëruesi e mbledh pështymën për të fashitur terjen në fyt, nuk është mekruh, por të mbedhurit e saj me qëllim gëlltitjen para njerëzve konsiderohet *mekruh*.

**4. Kryerja e ndonjë veprimi që e dobëson agjëruenin.** Si fjala vjen pjesëmarrja në ndonjë lojë të rëndë etj.

**5. Puthja apo përkledhja që mund të shpie deri në**

4. Buhariu dhe Muslimi.



ejakulim.

## ÇFARË NUK ËSHTË MEKRUH GJATË AGJËRIMIT

1. **Notimi, pastrimi i trupit dhe të fladiturit me ujë.** Nëse ndodh që uji të hyn pa dashje në brendësi të stomakut, agjërimi nuk priset, por mbetet i plotë edhe më tutje. Transmetohet se Pejgamberi (s.a.v.s.) e ka lagur kokën me ujë kur ishte agjërueshëm, për shkak të etjes së madhe dhe nxitësisë së lartë.

2. **Përdorimi i misvakut dhe i brushës për pastrimin e dhëmbëve.**

3. **Shpërlarja e gojës dhe e hundës kur nuk jemi duke marrë abdest.**

4. **Parfumosja me erëra të këndshme.**

5. **Përtypja e ushqimit apo shijimi i qumshtit për fëmijën e vogël, duke treguar kujdes për të mos gjëllitur asgjë.**

6. **Puthja dhe përkledhja e lehtë, me kusht që të mos arrihet deri në ejakulim.** Transmetohet nga Aishja (r.a.), e cila ka thënë: "Vërtet Pejgamberi (a.s.), i ka puthur disa prej grave të tij kur ishte agjërueshëm".<sup>5</sup>

7. **Dhurimi i gjakut.** Agjëruesit i lejohet të dhurojë gjak, por në rast se një veprim i tillë ndikon në dobësimin e tij fizik, atëherë është mekruh. Kjo vlen edhe në rastin kur jepet gjak për analiza laboratorike.

## AGJËRIMI DHE LLOJET E TIJ

Agjërimi është disa llojesh:

1. **Agjërim farz** konsiderohet:

a. **agjërimi i muajit të Ramazanit,**

b. **agjërimi për të kompensuar ditët e paagjëruara gjatë ramazanit.**

c. **për ta realizuar betimin e bërë me agjërim.** Fjala vjen në rastin kur dikush betohet se, nëse arrin të kryejë ndonjë punë do të agjërojë. Në këtë rast ai e ka farz që t'i agjërojë ditët për të cilat është betuar.

ç. **për t'i kryer keffaretet, të cilat janë të obliguara të kryhen me agjërim.**

2. **Të agjëruarit vaxhib** është:

a. **Nëse dikush ka filluar të bëjë agjërim vullnetar dhe atë ditë e prish agjërimin me shkak ose pa shkak.** Ky person e ka vaxhib për ta bërë kaza atë ditë.

b. **Po qe se dikush ka bërë nijet që të izolohet në xhami (itikaf) disa ditë.** Për të bëhet vaxhib agjërimi gjatë ditëve në të cilat qëndron në xhami.

3. **Agjërimi sunet.** Të agjëruarit sunet është:

a. **Agjërimi i gjashtë ditëve të muajit Shevval.** Për këtë lloj agjërimi Pejgamberi (a.s.) ka thënë: "Kush agjëron muajin e Ramazanit e pastaj agjëron edhe gjashtë ditët e muajit të Shevval, konsiderohet se ka agjëruar gjithë kohën."<sup>6</sup>

5. Muslimi.

6. Muslimi dhe të tjerët.

b. **Agjërimi i tri ditëve në çdo muaj.** Është e preferuar që të agjërohet dita e trembëdhjetë, e katërbëdhjetë dhe e pesëmbëdhjetë e çdo muaji hënor. Në lidhje me këtë Pejgamberi (a.s.) ka thënë: "Agjërimi i tri ditëve në çdo muaj."<sup>7</sup>

c. **Agjërimi i ditëve të ashureve.** Rekomandohet që të agjërohet dita e nëntë dhe e dhjetë e muajit Muharrem, ndërsa agjërimi vetëm i ditës së dhjetë konsiderohet mekruh.

ç. **Agjërimi i ditës së hënë dhe të enjte.** Transmetohet nga Ebu Hurjera (r.a.) se Pejgamberi (a.s.), ka agjëruar ditën e hënë dhe të enjte.

d. **Agjërimi i pjesës më të madhe të muajit Sh'aban.** Aishja (r.a.) transmeton se Pejgamberi (a.s.), agjëronte aq shumë sa që ne thonim se nuk ka për ta ndërprerë kurrë, por nganjëherë nuk agjëronte, aq sa ne thonim se nuk ka për të agjëruar kurrë. Nuk e kam parë asnjëherë të agjërojë një muaj të tërë përveç Ramazanit. Po ashtu, përveç Ramazanit nuk e kam parë të agjëronte më tepër në ndonjë muaj se sa në muajin Sh'aban". (Buhariu dhe Muslimi).

e. **Agjërimi i dhjetë ditëve të para të muajit Dhyl Hixhhe.**

ë. **Agjërimi i ditës së Arafatit për atë që nuk ndodhet në kryerjen e haxhit.** Në lidhje me këtë Pejgamberi (s.a.v.s.) ka thënë: "Atij që agjëron në ditën e Arafatit, do t'i falën mëkatet."

4. **Agjërimi mekruh tahrimen (mekruh i rëndë)** është:

a. **Të agjëruarit e ditës së Fitër Bajramit e të ditës së Kurban Bajramit, si dhe të tri ditëve të tjera (ejjamu teshrik).**

b. **Çfarëdo lloj agjërimi që dëmton rëndë shëndetin e agjëruesit.**

5. **Mekruhi ternzihen** (mekruh i lehtë) konsiderohet agjërimi:

a. **Agjërimi i ditës së dyshimtë (jevmi shekk),** që është dita e fundit e muajit Sh'aban, për të cilën dyshohet nëse është e tridhjeta e këtij muaji apo dita e parë e Ramazanit.

b. **Agjërimi i dy ditëve** pa ndërprerje, pa ngrënë asgjë.

c. **Të veçuarit e agjërimet gjatë atyre ditëve që konsiderohen ditë feste në besimet e tjera,** si fjala vjen të agjëruarit vetëm në ditën e shtunë etj.

ç. **Të agjëruarit vetëm në ditën e xhuma.**

d. **Agjërimi i gruas pa pëlqimin e bashkëshortit të saj.** Kjo vlen vetëm për agjërimet vullnetare (nafile) e jo edhe për agjërimet farze.

e. **Agjërimi i udhëtarit, kur ai ndjen vështirësi e lodhje të madhe.**

7. Buhariu dhe Muslimi.

## Roli i vitaminave në zgjatjen e trupit

Gjenetika luan rol të veçantë në përcaktimin final të gjatësisë suaj. Por vitaminat dhe mineralet ndihmojnë rritjen dhe pamjaftueshmëria e disa prej tyre mund të shkaktojë vonësë në zgjatje si dhe të ndikojë në gjatësinë përfundimtare. Që ti ndihmoni fëmijës suaj të zgjatet, duhet t'i jepni sasi të mjaftueshme të kalciumit, të vitaminës D dhe zinkut.

### Kalciumi

Kalciumi është minerali më me shumicë në trupin tonë. Kalciumi nevojitet për tkurrjen e muskujve, sekrecionin (lirim) e hormoneve dhe enzimave dhe transmissin e impulseve nervore. 99% e kalciumit të trupit tonë gjendet në eshtra. Eshtrat vazhdimisht thithin dhe depozitojnë kalcium për tu forcuar dhe ndërtuar ashtë si ri. Fëmijët kanë nevojë për sasi adekuate të kalciumit gjatë zhvillimit të tyre në mënyrë që të zgjaten. Foshnjat kanë nevojë për 210 deri 270 mg kalcium në ditë, kurse adoleshentët kanë nevojë për 1300 mg kalcium në ditë. Ushqimet e pasura me kalcium janë produktet e qumështit, peshku salmon, sardelet, lëngu i portokallit, spinaqi, lakra dhe qumështi i sojës.

### Vitamina D

Vitamina D është një vitaminë që gjendet vetëm në disa fruta. Por trupi ynë ka aftësi të prodhojë vitaminën D kur i ekspozohemi diellit. Vitamina D është e nevojshme sepse ndihmon në thithjen e kalciumit nga stomaku dhe në mineralizimin e eshtrave. Vitamina D ndihmon fëmijët që të zgjaten. Një studim i 2009 i publikuar në "The Journal of Clinical Endocrinology and Me-

tabolism" ka studiuar marrëdhëniet mes statusit të Vitaminës D dhe gjatësisë përfundimtare tek vajzat nga moshën 16 deri në 22. Studiimi ka treguar se vajzat me nivele të zvogëluara të Vitaminës

D gjithashtu kishin edhe gjatësi më të vogël. Ushqimet e pasura me vitaminë D janë peshku salmon, kërpudhat, qumështi dhe lëngu i portokallit i fortifikuar.

### Zink

Zinku është një mineral esencial prezent në disa ushqime. Zinku luan rol në sintezën e ADN-s, sintezën e proteinës dhe ndarjen e qelizave. Gjithashtu nevojitet për të ndihmuar rritjen normale gjatë shtatzënisë, fëmijërisë dhe adoleshencës. Sasia e pamjaftueshme e zinkut mund të ndikojë në mos rritjen e mjaftueshme. Ushqimet e pasura me zink janë prodhimet e detit, kofshët e pulës, drithërat e fortifikuara, kosi, bajamet, etj.



Besimtarët myslimanë në të gjithë botën kanë nisur agjërimin e muajit të Ramazanit. Megjithatë në tërësi agjërimi është shumë i shëndetshëm, personat me disa sëmundje të caktuara duhet të tregohen të kujdesshëm dhe

të agjërojnë me lejen e mjekut.

Të sëmurët kronikë duhet të tregohen shumë të kujdesshëm gjatë muajit të Ramazanit dhe të agjërojnë pa vënë në rrezik shëndetin e tyre. Si mund të agjërojnë të sëmurët me sëmundje kronike?

Nëse vuani nga një sëmundje kronike duhet të shkoni rregullisht tek mjeku. Të sëmurët me tiroide mund të agjërojnë duke marrë ilaçet në syfyr dhe sigurisht nën kontrollin e mjekut. Përsa kohë që qëndrimi pa ngrënë dhe pa pirë ujë nuk krijon ndonjë shqetësim tek i sëmuri atëherë ai mund të agjërojë.

## Të sëmurët kronikë dhe agjërimi

Sigurisht që personat të cilët mund të përkeqësohen nga agjërimi nuk duhet të agjërojnë, vetëm se me lejen e mjekut. Po cilët të sëmurë duhet të marrin lejen e mjekut para se të agjërojnë?

- Diabetikët të cilët përdorin ilaçe orale anti-diabetike për të ulur nivelin e sheqerit apo insulinë.
- Personat me probleme zemre.
- Shtatzënat (veçanërisht 3 muajt e parë ose 3 muajt e fundit).
- Personat me një nivel sheqeri më të ulët se normalja.
- Personat me ulçerë në stomak apo në zorrë.
- Personat me sëmundje kronike të mëlçisë ose veshkave.
- I sëmuri që ka kaluar një operacion të vështirë dhe i duhet të ushqehet rregullisht.

Dhe në fund nëse vuani nga sëmundje të ezofagut, stomakut, zorrëve, mëlçisë, fshikëzës së tëmthit apo pankreasit nuk duhet të agjëroni pa kontaktuar mjekun tuaj. Doktorit mund të bëjë disa analiza për të kuptuar më mirë gjendjen tuaj apo të bëjë disa ndryshime në kurë. Në këtë mënyrë përcaktohen më mirë mundësia e agjërit apo jo, gjërat që duhen pasur kujdes kur agjëroni dhe të parandaloni situatat e padëshiruara.

## Mikroçipi që do të zëvendësojë kafshët laboratorike

Një version mikroçipi i trupit të njeriut është aktualisht në zhvillim. Pajisja përfundimtare nuk do t'i ngjajë shumë një personi, por ajo do jetë mbartëse e qelizave të vërteta të njeriut dhe do të ketë të njëjtat funksione bazë si 10 organe të rëndësishme të trupit të njeriut.

Shpikësit e pajisjes shpresojnë se ajo do të bëhet një qendër testimi për barnat e reja, duke zëvendësuar kafshët laboratorike në disa studime.


Studiuesit në Institutin Wyss të Universitetit të Harvardit për Inxhinierinë Biologjike tashmë kanë rikrijuar disa funksione të organeve të njeriut në mikroçip, duke përfshirë një mikroçip mushkërie dhe zorrësh.

Instituti ka njoftuar se do të nisë një projekt për të krijuar 10 mikroçipe të tilla dhe do t'i bashkojnë në mënyrë që të mund të bashkëveprojnë në një sistem kompleks. Shkencëtarët e Institutit do të ndërtojnë një kontrollues

për mikroçipet, që do të përcjellin lëngje brenda dhe jashtë sistemit për të matur biokiminë brenda.

Ashtu si një mikroçip kompjuteri që përmban një qark elektrik, mikroprocesorët biologjikë kanë kanale boshe ku mbledhin lëngje. Kanalet e mikroçipit janë të veshura me qelizat e njeriut dhe të projektuara për të imituar një organ në miniaturë.

Shkencëtarët shpresojnë se një organ në mikroçip do të jetë një bazë e mirë për testimin e ilaçeve të reja. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë mendon se pajisja mund të jetë një mënyrë më e shpejtë dhe më e lirë e testimit të ilaçeve.



Një kompjuter i ndërtuar për Administratën e Sigurisë Kombëtare Nukleare Amerikane nga IBM-ja është kurorëzuar si super-kompjuteri më i shpejtë në botë, bëhet e ditur sipas

listës së 500 super-kompjuterëve më të mirë, duke i marrë kryesimin Kompjuterit K të projektuar nga Fujitsu-ja japoneze.

Kompjuteri NNSA, i quajtur Sequoia, bazohet në arkitek-

## Kompjuteri më i shpejtë në botë

turën BlueGene/Q të IBM-së dhe është në gjendje të arrijë 16.32 petaflopëbaraz me 16.32 kuadrilonë operacione pikë pezulluese për sekondë. Kjo lë shumë mbrapa Kompjuterin K, që arrin vetëm 10.51 petaflopë. IBM ofron një sqarim alternative të performancës së tij, duke shpjeguar se "3 miliardë njerëz që përdorin makinë llogaritëse xhepi duhet të kryejnë një milion operacione në sekondë për të arritur performancën e barasvlershme me SuperMUC."


Është e lehtë të kuptosh kur merr parasysh specifikat e Sequoia: ai përmban 1.6 milionë kore (core) me 1.6 petabyte RAM. Është sa një dhomë, i mbushur me 96 rafta dhe është i shëmtuar, por disa njerëz preferojnë më tepër mendjen se sa bukurinë.

## Panelet diellore transparente

Vitin e kaluar, kemi parë shkencëtarë të fusin material fotovoltai kudo, bojën në mure, në hapësirë, madje edhe në tavolinën e kafesë. Tani, një ekip kërkuesish nga Universiteti i Kalifornisë, Los Anxhelos (UCLA) dhe Universiteti i Kalifornisë, SantaBarbara (UCSB) kanë krijuar panele diellore transparente, që mund të përdoren si dritare që prodhojnë energji për shtëpinë tuaj.

Panelet e reja diellore janë një element fleksibël, plastik që tërheq energji ekskluzivisht nga spektri infra i kuq i rrezeve të diellit. Njëkohësisht, panelet lejojnë dritën e dukshme të kalojë përmes xhamit, që është 70% i tejdukshëm.

Përpjekjet e mëparshme në zhvillimin e paneleve diellore kanë rezultuar gjithnjë në një ekuilibër të dobët mes prodhimit efikas të energjisë dhe tejdukshmërisë. Këta kërkues,



megjithatë, krijuan një formulë të veçantë që arriti 4% nivel efikasiteti të shkëmbimit të energjisë, duke qenë paneli diellor më transparent në botë.

## Dhuna dhe padrejtësitë kundër myslimanëve të Mianmarit

As populli, as mediat, as qarqet politike në Mianmar e as shtypi botëror nuk mësuan nga ndodhitë që ndodhën në nëntor të vitit 2010 në këtë vend. Ngjarjet e fundit që janë duke u zhvilluar në skenën politike të Mianmarit, tregojnë për përshkallëzim të dhunës, ndërsa ajo çka është duke habitur të gjithë është se këtyre provokimeve po i ndihmon edhe politika. Pas 20 vitesh, në 9 nëntor të vitit 2010 ishin mbajtur zgjedhjet parlamentare.

Mirëpo sa i përket gjendjes së myslimanëve në Mianmar edhe pas këtyre zgjedhjeve nuk ndodhi asgjë në favor të tyre, duke mos iu dhënë asnjë të drejtë elementare. Asnjë institucion në Mianmar nuk kishte ngritur zërin për të kërkuar respektimin e të drejtave të muslimanëve, kurse sa i përket të drejtave të murgjve budistë dhe disa udhëheqësve të grupeve tjera fetare e etnike, ishte ngritur zëri në institucionet më të larta. Gjatë dy dekadave të kaluara në Mianmar, myslimanët ishin keqtrajtuar në mënyrën më mizore. Si pasojë e dhunës së ashpër të përdorur nga ushtria e Mianmarit ndaj myslimanëve të këtij vendi, ata ishin detyruar të shpërnguleshin dhe të shkonin në kufirin me Bangladeshin. Bangladeshi është një vend i varfër mysliman i cili me vite ka marrë ndihmë nga Agjencia për refugjatë e OKB-së.

Me sa duket historia e myslimanëve të Mianmarit vazhdon të përsëritet. Mianmari ditët e fundit ka përjetuar

shtimin e valës së sulmeve nga ana e budistëve, sulmet që kanë rezultuar me vrasjen e myslimanëve. Burimet informative dëshmojnë se deri tani në Mianmar janë vrarë më shumë se 20 mijë myslimanë, ku 5 mijë prej tyre janë femra. Ekstremistët në Mianmar, vrasin burrat myslimanë dhe përdhunojnë gratë dhe vajzat e reja në heshtjen e plotë të perëndimit dhe kjo është intensifikuar akoma më shumë pasi qeveria e Mianmarit ka deklaruar se myslimanët nuk janë shtetas të këtij vendi. Kjo qeveri tha se një pakicë myslimane nuk është pjesë e Mianmarit dhe ata nuk pranohen as nga vendet fqinje. Konfliktet mes budistëve dhe myslimanëve në Mianmar kanë nisur një muaj më parë pas një zënke mes një myslimani dhe një budisti. Kjo çështje u dha shkas budistëve radikalë që të sulmojnë dhe djegin fshatrat dhe zonat e banuara nga myslimanët. Vrasjet e muslimanëve të Mianmarit nga ana e budistëve ekstremistë ka shkaktuar zemërim dhe urrejtje tek të gjithë myslimanët e botës.

Qeveria e Mianmarit vazhdimisht është duke rritur shkëlqet e të drejtave të myslimanëve. Nuk ka dyshim se çdo organizatë apo parti politike islame në botë duhet të ndikojë në zgjidhjen e problemit të myslimanëve në Mianmar, duke i bërë trysni qeverisë së këtij vendi që të shmang dhunën që është duke ushtruar ndaj myslimanëve.

## Olimpiada e Londrës e gatshme për Ramazanin

Kryetari i Komitetit Organizativ të Lojërave Olimpikë në Londër (LOCOG) Sebastian Coe, tha se të gjitha nevojat e sportistëve, ekipeve profesionale dhe spektatorëve në Olimpiadën e ardhshme do t'ju plotësohen nevojat, përfshirë këtu edhe nevojat e myslimanëve gjatë muajit të shenjtë të Ramazanit.

Coe tha se gjatë planifikimit të Lojërave Olimpikë, LOCOG ka qenë e vetëdijshme se muaji i shenjtë i myslimanëve dhe lojërat olimpikë janë në të njëjtën kohë, prandaj ata kanë ndërmarrë të gjitha masat që t'ju mundësojnë nevojat e pjesëmarrësve muslimanë në këto lojëra. Sipas Coe gjithçka është gati për

të filluar Olimpiada. "Janë marrë masa të forta të sigurisë. Për sigurinë e lojërave do të kujdesen persona me aftësi dhe përvojë të njëjste ushtarake dhe policore. Jemi të vetëdijshëm se ky është një manifestim i madhe sportiv,

jo një samiti i sigurisë. Unë dua vetëm të dërgoj një mesazh se qëllimi ynë është që lojërat të zhvillohen në një mjedis të sigurt... Jemi të vetëdijshëm për nevojat e veçanta të myslimanëve gjatë muajit të tyre të shenjtë të Ramazanit dhe kemi

parashikuar që nevojat e tyre të respektohen dhe të përmbushen

dhe, jo vetëm për atletët, por edhe për ekipin profesional dhe spektatorët", tha Coe.

